



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29 GUSHT 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
29. AVGUSTA 2011. GODINE**

**GUSHT – AVGUST
2011**

E premte, më 29.8. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër dhe Kabinet qeveritar,
Mirë se keni ardhur në mbledhjen e sotme plenare!

Prezentë kemi 85 deputetë. Para se të hap punime e seancës, sipas rendit të ditës që e kemi marrë, ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, sot, në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht 2011, vendosi që t'i propozojë Kuvendit që sot në vend të shqyrtimeve të para të projektligjeve, të procedohet në fillim me shqyrtimin e dytë të 14-të projektligjeve. Këto projektligje janë të një rëndësie të veçantë dhe me prioritet, të parapara në Raportin e progresit të Komisionit Evropian.

Andaj, kërkoj miratimin e juaj për këtë propozim të Kryesisë së Kuvendit, përkatësisht në vend të leximit të parë, të shkojmë në leximin e dytë të projektligjeve. Materialet u janë shpërndarë deputetëve, nëpërmes grupeve parlamentare. Tani, kërkoj fjalën e kryetarëve të grupeve parlamentare. Fjalën e ka deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryeministër, Kabinet qeverisës,

Të nderuar kolegë,

Duke pasur parasysh rëndësinë që kanë ligjet të cilat kanë kaluar në leximin e parë dhe sot që na kanë ardhur të përgatitura për leximin e dytë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është dakord që për këto ligje të bëhet kjo shmangie, por të vazhdohet me procedimin edhe më tutje, mos të ndërpritet seanca, por të vazhdojmë me seancën e re dhe me leximin e ligjeve të tjera për lexim të parë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të LDK-së, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Edhe ne, si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, jemi që këto pika të futen në rend të ditës, por e kemi një, është edhe një kërkesë që kur të vijë atje, tash po e shfrytëzoj rastin, zoti kryetar, për Projektligjin në lexim të dytë që është për prokurim publik, është një amendament i veçantë atje, ku përjashtohet nga nënshkrimi i kontratave, si e kanë formuluar, kryeministri, presidenti, etj, etj. unë propozoj që këtu të futen edhe kryetarët e komunave.

Mendoj që është plotësisht, zoti kryetar, e arsyeshme që në këtë grup të njerëzve autoritativë edhe përgjegjës, të futet edhe kategoria e kryetarëve të komunave, që edhe këta me ligj të përjashtohen nga nënshkrimi i kontratave për punë që bëhen në komunat përkatës. Është kërkesë edhe krejt pothuajse të kryetarëve të komunave dhe mendojmë që është shumë e drejtë kësisoj, dhe ju kishim lutur që te ky amendament ose ky projektligj të shtyhet, nëse ka nevojë, vetëm për këtë, dhe komisioni gjegjës që është për Financa, të merret me këtë. Ky është propozimi ynë, përndryshe e përkrahim këtë që ju e propozuat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kur të shkojmë te ligji, para se të fillojmë, zhvillojmë debatin e nevojshëm.

Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e kundërshton këtë zëvendësim të agjendës, për shkak se konsiderojmë që këto ligje po nguten dhe nuk mendojmë që deputetët e kanë pasur kohën e mjaftueshme dhe informatat e mjaftueshme për të vendosur se si do të votojnë për amendamentet në këto ligje.

Pajtohem plotësisht që këto janë ligje shumë të rëndësishme dhe meqenëse janë të rëndësishme, konsideroj që duhet të jemi më të kujdesshëm me këto, jo kështu t’i kontrabandojmë, siç po ndodh me këto Amendamentime. Konsideroj që kemi kohë ende përbrenda gushtit që t’i shqyrtojmë këto ligje, p.sh. nëse shtyhet kjo agjendë për të mërkurën, atëherë nuk do të ishte shumë vonë, do të jemi përbrenda muajit gusht, se kur do të vendosim për këto ligje, mirëpo jo sot, meqenëse sot të gjithë janë përgatitur për një agjendë, për një rend dite plotësisht të ndryshëm nga ai që është propozuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Shumica prej këtyre ligjeve kanë kaluar nëpër komisione ose janë shqyrtuar nëpër komisione, të premtën.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës nuk kanë pasur kohë t’i marrin materialet për t’i lexuar. Mos harroni se po vendosim për çështje jashtëzakonisht të rëndësishme dhe për Kosovën është më e rëndësishme këto ligje t’u shërbejnë qytetarëve, se t’i shërbejnë Raportit Progresit. Mendoj se kemi mbërri në një pikë që është jashtëzakonisht e çoroditur për Kosovën, është jashtëzakonisht çoroditëse për ne, kur themi se ligjet duhet të kalojnë për shkak se i duhen Kosovës për Raport Progresit.

Kosovës i duhen ligjet e mira për të rregulluar jetën e qytetarëve të Kosovës, jo për ta rregulluar Raportin e Progresit dhe, fundi i fundit, rregullimi i Raportit të progresit është për hir të Qeverisë, për t’u dukur mirë, për t’u dukur që e ka kryer punën, e jo për ta ndrequr jetën e qytetarëve të Kosovës. Nëse këto ligje kalojnë kështu shpejtë, nëse Kuvendi i Kosovës vazhdon të punojë në këtë mënyrë, jeta e qytetarëve nuk rregullohet dhe Raporti i progresit vetëm tregon se a po përmirësohet jeta në Kosovë, nuk tregon Raporti i progresit se a po kalojnë 12 ose 13 ligje më shumë. Mendojmë se është procedurë shumë e keqe, mendojmë që është propozim i keq, mendojmë që është mendësi e keqe për ta rregulluar jetën në Kosovë edhe jemi kundër. Shpresoj që dikush në këtë Kuvend të Kosovës të mbërrijë në një moment dhe të thotë: - boll bre, se s’bën më kështu, se është tepëruar në të gjitha aspektet. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se ne vetëm tani e kemi rendin e ditës, me këto pika shitesë dhe duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre ligjeve, Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah që këto 14 pika të jenë në lexim, tash. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të SLS, Sasha Milosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Parlamentarna grupa Samostalne Libelarne stranke će podržati vaš predlog.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsjedniče!

I Parlamentarna grupa “6+“ podržava predlog Parlamentarne grupe PDK, tako da se slažemo sa ovim današnjim dnevnim redom.

KRYETARI: Faleminderit!

Mendoj, dëgjuat prononcimin e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Unë dua precizim, sepse po dalim në Kuvend edhe nuk është mirë, qoftë për mirë, qoftë për keq të pretendohet që dikush dha diçka. Sot, në orën 9:00, Kryesia e Kuvendit ka mbajtur mbledhje dhe Kryesia e Kuvendit, meqë e ka caktuar një agjendë, këtë që e keni sot, ka dashur të jetë korrekte me Kuvendin dhe s’ka vendosur asgjë, përpos t’i propozojë Kuvendit, dhe është Kuvendi, nëse do, e bë këtë ose se bë, as s’është PDK-ja, a LDK-ja, a AAK-ja, askush. Pra, ky është një propozim i Kryesisë së Kuvendit, i cili në të vërtetë është në kohezion me vendimin e Kryesisë të javës së kaluar, sepse në fund ne kemi thënë: Ligjet me prioritet, në lexim të dytë, mund të hyjnë në agjendë dhe në Kryesi të Kuvendit s’është vendosur asgjë. Ky është një propozim, le të dihet publikisht çka është kjo, se ka njerëz që s’kanë anëtarë kryesie dhe mund të jenë të pa informuar totalisht.

Varianti ekziston edhe pasnesër, edhe sot, kurrë nuk është e betonuar, janë deputetët që marrin qëndrim, është e drejta e tyre. Zoti kryetar, unë e pashë që është e domosdoshme të thuhet kjo, sepse ka njerëz që nuk janë të informuar. Nuk ka punë kontrabandimi, kujt i vyejnë këto të kontrabandohen, se unë dëgjova një shprehje që janë bërë këtu shprehje hatashëm të rënda. Njerëzit i kanë mendimet e veta, le ti thonë, por s’është interes i askujt dhe s’ka shans që të kontrabandohen ligjet, të cilat janë të monitoruara pa skaj, tepër bile. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk ka nevojë për debat, vendos seanca, propozimi është i Kryesisë së Kuvendit. Se kush si shprehet, mendoj se është çështje e mungesës së fjalëve adekuate.

Po shkojmë në procedurën e votimit, do të thotë kemi propozimin e Kryesisë për votim. Lus deputetët dhe regjinë, të përgatitën për votim dhe votojmë tash!
Kush është “për”? Për sot i miratojmë 14 ligje në lexim të dytë, këtë e votojmë.
Votojmë tash!

Me 63 vota “për”, 25 vota “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi propozimin e Kryesisë që të fillojë seanca për shqyrtimin e projektligjeve në lexim të dytë. Faleminderit!

Në seancë janë prezentë 101 deputetë. Tani kemi me radhë:

1. Deklarime jashtë rendit të ditës

Qeveria, e do tash fjalën apo më vonë?

Më vonë, mirë. Fjalën e ka kërkuar deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja për të cilën do të flas sot, është një çështje tashmë e ditur për të gjithë, shpërthimin e fuqishëm në gjigandin “Ferronikeli”, në Drenas, javën e kaluar.

Që nga funksionimi i kësaj fabrike, qytetarët e Drenasit dhe të rrethinës janë ankuar për ndotje të ambientit dhe kohë pas kohe këta qytetarë janë shqetësuar edhe me shpërthimet e natyrave të ndryshme, siç ndodhi edhe shpërthimi i fundit në javën e kaluar.

Mua, si deputete, më shqetëson fakti se pse kjo fabrikë, me reputacion të mirë, nuk iu përmbahet kriterëve evropiane për mbrojtje të ambientit. Një nga kushtet e rëndësishme është filtrimi i ajrit që del nga tymtarët e fabrikës, kusht ky që duhet të përmbushet domosdoshmërisht. Po të operonte kjo fabrikë në ndonjë nga vendet evropiane, patjetër do të duhet të përmbushte të gjitha kriteret e as që do të vinte në diskutim mos përmbushja i kriterit për ndotje të ambientit.

Kosova ka nevojë për tërheqjen e investitorëve, por njëkohësisht kërkojmë që këta investitorë t’iu përmbahen kriterëve për mbrojtje të ambientit. Po ashtu, kërkojmë nga departamenti përkatës në Ministrinë e Ambientit që të bëjë kontroll më të mirë lidhur me vënien e filtrave për filtrimin e ajrit. Kjo është e mundur të bëhet, sepse në rend të parë për të gjithë ne është jeta e qytetarëve.

Sikur të bëhej filtrimi i ajrit, qytetarët të Drenasit me rrethinë nuk do t’i kishin këto probleme që i kanë sot. Po ashtu, më shqetëson fakti se ambienti rreth “Ferronikelit” është shumë i vrazhdë, i parregulluar, pa gjelbërimin e nevojshëm dhe lë përshtypjen e një eksploatimi të egër.

Prandaj, e shoh shumë të nevojshme që investitorit t'i tërhiqet vërejtja për këto çështje të lartpërmendura, që ai dhe investitorët e tjerë t'i respektojnë dhe të punojnë konform rregullave për mbrojtjen e ambientit.

Unë mendoj që ne këtu, të gjithë së bashku, duhet të ngrisim zërin rreth kësaj çështje, sepse kjo së fundmi është në të mirën e gjithë qytetarëve të Kosovës dhe të mirën e Kosovës në përgjithësi. Kosova angazhohet fuqishëm për integritet evropian, atëherë ta kenë të gjithë të qartë, se parimet bazë për mbrojtjen e ambientit dhe siguria e qytetarit duhet të jenë në rend të parë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër, ministër,

Kolegë deputetë,

Unë do ta ngrej një çështje, se kohëve të fundit Ministria e Rendit ka qitur një konkurs për pranimin e policëve në Shërbimin Policor të Kosovës dhe në fletë aplikacion, në të cilin është dalë këto ditë, nga Ministria e Rendit apo nga Ministria e Shërbimeve Publike, janë cekur renditja e komuniteteve dhe ndër to, ka edhe komunitete që nuk janë të pranuar në Kushtetutën e Kosovës, por ka komunitete që s'janë paraqitur fare, edhe pse janë të pranuar në Kushtetutën e Kosovës dhe në Ligjin për komunitete.

Unë, në atë fletë-aplikacion kam vërejtje nga disa qytetarë të komunitetit egjiptian, të cilët nuk e shohin veten në atë fletë-aplikacion dhe nuk kanë vend ku të konkurrojnë. Janë të regjistruar edhe komunitetet që nuk janë në Kushtetutë të Kosovës, do të thotë, ka mbetur ai fletë-aplikacion, ja nga UNMIK-u, ose nga një zyrtar i cili nuk e di Kushtetutën e Kosovës, ose nga një zyrtar i cili nuk e di Ligjin për mbrojtjen dhe të drejtat e komuniteteve, se cilat komunitete janë në Kushtetutë dhe cilat s'janë në Kushtetutë.

Unë nuk di se si një qytetar i komunitetit egjiptian, si do të aplikojë, kur nuk ekziston rubrika. Është dashur në atë fletë-aplikacion ose mos të ceken fare, po të lehet deklarimi i lirë, ose të ceken të gjitha komunitetet të cilat janë të pranuar në Kushtetutën e Kosovës. Besoj që disa institucione janë duke e bërë një diskriminim ndaj disa komuniteteve, që nuk duhet të bëhet një diskriminim, dhe këtu kemi diskriminim të hapur që e shohin të gjithë, po edhe një diskriminim i heshtur, që nuk është duke e parë askush dhe që është shumë më i rrezikshëm se ai i pari.

Prandaj, unë lus institucionet e Kosovës dhe të gjithë ata që të zbatojnë Kushtetutën dhe të zbatojnë Ligjin për mbrojtjen dhe drejtat e komuniteteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI : Faleminderit, zoti kryetar!

Tre minuta janë të mjaftueshme për mua, sepse në emër të grupit do të flasë një koleg tjetër.

Do të flas shkurt, për një shqetësim që e kanë invalidët, veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në lidhje me pensionet invalidore që i gëzojnë ata. Shumica e invalidëve, të ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e gëzojnë pensionin, por ka edhe veteranë invalidë që nuk e kanë, nuk e gëzojnë akoma këtë pension, si pasojë e mos plotësimit të dokumenteve me kohë, të cilët tanimë nuk e kanë akoma të zgjidhur këtë problem. Problemi i tyre është i thjeshtë, sepse në përputhje me një Ligj për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, familjeve dhe viktimave civile të luftës, me Ligjin nr. 02/ L2, i aprovuar më 23 shkurt 2006, atyre në nenin 15, u kërkohet që dosjen e tyre ta plotësojnë edhe me një dokument nga një institucion që tashmë është shuar me ligj, përkatësisht u kërkohet një dokument nga Shtabi i Përgjithshëm i Trupave Mbrotjtëse të Kosovës.

TMK-ja është shuar, siç e dini, me ligj dhe nuk ka ndonjë trashëgimtar as pasiv e as aktiv dhe, si e tillë, nuk mund të lëshojë dokumentacione tash e tutje. Në të njëjtën kohë, ekziston edhe një zyre për mbrojtjen e të drejtave të ish-pjesëtarëve të TMK-së, një institucion i përkohshëm dhe, po ashtu, edhe ky institucion nuk mund t'i plotësojë këto kushte. Ju lus, ju zoti kryetar, që t'iu drejtoheni organeve kompetente për këtë çështje, që ky dokument i kërkuar nga Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së të mos kërkohet më si i tillë, ose të formohet një institucion, i cili do të jetë i autorizuar ta lëshojë këtë dokument, sepse vërtet është një maltretim shumë i madh kur atyre u kërkohet një dokument nga një institucion, i cili tashmë nuk ekziston.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të duhej të ishte organi, i cili do ta zgjidhte këtë problem qysh më herët, por unë nuk kam ndërmend t'i drejtohem ministrit Rashiq, për shkak se e di që ai nuk e ka hallin e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por po ju drejtohem juve që ta zgjidhni këtë problem shumë akut për të gjithë ata veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët akoma nuk e gëzojnë pensionin invalidor të ushtarit, pension i cili atyre ju takon. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryetar, zoti Krasniqi,

I nderuar kryeministër dhe ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Kohët e fundit biznesi në Kosovë me arsye ka ngritur një shqetësim, i cili ka rrezik që të bëhet faktor limitues për zhvillim dhe stabilitet ekonomik. Është fjala për furnizim me energji elektrike, përkatësisht kërkesën në vazhdimësi që Korporata Energjetike e Kosovës ua bën prodhuesve. Madje, në disa aspekte ata kanë arsye për imponimet e tilla, që i quajmë edhe "reket".

Më konkretisht, KEK-u u është drejtuar me një shkresë bizneseve, përkatësisht konsumatorëve me prioritet, me disa kërkesa ultimative, të cilat është vështirë të përballohen:

1. Fillimisht, KEK-u kërkon që kjo kategori e konsumatorëve të paguajë apo të ofrojë garanci për 25% të shumës vjetore të energjisë së faturuar.

Kjo kërkesë paraqet barrë të papërballueshme për shumë biznese në Kosovë, posaçërisht kur merret parasysh likuiditeti i vështirësuar në ekonomi. Biznesi nuk ka para, meqenëse ka shumë kërkesa duke filluar nga agjensionet buxhetore e deri te kërkesat e pa mbyllura ndërmjet bizneseve.

Me shkallën e likuiditetit të tashëm, mjafton të financohet prodhimi aktual, ndërsa secila ngarkesë, ekstra bëhet rrezik serioz për këtë. Njësoj do të reflektojë edhe kërkesa e KEK-ut për pagesën e 25% në energji. Shprehur në shifrat totale, ngarkesa do të dukej kështu: sipas Zyrës së Rregullatorit, KEK-u vjet ka faturuar energji për 174 milion euro, kurse ka arkëtuar 151 milion euro. Në këto shifra, konsumatorët komercialë, duke përfshirë edhe ata industrialë, marrin pjesë 30%, ose ata kanë paguar rreth 50 milionë euro. Nëse KEK-u tash kërkon që konsumatorët me prioritet të paguajnë paraprakisht 25% të shumës vjetore, do të thotë që menjëherë nga bizneset do tërhiqen 12.5 milionë euro.

Për të pasur më të qartë se sa është e madhe kjo shifër, vetëm po përmendi se eksporti i Kosovës në qershor ka qenë 30 milion euro. Pra, KEK-u po kërkon që të bllokojë gati 42% të eksportit mujor të Kosovës. Kjo është e papërballueshme për biznesin e Kosovës.

2. Unë e kam të qartë kërkesën e KEK-ut, po ashtu edhe standardet që aplikohen në vendet e Bashkimit Evropian, ku konsumatorët me prioritet paguajnë si paradhënie deri në 100% të energjisë së shpenzuar, por duhet thënë që fuqia e biznesit në BE është krejtësisht tjetër në krahasim me atë me Kosovën, se cilësia e furnizimit është e garantuar dhe ka përplot forma për kompensimin e dëmeve që mund të shkaktohen, për shkak të problemeve me energjinë elektrike.

3. Në Kosovë, KEK-u kërkon paradhënie, por nuk premton furnizim, si në cilësi, ashtu edhe në sasi. Ky...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem, predsedavajući!
Između stav Parlamentarne grupe „6+“.

Poštovani Bošnjaci, Turci, Romi, Gorani, Aškalije, Egipćani i ostali, da – ostali, Ovako jedan poslanik ne treba da zvuči, niti bilo koji zakon treba da glasi. Naravno da ste приметili da sam sa namerom - u ostale stavila baš one zajednice koje su u svakom zakonu poimenice naznačuju, Albanci i Srbi, a svi mi ostali, smo ostali. Gospodo poslanici i svi vi predstavnici Vlade, mi nismo ostali, mi smo jedini Bošnjaci, jedini Goranci, jedini Turci, jedini Romi, jedine Aškalije, jedini Egipćani u ovoj državi. Mi svojim prisustvom u ovoj državi treba da budemo lepota svakog zakona koji su odnosi na nas, jer smo mi oni koju ovu državu čine multietničkom. Bez nas ova država ne bi bilo multietnička i ne bi se uvrstavala u kategoriji onih država u Evropi koje spadaju u kategoriji multietničkih, ni u svetu.

Sve ovo govorim zbog toga što u poslednje vreme u nacrtima novih zakona Republike Kosova je primetna tendencija, ne spominjanje zajednica po njihovim nacionalnim imenima i neimenovanje njihovih maternjih jezika, osim sa izuzetkom većinske albanske i druge po brojnosti nevećinske srpske zajednice i albanskog i srpskog jezika.

Jedan od posebnog konkretnog primera za sve ovo što vam sada iznosim je Nacrt zakona o douniverzitetskom obrazovanju, koji će biti jedan od baznih zakona za uređivanje važne oblasti, kao što je obrazovanje u Republici Kosova, a koji je direktno od vrlo velike važnosti i za nas koji predstavljamo manjine u ovoj državi.

Ne znam da li ima potrebe da vas podsećam ili informišem da je definicija ne većinskih zajednica, koja se eksploatiše u donošenju zakona u Skupštini Kosova, „ostalih“ ne ustavna, jer Ustavom Republike Kosova ne većinske zajednice definišane po nazivu svog entiteta i sledeći logiku primene ustavnih odredbi u hijerarhiji pravnih akata, najlogičnije je da se u proceduri donošenja zakona najpre imenuju ustavne odredbe, što prenosno znači da ne većinske zajednice moraju se u zakonu pominjati i po nazivu svojih entiteta.

Smatram da bi trebalo da se kao poslanici i predstavnici Vlade odnosimo po normama koje su nam osnova u ovim našim eruo-atlanskim integracijama, a ne da se u nekim sferama pozivamo na međunarodne standarde, a u drugim sferama ne.

Ponavljam još jednom, mi nismo ostali, mi smo važni i ponosni smo na to ko smo i zato želimo da nas poštuju isto onako kako mi poštujemo druge i da nas u svakom zakonu, koji se direktno utiče nas, pominju nazivima naših entiteta, jer će se samo na taj način zadovoljiti pravda i ispoštovati sva pravila. Zahvaljujem!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Në seancën e kaluar përçolla një mesazh për vendorë dhe ndërkombëtarë. Mjaftë është tkurrur subjektiviteti jonë politik dhe juridik, duke sjell këtu librat të botuar, para 100 vjetëve në Serbi. Nuk kisha besuar se ajo mbi të cilën është ndërtuar, janë ndërtuar ato libra, fakti historik do të mungojë në një libër, të cilin e kam lexuar tani së fundi, i botuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Si edhe bashkëveprimtarët të tjerë në organizimet çlirimtare, edhe unë kur kam shkruar program për çlirimin e Kosovës, nuk më ka shkruar mendja të përmendja, pse këtë punë nuk e ka bërë ndonjë akademik, sepse do ta bënte shumë më mirë dhe më me kompetencë. Kur e kam shkruar, shtypur dhe shpërndarë buletin “Zëri i nxënësit” dhe “Republika e Kosovës”, nuk pyesja pse këtë veprimtari nuk e bën Akademia e Shkencave, si institucion më i lartë i diturisë, i formimeve shkencore dhe i virtyteve kulturore.

Kështu kanë gjykuar edhe veprimtarë të tjerë çlirimtarë, kur kanë nxjerrë buletin “Pararoja”, “Zëri i Kosovës”, “Liria”, “Lajmëtari i lirisë” etj. Kur kam shkruar programin dhe statutin e organizatës sime, si dhe shumë autorë e përpilues të tjerë të dokumenteve të organizatave të

tjera, nuk kam thënë, sikur edhe ata, se këtë duhet ta bëjmë ne, ta bëjë unë, sepse këtë do të mund ta bënte më mirë ndonjë akademik apo disa prej tyre. Por tani, kur e kam lexuar monografinë e botuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, me titull “Kosova - vështrim monografik”, nga faqja 235 e deri në faqen 283, më janë imponuar shumë pyetje, duke përjetuar një atak shpirtëror, krejt të veçantë në jetën time dhe shumë të rëndë.

Për të shkruar program për çlirimin e Kosovës ka qenë shumë sfiduese, si duket nga empiria tanimë nuk mjaftuaka që njeriu të ketë formim akademik dhe thirrje akademike, qenka e domosdoshme edhe një virtut gjenetik.

Përveçësimi i këtij definimi na ndihmon që të krijojmë brenda nesh një harmoni të plotë, por për të shkruar objektivisht për luftën çlirimtare, nuk sfidon asnjë rrezik, sikurse për të bërë program çlirimtar dhe sikurse për të udhëhequr një luftë çlirimtare. Pse ka ndodhur kjo në këtë monografi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI : Veç lajmërohuni në fillim, mësoni procedurat. Në emër të grupit parlamentar janë 5 minuta, në emër të deputetit janë 3 minuta. Ju në fillim prezantohuni për cilin variant jeni. Vazhdojani edhe 2 minuta, deputetit Halit Krasniqi!

HALIT KRASNIQI: Pse ka ndodhur kjo në këtë monografi, asnjëherë nuk dëshiroj të përgjigjem, por dëshiroj që kjo të korrigjohet dhe kërkoj nga Ministri i Arsimit që së bashku me ekupe profesionale, e në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve, të ndryshojë tërësisht disa njësi dhe disa të tjera t’i plotësojë më objektivitet eminent.

Lufta çlirimtare nuk ka ndodhur nga një ëndërr nate, si reagim impulsiv i një përplasje momenti, por ka lindur si rezultat i një përgatitje të gjatë në rrugën e qëndresës, nga një përkushtim maratonik i udhëhequr nga një intuitë me shumë intelekt, deri në formimin e fortesës çlirimtare, prej nga janë prodhuar dhe shpërndarë devotshmëria për këtë vend dhe gatishmëria për flijimin e një populli të tërë, për të rilindur këtë popull, si feniksi, pa harruar asnjëherë, për falënderime ndërgjegjen e qytetërimit botëror, e cila reagoi me një emancipim të panjohur për këtë kontinent deri atëherë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të, vetin a, deputeti apo të grupit, Glauk?

Mirë, në emër të grupit, fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Edhe përkundër agresionit më të fundit të Serbisë ndaj Republikës së Kosovës, më 26 korrik, edhe përkundër agresionit permanent të Serbisë ndaj Kosovës përmes strukturave të paligjshme që i financon dhe kontrollon Beogradi, edhe përkundër faktit që kemi të bëjmë me një shtet të vetë deklaruar haptazi si armik i pandreqshëm i shqiptarëve, më 2 shtator Qeveria jonë pritet t’i qëndrojë edhe njëherë tjetër gatitur Beogradit, të cilit aq shumë po i nevojitet fqinjësia e shtirur me Kosovën, për të hyrë shpejt e shpejt në Bashkimin Evropian.

Me vetë faktin që Qeveria e Kosovës nuk i ka vendosur kurrfarë kushti Serbisë që është përgjegjëse për sulmin mbi kufijtë tanë shtetërorë dhe po shkon të ulet sërish, e poshtëruar, në tavolinën e bisedimeve me Serbinë agresore, tregon qartë që përfaqësuesi i delegacionit të Kosovës, në këtë rast pra përfaqësuesja e kryeministrit, Edita Tahiri, do të shkojë në bisedime dhe do të ulet e do t'i shtrëngojë duart e do t'ju qesh kamerave së bashku me udhëheqësin e ekspeditës së armatosur serbe mbi kufijtë tanë republikanë, Borisllav Stefanoviqin.

Ata do të qeshin me njeriun, i cili duhet të mbahet përgjegjës, në fakt, për vrasjen e policit tonë të rënë në krye të detyrës, heroin e Kosovës, Enver Zymberin. Serbia ende nuk po na njeh, Serbia po na e minon shtetësinë, Serbia nuk po i kthen të pagjeturit, Serbia po ngrit barrikada brenda shtetit tonë, Serbia po e dërgon përfaqësuesin e saj negociator për t'i udhëhequr bandat kriminale në veri, kurse Qeveria jonë po detyrohet me "bishtin nën shalë" t'i gëlltisë të gjitha këto dhe t'ju bindet kërkesave të Beogradit.

Më poshtërim se kaq, nuk di se a ka më. Deri tash, sa dimë e sa u tha nëpër media, sepse nga Qeveria jonë jo transparente, nuk mund të mësojmë asgjë, në këto negociata po shkohet të bisedohet edhe për pikat e djegura doganore, si dhe për vulat doganore. Ja pra, strategjia e Serbisë, njëherë të djegë, pastaj të qet në negociata, e në fund të detyron të bësh kompromis. Vetë fakti që pikat e djegura doganore po përfundojnë në negociata me Serbinë, është shenjë që me automatizëm tregon se Qeveria e Kosovës po na gënjen kur po na thotë se po i kontrollon pikat doganore.

Shtrohet pyetja, po t'i kontrollonte pikat doganore tërësisht, atëherë pse do të duhej ta pyesnim Serbinë se çka mund të bëjmë, e çka s'mund të bëjmë, çka na lejohet, e çka s'na lejohet?!

Pikat doganore 1 dhe 31 po përfundojnë në negociata, sepse në to kontrollues konkretë më shumë po duket të jetë Qeveria e Serbisë, se Qeveria jonë. Tash, kur pikat e djegura doganore po përfundojnë në negociata me Serbinë, po rikonfigurohet edhe më qartë qëllimi i ndërhyrjes së Qeverisë, më 25 korrik.

Plani paska qenë që vetëm të provokohet Serbia, që të tërhiqen forcat, që strukturat e Serbisë t'i djegin pikat doganore dhe kështu të krijohet një ngjarje aq e bujshme, sa të jetë e denjë për të përfunduar në negociata, sepse përndryshe pa kurrfarë eksesi, pa një dhunë të kontrolluar, kufijtë e Kosovës zor se do të ishin bërë temë e negociatave. Po të ishin bërë temë e negociatave, kufijtë e Kosovës pa ndodhur asgjë e jashtëzakonshme, kjo do ta kishte ngritur "peshë" opinionin publik. Por, tash kur Qeveria me veprimet e veta aventureske dhe pa kurrfarë plani strategjik paraprak e bëri veriun temë të bisedimeve, e ka maskuar pak më mirë qëllimin e saj të vërtetë, duke pretenduar se po hidhet në bisedime zgjidhja e një situatë të jashtëzakonshme.

Sido që të jetë, çka do e dëmshme që mund t'i ndodh Kosovës, në aspektin e integritetit territorial, apo çfarëdo ndarje e brendshme që rrezikon të institucionalizohet, çfarëdo marrëveshje që mund të arrihet për veriun për status special eventual atje, ne e dimë se kë duhet ta mbajmë përgjegjës. Përgjegjëse është kjo Qeveri e papërgjegjshme, e cila çdo veprim që po e bën, në qendër të kësaj e ka pushtetin personal të kryeministrit dhe jo interesin shtetëror të Kosovës.

Në fund, tash po ua jap një informatë tjetër, jashtë kësaj, meqë konsiderojmë që procedurat e sotme parlamentare që u vendosën këtu, paraqesin shkelje të papranueshme dhe tallje me deputetët e Republikës së Kosovës, sepse madje as anëtarët e komisioneve ende nuk i kanë marrë të përmbledhura amendamentet dhe, si rrjedhim, gjatë votimit nuk do të dimë saktësisht se për çka po votojmë, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, unë po ju informoj se nuk do të jemi pjesë e këtyre manipulimeve dhe do ta lëshojmë sallën menjëherë pas pjesës së pyetjeve parlamentare.

Mënyra se si është vepruar me këto ligje, që po votohen sot menjëherë me procedura të shpejtuara, na e përkujton votimin e planit të Ahtisarit. Ky është një nxitim i Qeverisë, të cilit ne do t’i themi “jo”, dhe merre me mend, tash kur po e mbajmë ne seancën, është thirrur shpejt e shpejt të mbajë mbledhje Komisioni për Buxhet dhe Financa, vetëm...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REXHEPI: Zahvaljujem se, predsedniče!

Iskoristila bih priliku da upoznam gospodina ministra Ramë Buju sa problemom kojeg ima prizrenska opština, odnosno poštovani ministri, ako želite da obratite više pažnju na otvaranje jednog novog odeljenja u srednjoj školi u Prizrenu, gimnaziji, za to što su nam ostala 20 odlična učenika koja su već položila prijemni ispit. Ja sam posetila tu školu i postoje adekvatni uslovi za otvaranje još jednog takvog razreda, tako da vas molim da sa vašim autoritetom završimo taj problem. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Nesër është një ditë feste dhe shumë familje në Kosovë nuk kanë mundësi që të festojnë ashtu siç duhet, dikush për shkak të gjendjes financiare, dikush që ju mungojnë më të dashurit e tyre dhe dikush të dyja nga këto.

Dhe, për t’ua lehtësuar këtë, shteti duhet t’ju gjendet pranë. Çështja ka të bëjë se, Policia e Kosovës si organizatë në shërbim dhe mbrojtje të qytetarit, jo rrallëherë, është gjendur përballë sulmeve nga kriminel dhe krimi i organizuar. Kur vepruan institucionet, polici Enver Zymberi dhe gjithë pjesëtarët tjerë të policisë treguan vetveten në mbrojtjen e shtetit dhe të ligjshmërisë në vend. Por, çka ka bërë shteti për policët e tjerë të vrarë në krye të detyrës? Kemi shumë prej tyre, si: Sebahate Tolaj, Isuf Haklaj, Hajdar Ahmeti, Arsim Rustolli, Lazim Rexhepi etj., familjet e të cilëve nuk gëzojnë asnjë mbështetje institucionale dhe financiare.

Prandaj, me të drejtë sot prindërit e tyre e pyesin ministrin e Punëve të Brendshme, për çka është vrarë prindi ynë dhe pse neve nuk na mbështet shteti? Ndërsa, e pyesin edhe Presidentin e Kosovës, - a quhet hero edhe prindi ynë që luftoi krimin dhe kriminelët? Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje kryeministër, ministra,

Javën e kaluar ose në seancën e kaluar, është kërkuar që edhe Reçani me regjion të bëhet komunë. Është interesant se gjithnjë pakicat i mbajmë kështu në shuplakë të dorës dhe kujdesemi për ta, por e kemi Hasin që i ka 40 mijë banorë dhe nuk është komunë. Po, nëse qenka kështu, të bëjmë komuna aq dhe si po na preferojnë miqtë, unë kërkoj që Hasi të bëhet komunë dhe të nxjerrim ligje edhe për disa fshatra tjerë.

Kërkoj që ta nxjerrim një ligj të veçantë për fshatin Komoran, se është në qendër e Kosovës. Pika është midis... edhe është një... hiq s'keni nevojë të qeshim, ju lutem, kërkoj ta nxjerrim edhe një ligj të veçantë tjetër për fshatin Kliqinë, që kryeministri është këtu dhe këtë duhet ta shtimë në Raport të progresit, sepse aty janë rrahur shqiptarë, e shqiptarë që kanë kaluar atypari prej serbëve.

Kërkoj, po ashtu, Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, ta shpallim zonë edhe monument të mbrojtur, sepse prej viteve '60 janë gjykuar e dënuar sa e sa shqiptarë, ndërsa Udbën që ka qenë këtu, po ashtu, monument historik, që na i ruan vlerat dhe kujtesën tonë historike nga kemi kaluar. Mendoj që qytetarët e Kosovës duhet ta kuptojmë çfarë ligjesh po miratojmë, prandaj qendra e Kosovës është me rëndësi të veçantë, Ligji për Gjykatën është po ashtu me rëndësi të veçantë, Ligji për Udbën, po ashtu është me rëndësi të veçantë, se na freskon kujtesën dhe kërkojmë, po ashtu, një ligj për fshatin tim, Randrobravën, se është një kishë atje e vjetër, i ka diku nga 1500 vjet dhe është një fshat i djegur po ashtu, nën rrënoja, që kërkoi ministri i Kulturës, nuk është këtu, ta dërgojë ekspeditën ta këqyr, mos është ortodokse edhe ajo serbe atje, para 1500 vjetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, mendoj që ky i fundit është, Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë, qytetarë të Kosovës,

Unë do të flas prapë për shqetësimin që herën e kaluar e kisha për Ferronikelin dhe ftoj që konkretisht në Ferronikel, unë kam një interes të veçantë, sepse janë 5000 votues të asaj zone, të cilët më kanë deleguar këtu, në këtë Kuvend dhe të cilët janë duke u kontaminuar nga kjo kompani në mënyrë të pamëshirshme dhe mungojnë dhe vazhdojnë të mungojnë mekanizma monitorues të kontaminimit të asaj zone dhe propozoj që nga Ministria e Shëndetësisë të fillohet një hulumtim i sëmundshmërisë në perimetër 20 km rreth e përqark Ferronikelit, për sëmundjet e mundshme që mund të shkaktojë kontaminimi i ajrit, i tokës dhe i deponisë aty, që është në afërsi të Ferronikelit dhe qytetarëve, në një afërsi prej 100 m, ashtu.

Po ashtu, kërkoj nga Ministria e Ekonomisë dhe ajo e Financave, të shohin se si është duke u implementuar kontrata e tyre, për respektimet dhe obligimet që ata kanë karshi asaj kontrate. Kjo, do të thotë, është një formë që shtrohet edhe si pyetje për përgjigjet në takimet e radhës dhe Ministria e Industrisë, po ashtu, duhet të inspektojë situatën në atë institucion prodhues, i cili është shumë i rëndësishë së veçantë për Kosovën, por të shihet se sa është implementuar rifreskimi i teknologjisë në atë fabrikë, sa janë të testuara teknologjitë që punojnë në atë fabrikë, sa janë në rrezikshmëri qytetarët që punojnë brenda dhe qytetarët që janë në afërsi në atë fabrikë dhe kjo fabrikë duhet, së fundi, të respektojë të gjitha standardet që rrjedhin nga ligji që kemi kërkuar, po ashtu, edhe të respektojë edhe standardet që rrjedhin edhe nga Bashkimi Evropian, që Kosova sot është duke bërë përpjekje që të jetë pjesë, e ku Kosova është jashtëzakonisht e dëmtuar, jo vetëm nga Ferronikeli, po edhe nga impiant tjerë dhe mendoj që është kohë e fundit që Ministria e Ambientit të jetë shumë më azhure dhe të jetë shumë e organizuar, për mbrojtjen e ambientit, së bashku me dikasteret tjerë të shëndetësisë dhe të industrisë. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit!

Konsideroj që është ezauruar 30 minutëshi. Tani fjalën e ka kërkuar kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryesues, Haliti!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht, më lejoni që të jap një përgjigje, megjithëse nuk është pyetje-përgjigje, por sido që të jetë, për shkak të korrektësisë, por edhe për shkak të peshës dhe respektit për familjet dhe fëmijët e tyre, për policët e rënë në detyrë nga dita e themelimit të Policisë së Kosovës, shtator, do të thotë, muaji shtator 1999. Në Ligjin për Policinë kemi paraparë që të gjithë policët e rënë në detyrë, për familjet e tyre të sigurohen pensione të veçanta, do të thotë, për të gjithë policët e rënë në detyrë, i nderuari deputet Zemaj, që kanë rënë që nga dita e themelimit të Policisë së Kosovës, deri më tani. Tash, unë nuk po i përmendi emrat, por emrat dihen botërisht.

Të nderuar deputetë,

Sot do të mbahet mbledhja e Këshillit të Sigurimit të organizatës së Kombeve të Bashkuara, ku temë debati do të jetë gjendja në Republikën e Kosovës. Ne do të prezantojmë të arriturat në muajt e fundit, në Republikën e Kosovës. Republika e Kosovës edhe në muajt e fundit ka shënuar progres në konsolidimin e shtetit tonë dhe forcimin e institucioneve tona, në funksionimin demokratik të vendit dhe në zhvillimin ekonomik, por në harmonizimin e politikave bashkë me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Në rrugën e integriteteve evropiane, gjithashtu, është arritur progres dhe tash presim edhe Raportin e ardhshëm të progresit. Po ashtu, kemi marrë hapa për rend dhe ligj në tërë territorin e Kosovës. Presim mbështetje nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, për të drejtën tonë, për rend dhe ligj në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Vendosa që sot t'ju drejtohem për të shprehur qëndrimin tim lidhur me disa zhvillime aktuale në vend, aktualisht dhe në ditët e ardhshme. Tani jemi në fazën finale të përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur, një përmbyllje kjo e suksesshme. Para se gjithash, dua të njoftoj lidhur me vazhdimin e dialogut mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, me ndërmjetësimin e Brukselit dhe Uashingtonit, pra, të Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Dua të them qartë dhe shqip, Kosova nuk ka arsye për t'u zbrapsur apo frikësuar nga ky dialog i vlerave Euro-Atlantike. Përkundrazi, sot më shumë se dje, jemi të gatshëm të ulemi në tryezë në Bruksel dhe edhe aty të rikonfirmojmë konsolidimin e shtetësisë sonë dhe parimet tona të pa negociueshme të shtetit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Pas realitetit të ri të krijuar pas 25 korrikut, me implementimin në tërësi të reciprocitetit të mallrave dhe vulave doganore, Kosova është në pozicione shumë më të favorshme edhe brenda, edhe jashtë dhe në pozicion shumë më kredibil. Mbase, suksesi më i madh në nivelin politik nuk është vetëm implementimi i reciprocitetit, por mbi të gjitha demaskimi dhe dështimi i plotë i politikës së Beogradit për ndarjen e Kosovës, njëherë e përgjithmonë.

Ky demaskim solli edhe reagimin më të qartë nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës lidhur me tërësinë territoriale dhe sovranitetin e Kosovës, shuarjen e strukturave ilegale dhe kriminale dhe vendosjen e rendit dhe ligjit në tërë Kosovën. Është shumë e rëndësishme që bashkarish ta konsolidojmë, forcojmë dhe avancojmë këtë realitet të ri të pa suksesit historik të 25 korrikut. Ajo që ndodhi me 25 korrik, është hapi i parë, por shumë i rëndësishëm në shtrirjen e sovranitetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. S'ka mëdyshje që ky mision do të jetë edhe me shumë sfida, por kam besim të plotë në suksesin tonë.

Unë dua t'ju falënderoj të gjithëve, si grupe parlamentare dhe si deputetë, një nga një, secilin veç e veç nga ju, për mbështetjen që i keni dhënë vendimeve dhe veprimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në veri të Kosovës. Ju, ashtu sikurse unë dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, prisni të shihni veprimet konkrete të radhës, në mënyrë që rendi dhe ligji të mbretërojë në tërë Kosovën dhe unë ju them edhe njëherë qartë, kthim prapa nuk do të ketë, veprime për zhbërjen e strukturave ilegale dhe kriminale do të ketë, do të vazhdojnë. Përkundrazi, dua të them me shumë zë, se në veri të Mitrovicës nuk është në konflikt qytetari me Qeverinë, por e drejta me të padrejtën, ligji me jo ligjin, e mira me të keqen. Do të ngadhënjë e mira.

Unë garantoj që në fund të këtij misioni do të na vijë shteti ligjor, rendi dhe demokracia, në mënyrë që qytetarëve tanë atje t'u mundësojmë të jetojnë të lirë, pa frikë në shtëpitë e tyre, t'u krijojmë mundësi të barabarta të gjithë qytetarëve tanë, në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Më lejoni, të nderuar deputetë,

Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Të shpreh bashkë me ju neverinë lidhur me mënyrën se si po portretizohet Policia e Kosovës, e posaçërisht njësi elit ROSU, nga zyrtarët e Beogradit, por edhe nga disa qarqe ndërkombëtare. Pjesëtarët e njësitit ROSU janë vëllezërit dhe motrat tona, apo gratë dhe burrat e Kosovës, bijtë dhe bijat tona, të cilët me nderin dhe guximin më të madh po i shërbejnë vendit, Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Deklarimet neveritëse që për qëllim kanë diskreditimin e këtij njësi, janë shprehje e qartë e gjendjes së rëndë, nervoze dhe agresive në të cilën gjendet politika aktuale e mentalitetit të vjetër të Beogradit.

Ata, si duket, harrojnë që Policia e Kosovës është themeluar dhe trajnuar me ekspertizën më të mirë, më të lartë profesionale ndërkombëtare. Krahasset dhe insinimet e dëshpëruara, do ta kenë si përgjigje profesionalizmin dhe besueshmërinë e vajzave dhe djemve më të mirë të Policisë së Kosovës.

Zonja dhe zotërinj,

Teksa angazhohemi të gjithë për shtrirjen e rendit dhe të ligjit në tërë Kosovën, më lejoni të them se është e rëndësishme që të dërgojmë mesazhe të qarta edhe për qytetarët serbë të Kosovës. Të rikonfirmojmë angazhimin tonë për përmbytjen në plotëni të të drejtave afirmative për komunitetet jo shumicë në Kosovë. Pjesë integrale e Deklaratës së Pavarësisë, të cilën me shumë krenari e përgjegjësi e kemi nënshkruar shumë prej nesh në këtë sallë, më 17 shkurt 2008, është edhe pakoja e presidentit Ahtisari.

Pavarësia ka qenë maksimumi i kompromisit tonë dhe minimumi i së drejtës sonë historike dhe për këtë janë të vetëdijshëm dhe e kanë të qartë edhe të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë. Dhe tani, të nderuar deputetë, për befasi, sidomos me dy ligjet e mbetura për miratim, atë të Qendrës Historike dhe Kulturore të Prizrenit dhe Hoçës së Madhe, dua të shpreh shqetësimin tim, si kryeministër i Kosovës, lidhur me diskursin që e ka shoqëruar procedimin e këtyre dy ligjeve.

Dua të them shumë hapur, se nuk jam aspak i befashuar nga reagimi i partisë “Vetëvendosje”, sepse në fund të fundit, sfidimi i pakos së Ahtisarit, Kushtetutës, multi etnicitetit, simboleve shtetërore, kufijve të Kosovës, ekonomisë së lirë të tregut, është platforma kryesore politike e këtij subjekti politik.

Ajo çka është brengosëse, shqetësuese, e pandershme, është reagimi i disa grupeve parlamentare dhe i disa deputetëve, të cilët drejtpërdrejtë kanë qenë të përfshirë në negociimin dhe pranimin e pakos së presidentit Ahtisari, edhe në Vjenë, por edhe nga Parlamenti i Kosovës, në mars të vitit 2007.

Të nderuar deputetë,

Të nderur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është po ai diskurs, për të mos thënë po ajo zhurmë që e ka përcjellë edhe miratimin e disa ligjeve të tjera të pakos, më herët, prej vitit 2007. Edhe argumentet janë po ato të paqenat, se po ndahet Kosova, gjoja, po kantonizohet Kosova, po enklavizohet Kosova, po ndërtim shtet brenda shtetit, e të tjera, e të tjera. Në fakt, praktika e ka dëshmuar pikërisht krejt të kundërtën e kësaj zhurme me motive politike. Ne kemi probleme me rendin, ligjin dhe strukturat ilegale

vetëm në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, aty ku ende nuk kemi arritur ta implementojmë pakon e presidentit Ahtisari. Ne kemi marrë mbështetje ndërkombëtare, por edhe kemi obligime ndërkombëtare, prandaj bota pret të sillemi si shtet serioz dhe do të sillemi.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Deputetë, qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Duartrokitjet e disa deputetëve për rrëzimin e ligjeve të presidentit Ahtisarit në Parlament, nuk janë për t'u krenuar, ato janë flakaresha për shtetndërtimin dhe konsolidimin e shtetit tonë të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kosova nuk rrezikohet nga qytetarët serbë të saj, nuk rrezikohet nga përfshirja e tyre në jetën institucionale, as në nivel qendror, as në nivel lokal. Më thoni, ju lutem, çka po e rrezikon pavarësinë e Kosovës, funksionimin e Kushtetutës dhe rendin e ligjin në komunën e Graçanicës, me çka po e rrezikon Kosovën komuna e Shtërpces, me çka po e rrezikon Kosovën funksionimi i komunës së Graçanicës, Ranillukut apo e Klllokotit? Me çka po e rrezikon shtetin e Kosovës funksionimi i manastirit në Deçan, Pejë apo Deviq? Jo, të nderuar deputetë, Kosova nuk rrezikohet nga pakicat, as nga kishat e xhamitë, e as nga funksionimi i monumenteve tjera fetare. Kosova dhe e ardhmja e saj evropiane rrezikohet nga papërgjegjshmëria jonë, nga patetizmat dhe romantizmat e së kaluarës. Gardianët e vetëshpallur të pavarësisë së Kosovës duhet ta kenë të qartë njëherë e përgjithmonë, koha kur referencat dominante politike kanë qenë fjalët “tradhtarë” e “patriotë”, kanë përfunduar njëherë e përgjithmonë në Republikën e Kosovës.

E kam theksuar dhe e ritheksoj, për lirinë dhe çlirimin e Kosovës të gjithë qytetarët janë meritore. Kosova është e pavarur, sovrane dhe e tërë. Si klasë politike e kemi për detyrë që nivelin e debatit politik ta zhvillojmë përtej sintagmave, ky apo ai është tradhtar, ky apo ai po e shet Kosovën, e të tjera të ngjashme. Kjo, jo pse duhet artificialisht të zhvillojmë debat për vlerat evropiane, reformat dhe detyrat që na presin, po për shkak se kualifikimet si ato që i thashë më herët, thjesht nuk qëndrojnë, janë patatizma, romantizma, janë demagogji.

Kosova është e pavarur, është sovrane, ka vizion të qartë për t'u integruar në NATO dhe Bashkim Evropian, por nuk hyhet as në NATO dhe as në Bashkim Evropian me sjellje të standardeve të dyfishta. Ne këtu në këtë sallë, para së gjithash, duhet të bindemi për këtë punë, për këto standarde, për këtë vizion. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Po vazhdojmë me pikën e dytë, të rendit të ditës, që është:

2. Koha për pyetje parlamentare

Janë 4 pyetje gjithsej, po e ezaurojmë edhe këtë çështje, që të mos e shtyjmë për seancën e ardhshme. Në bazë të nenit 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje e deputetëve për

Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një mbledhje mund të parashtrojë më së shumti 2 pyetje. Kemi pra 4 pyetje.

Pyetje e deputetit Haki Demolli, për ministrin Bedri Hamza.
Është Hakiu këtu? Po.

HAKI DEMOLLI : I nderuari kryesues,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministri Hamza,

Ministria të cilin e drejtoni ju, në janar të këtij viti përmes një komunikate ka njoftuar opinionin kosovar, si dhe gjithë pensionistët e Kosovës, se duke u bazuar në marrëveshjen e nënshkruar me FMN-në, në qershor të vitit 2010, Qeveria e Kosovës nga fillimi i këtij viti pensionistëve do t'ua rrisë pensionet, me qëllim të avancimit të pozitës materiale për këtë kategori.

Pyetje për ju: Tani jemi në fund të muajit gusht, ndërsa për pensionistët kosovarë ende nuk ka përmbushje të premtimit të dhënë lidhur me ngritjen e pensioneve të tyre. Cilat janë arsyet e mos ngritjes së pensioneve deri më tani, çfarë veprimesh konkrete keni ndërmarrë në këtë drejtim, kur do të fillojnë të zbatohen dispozitat ligjore me të cilat përcaktohen pagesat për këtë kategori, si dhe a do të zbatohen këto dispozita në mënyrë retroaktive apo jo? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

BEDRI HAMZA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

I nderuari zoti Demolli, faleminderit për pyetjen!

Pjesë e Ligjit të buxhetit për vitin 2011, dhe tabelave të buxhetit për vitin 2011, është edhe shuma, e cila është përlogaritur se është e mjaftueshme për mbulimin e kostos të Ligjit për pensione. Ministria sponzoruese, besoj që e dini këtë fakt, e këtij ligji është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe e ka përgatitur draftin e këtij projektligji. Ky projektligj është pjesë e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Janë duke u inkorporuar komentet e fundit me këtë draft ligj dhe pas finalizimit dhe inkorporimit të këtyre komenteve, ky projektligj do të procedohet për aprovim në Kuvend.

Ndërsa, sa i përket pjesës së pyetjes tuaj - kur do të fillojnë të zbatohen dispozitat ligjore, dispozitat ligjore do të fillojnë të zbatohen atëherë kur ky ligj do të aprovohet në Kuvend dhe në formën se si do të zbatohen këto dispozita ligjore, do të zbatohen në atë formë qysh aprovohen në ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti deputet?

HAKI DEMOLLI: Jo vetëm desha të them se ne vërtetë jemi përfaqësues të popullit, të të gjitha shtresave të popullit dhe përfaqësojmë po ashtu edhe pensionistët, andaj pyetja ime nuk kishte ndonjë karakter tjetër, përveçse karakterit informativ, në mënyrë që pensionistët të dinë se kur do të bëhet pagesa e pensioneve të tyre me shtesat përkatëse. Nuk kam pyetje.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

Zoti Aliu, e keni fjalën!

LIBURN ALIU: Pyetja ka të bëjë, pra, me vonesën e të ardhurave personale të 2400 shërbyesve civil në Gjilan, ka ndodhur, pra, vonesë 7 ditore, e cila të gjithë këtyre shërbyesve ju ka kushtuar jashtëzakonisht shumë, meqenëse një pjesë e madhe e tyre, mos të themi më tepër se gjysma e tyre, kanë kredi nëpër banka dhe pikërisht vonesa prej 7 ditësh ju ka shkaktuar të gjithëve probleme dhe kjo ka qenë problem, i cili ka qenë edhe përmes mediave dhe ka mbetur disi i pasqaruar. Pra, pyetja është për zotin ministër, që 2400 shërbyes civilë të komunës së Gjilanit i kanë marrë të ardhurat e tyre me 7 ditë vonesë, gjë që atyre ju ka shkaktuar probleme të mëdha, sidomos kur bëhet fjalë për kreditë në banka.

Komuna e Gjilanit për këtë vonesë të të ardhurave e fajëson ministrinë që e drejtoni ju, pra vetëm kërkojmë që të na njoftoni, pse ministria që e drejtoni ju, i ka vonuar të ardhurat e punëtorëve të lartpërmendur? Kjo është pyetja.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamza, e keni fjalën!

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari deputet Aliu, faleminderit për pyetjen, por Ministria e Financave nuk e ka bërë vonesën e pagesës së pagave. Ministria e Financave, ky është viti i 4-të, që çdoherë në kohë e ka bërë pagesën e pagave dhe për këtë muaj e keni vërejtur që ne kemi qenë të kujdesshëm që me datën 26 gusht e kemi bërë ekzekutimin e pagave për muajin gusht, ndërsa sa i përket rastit konkret, ministria e Financave, bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe Ligjin e buxhetit, është përgjegjëse për ekzekutimin e buxhetit, në këtë rast edhe këtë pjesën e pagave.

Çdoherë kur organizatat buxhetore e kanë numrin e të punësuarve dhe masën e pagave, në kuadër të Ligjit të buxhetit, ne pa problem e bëjmë ekzekutimin e pagave. Në momentet kur ndonjë organizatë buxhetore ka tejkallim të numrit të punësuarve në raport, me numrin i cili është lejuar me buxhetin dhe ka tejkallim të masës së pagave, ne kërkojmë nga organizata buxhetore që të bëj korrigjimet e nevojshme. Kësisoj ka ndodh edhe me komunën e Gjilanit, ku ka pasur një mospërputhshmëri për 43 mijë euro të masa e pagave. Ne kemi kërkuar që të bëhet ky korrigjim. Ky korrigjim nga Organizata Buxhetore përmes Ministrisë së Administratës Publike është bërë dhe ka ardhur masa e pagave në limitet e parapara. Ne, listën e pagave të korrigjuara në përputhshmëri me Ligjin e buxhetit dhe Ligjin për menaxhimin e financave publike, e kemi pranuar me datën 5.8.2011, në ora 15:45, ka qenë e premtë dhe në momentin kur është bërë korrigjimi i pagave, ne e kemi bërë ekzekutimin e pagave, prandaj ne çdoherë kërkojmë që numri i të punësuarve, masa e pagave të jetë brenda limiteve të lejuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti deputet?
Zotit Aliu, fjalën!

LIBURN ALIU: Nuk kam ndonjë pyetje shtesë, pra mua më interesoi vetëm të sqarohet kjo çështje, meqenëse ka qenë përmes mediave dhe shërbyesit civilë janë të painformuar, mendojnë që ministria e ka fajin apo komuna, kështu që kjo ishte shumë e nevojshme që të sqarohet.

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Bedri Hamza. Zoti Ymeri, e keni fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!
Pyetja ime ka të bëjë me buxhetin e Kosovës, më mirë të them me rishikimin e buxhetit të Kosovës. Siç e dimë, për vitin 2011, ky buxhet është kaluar nën presion të madh të kohës për shkak të nevojës që ligji të kalohet para datës 1 prill. Në diskutimet në mars ne i kemi shprehur vërejtjet tona mbi shumë çështje që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë fiskale të Kosovës, pra shpenzimet marramendëse pa mbulesë të sigurt në të hyra, mungesa e konceptit zhvillimor në buxhet, kontrabandimi i privatizimit të PTK-së ishin vetëm disa nga vërejtjet që i ne paraqitëm në fund të marsit. Raporti 6 mujor, i cili është dorëzuar nga Qeveria për shpenzimet buxhetore, dëshmon një realizim të dobët me investimet kapitale, përveç në rastin e autostradës, ku natyrisht pagesat nuk mungojnë, si dhe jep sinjale dhe shenja të qarta mbi mundësinë e mosrealizimit të planit të të hyrave, të cilin e kishte bërë Qeveria në fillim kur ishte miratuar buxheti.

Praktikat e shteteve demokratike që kanë përvojë të përgjegjshmërisë fiskale, tregojnë se me ndërrimin e kushteve dhe fakteve, si p.sh. humbja e një pjese të të hyrave, mosrealizimi i shpenzimeve kapitale etj., shteti bën rishikimin buxhetor gjatë vitit për të adresuar informatat e reja, në mënyrë që sa më mirë të planifikohen financat deri në fund të vitit dhe në mënyrë që institucioni më i lartë legjislativ në vend, pra Kuvendi, të ketë hapësirë që me përgjegjësi t'i mbikëqyrë financat e shtetit.

Pyetja ime është kjo: Duke marrë parasysh humbjen e një pjese të të hyrave të parashikuara në mars dhe duke pasur parasysh raportet buxhetore të 6 mujorit, trendet ekonomike në vend dhe më gjerë, si dhe rrezikun fiskal që i kanoset Kosovës, a e ka në plan Qeveria që ta iniciojë rishikimin e buxhetit për vitin 2011?

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti ministër, e keni fjalën!

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!
I nderuari deputeti Ymeri, faleminderit për pyetjen!

E vlerësoj të drejtën e juve që të votoni "kundër", mirëpo edhe atëherë ju kam thënë, edhe sot po ua ripërsëris që ka qenë më mirë të votoni "për", sepse ky ka qenë një buxhet ku ka përfshirë rritjen e pagave për mbi 70 mijë punëtorë që realizojnë paga përmes buxhetit, ka përfshirë rritjen e investimeve kapitale në raport me vitin paraprak për 26%, ka përfshirë rritjen

e pensioneve për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës, mirëpo ajo është e drejtë e juaj për të votuar “kundër”

Ndërsa, sa i përket trendit të hyrave, besoj që nganjëherë një grafik flet më shumë se shumë fjalë dhe këtu po i paraqes të hyrat e doganës nëpër vite, duke filluar nga viti 2007. Ju e keni marrë raportin 6-të mujor të ekzekutimit të buxhetit dhe e shini që doganat e Kosovës dhe Administrata tatimore e Kosovës, 6-të mujorin e parë të këtij viti, krahasuar me 6 mujorin e njëjtë të periudhës së vitit 2010, ka realizuar 20% më tepër të hyra. Ndërsa, sa i përket ekzekutimit të buxhetit, del se investimet kapitale, në raport me periudhën e njëjtë të viti paraprak, kanë pas një ngritje prej 55%.

Buxheti i Kosovës është aprovuar në muajin prill dhe nuk ka pasur as ndonjë arsye, as kërkesë që t’i hyjmë rishikimit të buxhetit mbas një muaj dite. Ligji i buxhetit jep fleksibilitet të mjaftueshëm organizatave buxhetore për ta ekzekutuar buxhetin, përkatësisht neni 14 dhe 15 i Ligjit të buxhetit.

Ndërsa, tani ne jemi në fazën finale të përgatitjes së buxhetit për vitin 2012, dhe ne në tetor do ta aprovojmë në Kabinetin qeveritar buxhetin e vitit 2012, do të thotë, ta procedojmë në Kuvend. Ndërsa, sa i përket qëndrueshmërisë buxhetore, ju e vëreni se edhe në raportin 6 mujor, ne kemi arritur që të mbledhim më tepër të hyra se sa të shpenzojmë, ndërsa sa i përket pjesës së fundit të tabelës të parë të buxhetit që ka të bëjë me financimet e njëhershme, varësisht prej zhvillimeve që do të ndodhin, ato nuk do të efektojnë ekzekutimin e buxhetit, mirëpo do të efektojnë në pjesën, varësisht se qysh do të jetë rezerva buxhetore në fund të vitit, varësisht prej zhvillimeve që do të ndodhin në pjesën e burimeve që janë si financim i njëhershëm për buxhetin e Kosovës.

Prandaj, në Kosovë ekziston qëndrueshmëria buxhetore, në Kosovë paguhen të gjitha obligimet në kohë dhe ne kemi arritur që të mbledhim më tepër të hyra dhe ta ekzekutojmë buxhetin më mirë se sa periudhat e njëjta të vitit paraprak dhe të viteve tjera paraprake. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti deputet? Zoti Ymeri e ka fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit! E falënderoj ministrin për këto këshilla që na i dha profesionale, edhe pse nuk e di që të kemi punësuar për të na këshilluar, por faleminderit që po e bën këtë pa para. Unë pyetjen që e shtrova, i përmenda disa çështje të cilat dalin nga raporti 6 mujor për shpenzimet buxhetore dhe aty shihet që të hyrat nuk janë konform planifikimeve tuaja për të hyra. Pra, ju na treguat që janë rritur të hyrat për vitet paraprake dhe po ashtu që janë rritur investimet kapitale, por ne po flasim për buxhetin e këtij viti dhe për domosdonë e rishikimit të këtij buxheti, e ky rishikim i buxhetit është i domosdoshëm në dy aspekte, në njërin anë, se raporti juaj thotë që jeni prapa sikur në të hyra, po ashtu edhe në shpenzime, të linjave apo zërave buxhetore, të cilat janë miratuar në këtë Kuvend në mars dhe, e dyta, është që tashmë e dimë që një pjesë e të hyrave të planifikuara atëherë, e kanë humbur rastin që të vijnë në buxhetin e Kosovës, sivjet.

Prandaj, një rishikim i tillë është i domosdoshëm për shkak se edhe të hyrat të cilat janë të planifikuara me buxhet, nuk janë reale, por edhe shpenzimet po duken që nuk janë reale ose...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e doni fjalën?

BEDRI HAMZA: ...është Qeveria e Kosovës, prapë unë e vlerësoj atë bindjen e juaj për t'i dhënë mendimet e juaja dhe të votoni sipas asaj që ju e vlerësoni, mirëpo të hyrat për buxhetin e Kosovës dhe të hyrat që i administrojnë doganat dhe Administrata Tatimore e Kosovës nuk ndahen me 1/12 dhe asnjëherë historikisht nëse iu referohemi të dhënave dhe raporteve të cilat i publikon Ministria e Financave, nuk del se të hyrat 50% mbledhen në pjesën e parë të vitit dhe 50% mbledhen në pjesën e dytë të vitit. Qëndron fakti se për periudhën e parë të këtij viti ka pasur 20% të hyra të mbledhura më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Ndërsa, në raport me planin, referojuni, ju lutem, të dhënave historike dhe raporteve që publikohen, del se zakonisht në pjesën e dytë e vitit mbledhen më tepër të hyra se sa në pjesën e parë e vitit, prandaj trendi i të hyrave është mjaftë inkurajues, është pozitiv, ekzekutimi i buxhetit është më i mirë se çdoherë, çdo vit, çdo periudhë më herët dhe ne ju kemi dhënë fleksibilitet edhe komunave, edhe ministrive, bazuar në Ligjin për buxhetin që ato ta ekzekutojnë buxhetin dhe ne jemi në fazën finale të përgatitjes së buxhetit, për vitin 2012. Prandaj, te pjesa e financimeve të njëhershme për buxhetin, e thashë, po e ri përsëris që varësisht prej këtyre zhvillimeve, do të ketë ndikim në lartësinë e rezervës buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe kjo pikë e rendit të ditës u shqyrtua. Tani fillojmë me miratimin e ligjeve në lexim të dytë. Dua të kërkoj mirëkuptim dhe në qoftë se jeni të mendimit që t'i kalojmë me procedurë më të përshtetshme, që të mos kërkojmë votim elektronik, të votojmë me dorë kur është "kundër", duke përjashtuar amendamentet të cilat janë të kërkuara nga grupet parlamentare, të cilat duhet të votohen me elektronik për shkak të korrektësisë dhe arsyeshmërisë së miratimit të tyre. A jeni "për"? Kërkoj një deklaram. "Kundër", s'ka. Ok

Atëherë, në radhë është:

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia kanë parashtruar raportet me rekomandime. Ftoj kryetarin e komisionit funksional, deputetin Idriz Vehapi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime, nëse kuptohet e shihet të arsyeshme. Zoti Vehapi, e keni fjalën!

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Projektligji ka kaluar fazën e Amendamentimit edhe komisionet e përhershme e kanë dhënë fjalën e vet dhe është i gatshëm për procedim, me përjashtim që deputeti Ramë Vata i ka pasur dy plotësime të projektligjit, në disa nene dhe ai do ta marrë fjalën kur të vjen rendi i shqyrtimit të atyre paragrafëve ose neneve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, fillojmë me votimin.

Amendamenti 1

A ka “kundër” dikush? S’ka. Abstenim?

Miratohet.

Prezentë janë 64 deputetë në sallë.

Amendamenti 2

“Kundër” a ka? Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Amendamenti i 3

“Kundër”, s’ka. Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti...

Zoti Vataj, urdhëro, zoti Vataj e ka kërkuar fjalën.

RAMË VATA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë do ta marr fjalën te amendamenti 25.

KRYESUESI: Ok... në rregull...

Amendamenti 4

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 5

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 6

“Kundër” s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 7

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 8

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 9

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 10

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 11

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 12

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 13

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 14

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 15 “kundër” s’ka, abstenim s’ka. Miratohet.

Amendamenti 16

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 18

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 20

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 21

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 22

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 23

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 24

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 25, zoti Vataj e ka kërkuar fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e kam një amendament 25, që do të hyjnë, ndërsa i 25-ti që e kanë deputetë do të jetë 27, sepse janë dy.

Po e lexoj vetëm paragrafin 3, të nenit 18, ku thotë, një pjesë: “ Një numër i anëtarëve të zgjedhur nga universiteti duhet të jenë nga komunitet akademik ndërkombëtar”. Komisioni ka rënë dakord, por me siguri ka qenë një gabim teknik. Nuk duhet të jetë fjala “duhet”, por do të jetë “mund”, domethënë, nuk do të jetë obligative, duhet patjetër të kemi akademikë ndërkombëtarë në bordin e universitetit, pra ky është amendamenti i 25, fjala “duhet” zëvendësohet me fjalën “mund”.

Dhe, amendamenti 26, që vazhdon neni 19, paragrafi 1, unë po e lexoj vetëm formulimin që ndryshon vetëm një fjalë nga fundi, kështu do të jetë, “...autoriteti kryesor menaxherial i një universiteti publik është rektori. Rektori i universitetit publik zgjidhet nga këshilli drejtues, me shumicën absolute të numrit të përgjithshëm të votave pas një procesi formal të konkursit publik, pas vlerësimit nga një komision profesional dhe pas intervistimit nga i tërë këshilli drejtues i universitetit”. Ky është edhe pëlqimi i komisionit, pra këto dy janë amendamenti i 25 dhe 26, që nuk i kanë deputetët për shkak të lëshimeve teknike, gjatë bartjes nga personeli i komisionit. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Janë çështje teknike dhe besoj s’ka kundër. Deklarimi i kryetarit të komisionit, zoti Vehapi, a keni vërejtje ju?

IDRIZ VEHAPI: Nuk kemi vërejtje, kështu ne jemi marrë vesh edhe në komision, por administrata gjatë përshkrimit të propozimeve, sigurisht ka qenë një lëshim teknik. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull, atëherë me vërejtjet e kryetarit të komisionit dhe të zotit Vataj, vërejtjet që u dhanë duhet të miratohen për shkak se janë... Zoti Hamiti e kërkon një sqarim.

SABRI HAMITI: Nuk janë formale, as nuk janë teknike, po këto janë propozim i dy amendamenteve të reja dhe, të lutem, qiti në votim, pyeti njerëzit, sepse ndryshe s’kalojnë. Se këto janë dy amendamente të reja, që janë përtej amendamenteve që i ka kaluar komisioni, le të jetë dhe gabim dhe mungesë e evidentimi. Zoti Vataj propozoi dy amendamente, thelbi i tyre është që në bordin e Universitetit mund të ketë të huaj, jo duhet të jetë si obligacion dhe, e dyta, është që te zgjedhjet, amendamenti i dytë i tij është, problemi i kompanisë konsulente të ekspertëve të jashtëm, prapë mundet, por s’është domosdo. Kjo është

esenca e zotit Vatës që i propozoi, pra janë dy dhe, të lutem, qiti në votim këto dhe pastaj vazhdo me tjerat!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hamiti, për ndihmën!
Atëherë, po i nxjerr në votim një nga një.

Amendamentin 25, i propozuar nga zoti Vataj,
Kush është “për”? “Kundër” a ka? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 26, i propozuar prapë nga zoti Vataj,
Kush është “për”? “Kundër”, s’ka.
Miratohet.

Atëherë, sipas renditjes, vazhdojmë me amendamentin, siç u propozua.
Në sallë janë 84 deputetë.

Amendamenti i 27, vjen me radhë.
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 28
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 29
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 30 “kundër” s’ka, abstenim s’ka. Miratohet.

Amendamenti 31
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 32 “kundër” s’ka, abstenim s’ka. Miratohet.

Amendamenti 33
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 34
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

S'ka amendamente tjera. Atëherë, votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitën për votim, votojmë tani!

Faleminderit! Konstatohet që me 77 vota "për", 1 votë "kundër", Kuvendi miratoi Ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

Pika e katërt e rendit të ditës është:

4. Shqyrtimi i Projektligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit i kanë parashtruar raportet me rekomandime.

Ftoj kryetarin e komisioni funksional, deputetin Idriz Vehapi, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Edhe Projektligji për arsimin parauniversitar i ka kaluar të gjitha procedurat e nevojshme për amendamentim dhe për lexim të dytë. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në Raportin e komisionit funksional. Zoti Gashi, jeni paraqitur për më vonë apo tani menjëherë?

ARBEN GASHI: Në emër të komisionit.

KRYESUESI: Po, zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Komisioni për Legjislacion ka trajtuar amendamentet dhe ka arritur në konkluzionin se amendamentet 3, 19 dhe 25 janë në kundërshtim me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe amendamenti 8 është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, prandaj ju kërkohet që këto të mos merren në konsideratë si amendamente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kur të vijmë aty, është mirë që të diskutohet dhe për atë e thashë edhe në fillim që të votojmë me elektronikë këto amendamente që nuk i kanë kaluar komisionet funksionale. Faleminderit!

Vazhdojmë me votimet.

Amendamenti 1

"Kundër", s'ka, abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 2

"Kundër", s'ka, abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 3,

I propozuar nga Grupi Parlamentar “6+”, pa përkrahjen e komisionit funksional dhe Komisionit për Legjislacion.

Për ta arsyetuar amendamentin, fjalën e ka kërkuar Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Dëshiroj veç të jap sqarimin pse e kemi propozuar si grup këtë ndryshim, te amendamenti i 3-të. Kur flitet për këtë pikë të projektligjit, flitet për gjuhët e arsimit për komunitetet jo shumicë, por në draft, në projektligj thuhet që: “gjuhët jo zyrtare janë gjuhët të cilat fliten në Republikën e Kosovës, përveç të dy gjuhëve zyrtare”. Prandaj, ne kemi kërkuar që të zëvendësohen këto fjalët “gjuhë jo zyrtare” me fjalët “gjuhët e komuniteteve”, sepse gjuhë jo zyrtare nuk ekziston as në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, as në Ligjin për përdorimin e gjuhëve kur flitet për arsimimin.

Neni 59, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kur flet për arsimimin e komuniteteve jo shumicë, shumë qartë thotë që: “komunitetet kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e komuniteteve, në gjuhën amtare”, kurse neni 20 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, ku flet për arsimimin e komuniteteve jo shumicë, thotë që: “Në Republikën e Kosovës komunitetet kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e tyre amtare”, prandaj kërkesa ka qenë jo diçka ekstra të futim që ndikon edhe në buxhetin, por në Kushtetutë dhe në ligj kur flitet për arsim për komunitetet, ku thuhet: “Gjuhët e komuniteteve”, të zëvendësohet me “gjuhët jo zyrtare”, sepse nuk ekziston kjo terminologji.

E për nenin 25, prapë do të marr fjalën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Hamiti e ka kërkuar fjalën. Për amendamente keni të drejtë të diskutoni.

SABRI HAMITI: Unë s’dua ta komentoj amendamentin, por interpretimin. Ekziston një Ligj për përdorimin e gjuhëve zyrtare, po le të thuhet që ekzistojnë dy terme, “gjuhë zyrtare” janë shqipja dhe serbishtja, ekziston termi në legjislacionin tonë, i diskutuar gjatë dhe i votuar me probleme të mëdha, por i votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, është edhe termi “gjuhët në përdorim zyrtar”. Masandej, shumë saktë është e precizuar cilat janë gjuhët në përdorim zyrtarë, është një status që ka të bëjë kryesisht me këto që po flet zoti Kervan, saktësisht kjo është, domethënë, ai term ekziston në legjislacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe pikërisht ka këtë funksion që kap jo vetëm arsimin, por kap edhe problemin e administratës, shkon edhe një hap më tej, kështu që unë kisha vetëm këtë precizim. Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arben Gashi e ka kërkuar fjalën.

ARBEN GASHI: Po, faleminderit!

Komisioni e ka diskutuar gjatë këtë çështje dhe ka ardhur në konkluzionin që mënyra qysh është draftuar ky amendament, është në kundërshtim me Ligjin e përdorim të gjuhëve në Republikën e Kosovës, prandaj “gjuhë e komuniteteve” dhe si term është një term shumë i gjerë dhe bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet tjera dhe nuk mund të përdoret në këtë legjislacion, prandaj nuk duhet të përkrahet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministri Yagcillar.

MAHIR YAGCILLAR: Zoti nënkryetar,
Të nderuar deputetë,

(Ndërhyrje, Sabri Hamiti)

Ministri ka drejtën të flet, për këto çështje ka të drejtë! Për këtë çështje kam folur edhe në Qeveri dhe mund me shpreh mendimin, edhe unë jam me ju zoti Sabri Hamiti, sepse...

(Ndërhyrje, Sabri Hamiti)

... Unë sa e di si ministër, në çdo kohë kam të drejtë të flas!
Unë dëshiroj të shpjegoj se, në qoftë se amendamenti nuk është në pajtim me Kushtetutën ose me ligjin, atëherë edhe neni në ligj nuk është, sepse nuk ekziston termi “gjuhë jo zyrtare”. Mund të thuhet “gjuhë në përdorim zyrtar”, “gjuha e komuniteteve”, sepse ekziston, mund ta gjeni edhe në Kushtetutën edhe në ligjin, në shumë paragrafe, ku thuhet “gjuhët e komuniteteve”, por kurrëgjë askund nuk mund ta gjeni “gjuhë jo zyrtare”. Kështu që për këto çështje ose amendamentim ose duhet të bëhet një rishikim i neni, në ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Hamza Balje.

HAMZA BALJE: Zahvaljujem, predsedavajući!

Što se tiče preduniversityskog obrazovanja i pošto je ovo drugo razmatranje ovog zakona, hteo bih da istaknem da, po Ustavu, član 59. paragraf 3. Prava zajednica, znači ne kaže se neslužbeni jezici, prava zajednica, koji glasi – „pripadnici zajednica imaju pravo pojedinačno ili u okviru zajednica da se školuju u osnovnim i srednjim školama“, znači obaveza, „na svom jeziku, koji je propisan zakonom, po članu 20. a troškove će snositi nadležni organi, odnosno ministarstva“.

Amandament broj 3, zamjena termina „neslužbeni jezici“, koji je bio dosta diskriminatorski sa terminom „jezici zajednica“, mislim da se donose korenite promjene i izmjene i sadržina ovog amandamenta, gdje zajednice napokon dobijaju svoje pravo mjesto i terminologiju, gdje ponovo ističem, ne krši se niti Ustav, niti zakon nego se daje legitimitet zajednicama po važećem Ustavu i zakonu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Adem Grabovci e ka kërkuar fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e mbështesim propozimin e Grupit Parlamentar „6+“.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, nuk ka tjerë të paraqitur, vazhdojmë sipas Rregullores së Kuvendit. Si fillim, duhet ta qesim në votim mendimin e dy komisioneve, domethënë të komisionit funksional dhe të Komisionit për Legjislacion, i cili thotë që: “të mos miratohet”, nuk e përkrah. Votojmë mendimin e komisionit funksional dhe të Komisionit për Legjislacion. Votojmë tani. Regjia, votojmë tani.

E qartë është shumë mirë, nuk kalon propozimi i komisionit funksional dhe i Komisionit për Legjislacion. A doni ta përsërisim edhe njëherë votimin?

(Ndërhyrje)

Unë ju thashë, si rregull, në Kuvendin e Kosovës, meqenëse është për një pjesë të madhe të deputetëve pak problematike, si rregull, në komisionin funksional dhe Komisionin përkatës të Legjislacionit kanë dhënë një mendim, kundër propozimit të Grupit Parlamentar “6+”. Si rregull, në Kuvendin e Kosovës në fillim hudhet në votim propozimi i komisionit funksional dhe i Komisionit për Legjislacion, do të thotë, votohet “për” ose “kundër” në fillim të propozimit të komisionit funksional dhe të atij për Legjislacion.

Pra, votojmë tani, kush është “për” mendimin e komisionit funksional dhe të atij për Legjislacion, voton “për”, kush është kundër mendimit të tyre dhe është për propozimin e Komisionit “6+” voton “kundër”. Votojmë tani.

KRYESUESI: Faleminderit!

Bie propozimi i komisionit funksional dhe i Komisionit për Legjislacion, miratohet amendamenti i 3-të i Grupit Parlamentar “6+”.

(Reagim)

Nejse... okej, e qesim në votim, pra. Por, me vota... votat e përcaktojnë qashtu. E qesim tani në votim amendamentin 3 të Grupit Parlamentar “6+”, me votim elektronik.

Kush është “për” dhe kush është “kundër”, votoni!

Faleminderit!

Me 46 vota “për”, 3 abstenime dhe 38 vota “kundër”, miratohet amendamenti i 3-të i Grupit Parlamentar “6+”. Faleminderit!

Amendamenti 4

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 5

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 6

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Është radha e amendamentit të 7-të, që është në emër të grupeve parlamentare. SLS, “6+” dhe “Kosova e RE”, pa përkrahjen e komisionit funksional. E kërkon dikush fjalën, për të sqaruar lidhur me këtë nen? Ardian Gjini është paraqitur.

ARDIAN GJINI: Faleminderit zoti kryesues!

Është shqyrtuar edhe në komisione të ndryshme, edhe në komisionin ku unë bëj pjesë, që udhëhiqet nga zoti Arben Gashi për Legjislacion. Edhe pse nuk ka ardhur ndonjë vërejtje, ne mendojmë se ky amendament provon t’i lidhë duart e ekzekutivit, në mënyrë që mos të ketë të drejtë të marrë vendime, të cilat do të mund të interpretoheshin krejt ndryshe më vonë. Do të thotë, propozohet që përmes një amendamenti, nëpër një derë të vogël të futen temat, të cilat do të jenë jashtëzakonisht të dëmshme si për sistemin e qeverisjes në Kosovë, ashtu edhe për temat tjera të cilat do të mund të rrjedhin nga kjo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, e njëjta gjë ... Deputeti Amir Ahmeti.

AMIR AHMETI: Faleminderit, kryesues!

Përsëritje për Kabinetin Qeveritar,
Deputetë të nderuar,

Në komisionin ku kemi qenë bashkë me zotëri Gjinin dhe me të gjitha partitë parlamentare, Komisioni për Legjislacion e ka miratuar këtë amendamentin e 7-të, që është në përputhje me Kushtetutën dhe besoj që nuk ka nevojë të diskutojmë më tepër. Ju faleminderit! Ta votojmë, pra!

KRYESUESI: Deputeti Mustafa e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: Ky amendament, në fakt, unë nuk mund të kuptoj çfarë dere hap një amendament, i cili sugjeron që në institucionet arsimore, publike apo private të përmbahet çdo lloj i diskriminimit fetar apo etnik dhe që sugjeron që të luftojmë kundër urrejtjes ndëretnike fetare. Unë nuk mund të kuptoj, çfarë dere të keqe mund të hap një përmbajtje e tillë? Më falni!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Gjini, kërkon edhe një sqarim shtesë.

ARDIAN GJINI: Po, mendoj se nëse po flasim për diskriminim dhe mbrojtje ndaj diskriminimit, Kosova mendoj se i ka provizionet më të qarta kushtetuese, të paktën në rajon sa i përket kësaj çështjeje, domethënë kemi provizione të sakta dhe të qarta

kushtetuese për mbrojtje ndaj diskriminimit dhe vetë fakti që dikush kërkon një provizion të këtillë ta fusë në ligj, e hap derën për interpretime të vazhdueshme se çka do të mund të jetë diskriminim dhe çka nuk do të jetë diskriminim.

Do të thotë, fillimisht është totalisht e panevojshme që një provizion i tillë të jetë provizion ligjor në Ligjin për arsim.

Dhe, e dyta, edhe një herë po them, hap çështje të interpretimit se çka nënkupton diskriminim dhe çka nuk nënkupton diskriminim. Domethënë, këtu flasim për një diskriminim, që dikush dëshiron të na mbrojë, ndërsa haptas dëgjohet që kërkohet të diskriminohet diçka tjetër.

Unë personalisht nuk po provoj për t'ju dhënë shembuj, për shkak se do të ishte gabim të jepen shembuj, mirëpo deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë tepër të qartë që ata që po provojnë të mbrojnë prej diskriminimit, në Kuvendin e Kosovës shumë shpesh kanë folur me gjuhë diskriminuese. Faleminderit!

Edhe një herë po e thërras Kuvendin mos ta votojnë propozimin e deputetëve, për shkak se nuk është në frymën e legjislacionit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, zoti Mustafa, prapë e keni kërkuar fjalën...?

MUHAMET MUSTAFA: Mendoj që ka shumë logjikë që në sistemin e arsimit tonë të kemi një përmbajtje të tillë, një amendament me përmbajtje të tillë, për arsye se sistemi i arsimit duhet të mundësojë qasjen, pa diskriminim, të gjithë kosovarëve, në të gjitha nivelet. Prandaj, ne me këtë e sigurojmë një qasje të barabartë të njerëzve në edukimin e tyre, në institucionet publike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, e qesim në votim. E njëjta gjë vlen edhe për këtë amendament. Në fillim e qesim në votim amendamentin e komisionit funksional, i cili nuk e përkrahë amendamentin 7. Zoti Vehapi e do fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, shumë!

Unë kujtoj se edhe gjatë votimeve të kaluara janë bërë gabime, sepse deputetët nuk kanë kuptuar. Qitet në propozim amendamenti i propozuesit apo mendimi i komisionit dhe ka pasur paqartësi dhe është votuar gabimisht. Sepse, Komisioni për Legjislacion, në qoftë se e ka hedhur poshtë një amendament për shkaqe se është në kundërshtim me Kushtetutën ose me ligjet në fuqi, atëherë si ka mundësi që këta deputetë ta votojnë atë amendament dhe ta bien në fuqi në një ligj tjetër.

Edhe unë them që të qitet amendamenti në propozim me përkrahje ose pa përkrahje të komisionit, ashtu siç është i propozuar nga komisionet, qofshin funksionale apo të përhershme. Dhe, mos na qitni në dilema tani këtu, të kemi dilema, u paraqit propozimi si duhet apo jo. Domethënë, ka amendamente të përkrahura nga komisioni dhe ka amendamente që nuk i ka përkrahur komisioni dhe kështu të jemi të qartë.

KRYESUESI: Në rregull është, zoti Vehapi.

Si rregull është, gjithmonë qitet në votim amendamenti pa ose me përkrahje por, meqenëse ishte kërkesa e një grupi parlamentar, unë e respektova kërkesën dhe nuk ka, besoj, asgjë të keqe. Fjalën e ka kërkuar kryeministri zoti Thaçi!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë dëshiroj vetëm të sqaroj diçka që e dini të gjithë, që të mos ketë keqinterpretime. Jo diskriminimi është i garantuar me Kushtetutë, me ligje dhe me standarde evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani votojmë amendamentin... Zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën, më fal zoti Zemaj, se s'të pashë!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Sinqerisht, është për të ardhur keq se si zhvillohet edhe votimi me dy standarde, që kemi standarde të dyfishta. Në njërën anë, ku shumica bën pjesë në komisionet funksionale, koalicioni qeverisës e ka shumicën dhe e ka prurë këtu pa përkrahjen e komisionit funksional, ndërsa këtu në seancë neve na qet para një pozite të pa lakmueshme, gjëja se po bëhen lojëra politike, të cilat vetëm e dëmtojnë procesin dhe nuk i zhvillojnë as institucionet publike arsimore. Vetë neni 7 e ka përmbajtjen të qartë. Çdo kush në Kosovë është kundër diskriminimit, por esenca është pak më ndryshe dhe ju po i ikni kësaj. Prandaj, nuk mundemi kështu të vazhdojmë me standarde të dyfishta.

Komisioni funksional, të cilin e përbën shumica, e ka dhënë pa përkrahjen. Pse e ka dhënë pa përkrahjen, neve të na qesë para një dileme të tillë. Atëherë, po kemi edhe disharmoni mes neneve. Ne e përkrahim nenin, se askush nuk është kundër diskriminimit, por arsyeja është se po luhen standarde të dyfishta dhe do të duhej të njoftojë dhe ta marrë vesh edhe opinioni, edhe të gjithë deputetët që janë këtu të pranishëm.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Haziri e ka kërkuar fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar dhe kryesues i seancës!

Vetëm të them edhe një herë, normalisht që Kushtetuta garanton jo diskriminim ndaj etnive dhe feve në Kosovë dhe nuk e di pse duhet gjeneruar edhe me ligje tash, por kjo po nënkuptohet pse.

Zoti kryeministër, diskriminuese është kur ministri juaj Yagcillar ulet kundrejt ministrit të Arsimit të Kosovës, në krah të ministrit turk, është diskriminuese ndaj vendit të vet, ndaj Qeverisë së vet, ndaj ligjeve të veta. Edhe ky po vazhdon prapë të sillet në mënyrë diskriminuese në proces të votimit. Kjo është diskriminuese. I themi sendet qartë, mirë, drejt. Kështu është, kështu po ndodhë, mos ta lejojmë të diskriminohet shumica dhe të tjerët këtu edhe me sjellje, edhe me qasje, edhe me mënyrën e tillë të angazhimit. Natyrisht, që unë e përkrah çdo vendim që nuk e njeh diskriminimin, ksenofobinë dhe racizmin. Dhe, ky Kuvend i bën nder vetvetes, por ministrat e pakicës le të mësohen të sillen në mënyrë jo diskriminuese ndaj të tjerëve, sepse tipi është ministër i Kosovës, dhe

nuk ka të drejtë asnjëherë të shkojë të ulet kundër ministrit të vet. Nuk e di pse, ministri Buja shuan. Ose pse pranon që kolegu i vet t'i ulet përballë me kërkesa diskriminuese. Kërkesë diskriminuese është ajo. Ministër duhet të jetë, po bën kërkesa diskriminuese dhe po sheh që është diskriminim këtu. Kjo është ajo qasje që duhet në natën e madhe të Bajramit të themi dhe në raport me këtë, unë e votoj çdo politikë që e njeh angazhimin jo diskriminues. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Sahatqija e ka kërkuar fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Kryesues, ky amendament thotë: “institucionet shkollore publike dhe private duhet të përmbahen nga çdo lloj i diskriminimit fetar apo etnik, si dhe përhapja e urrejtjes ndërfetare dhe etnike”. Neni 21 dhe 22 i Kushtetutës sonë flasin jashtëzakonisht qartë për parimet e përgjithshme, për të drejtat dhe liritë themelore, ku thuhet që Kushtetuta dhe Republika e Kosovës mbrojnë dhe garantojnë të drejtat. Në qoftë se në amendament thuhet që duhet të përmbahen nga çdo lloj diskriminimi, atëherë po fitohet përshtypja që në shkollat tona ekziston diskriminimi ndërfetar apo etnik. Përkundrazi, mendoj që në popullin tonë, është popull ndoshta unik, në të cilin toleranca ndërfetare është tolerancë, ku duhet të merret shembull. Prandaj, mendojmë që ky nen përkundrazi nuk krijon përmbajtje nga diskriminimi, por tregon që aty ka diskriminim dhe që me ligj mbi Kushtetutë duhet të rregullohet. Kjo është e rregulluar me Kushtetutë dhe Kushtetuta është mbi çdo ligj edhe mendoj që kjo nuk e ka vendin këtu.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kryeministri, zoti Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë, përsëri theksoj, interpretimin e Kushtetutës e bën Gjykata Kushtetuese dhe jo ne. Dhe, për fat të mirë, e kemi dëshmuar respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të gjithë dhe e kemi përvojën të mirë apo të hidhur, por e kemi.

Me rëndësi është që të gjithë i kemi akceptuar ato vendime, prandaj formulimet e qarta kundër diskriminimit etnik dhe fetar janë në interes të tolerancës, mirëkuptimit dhe integritetit. Ndërsa, unë i kuptoj transformimet ekstreme të njerëzve, por nganjëherë duhet të kuptojmë qartë, a po flasim këtu si deputetë të zgjedhur nga një parti politike prej qytetarëve, apo si haxhi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Për replikë e ka kërkuar fjalën zoti Yagcillar, ministri Yagcillar.

MAHIR YAGCILAR: Faleminderit zoti nënkryetar!

I nderuari kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar deputetë,

Vërtet ka qenë ministri i arsmit, ka ardhur me ftesën time. Ndoshta ka ndodhur gabim, unë pranoj, por nuk ka qenë kurrfarë qëllimi të bëhet diçka jashtë agjendës ose jashtë

diçka çka kemi vepruar. Ju e dini, unë jam qe dhjetë vjet në Parlamentin e Kosovës edhe gjithmonë kam punuar për bashkë me ju për pavarësinë e Kosovës dhe për të drejtat e komunitetit turk.

Sa i përket pjesës tjetër, unë jam i mendimit, unë nuk jam me profesion jurist, por në qoftë se Komisioni i Legjislacionit ka një kundërshtim, duhet thirr në cilin nen të Kushtetutës dhe të ligjit. Në këtë aspekt, prapë për nenin, për gjuhët jozyrtare. Në qoftë se mund të gjeni diku që ekziston termi “gjuha jozyrtare” në Ligjin për përdorimin e gjuhëve ose në Kushtetutën e Kosovës, unë jam me ju dakord.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Po ngatërrohem në një çështje, në të cilën s’do të duhej të ishim ngatërruar. Është propozuar një amendament, i cili nuk ka përkrahjen e komisionit funksional dhe ky amendament objektivisht nuk e ndryshon ose nuk e sqaron sa e ndryshon nenin 7, që thotë se institucionet arsimore përmbahen nga mësimdhënia fetare ose veprimtaritë tjera, të cilat propagojnë një fe të caktuar. Ky nen, këtë materie e kthen në diçka tjetër. Institucionet shkollore publike dhe private duhet të përmbahen, veni re: “duhet të përmbahen nga çdo lloj i diskriminimit fetar apo etnik, si dhe përhapja e urrejtjes ndërfetare e etnike”. Diskriminimi fetar e etnik dhe përhapja e urrejtjes fetare etnike nuk është diçka morale që duhet të kërkohej të përmbahet, është e dënueshme dhe Kushtetuta dhe ligjet e dënojnë diskriminimin fetar. Ne kemi diskriminimin, po ashtu diskriminimet tjera dhe përhapjen e urrejtjes, prandaj si amendament nuk mund të përkrahet edhe kështu, sepse nuk është i mjaftueshëm. E zbutë, siç u tha, dhe krijon përshtypjen sikur shkolla jonë është plotë diskriminim e urrejtje fetare, e tjera, po tash duhet të zbutet e të përmbahet. Nuk është adekuate.

Por, nëse insistohet që të jenë edhe sanksionet kundër diskriminimit në shkollë, nuk shoh gjë të keqe, por në atë rast duhet të mbetet amendamenti në ligj siç është, që është përkrahur nga komisioni funksional dhe t’i shtohet “institucionet shkollore publike dhe private përjashtojnë çdo lloj diskriminimi fetar” ose tjera. Kjo “përjashtojnë” është megjithatë një gjuhë juridike, por kjo nuk e përjashton njërin-tjetrin. Prandaj, mendoj që si propozim alternativ të mbetet amendamenti 7, jo amendamenti, më falni, paragrafi 7 i nenit 3 dhe kësaj t’i shtohet, nëse pajtohet edhe komisioni, formulimi që të përjashtohet diskriminimi fetar dhe nxitja e urrejtjes. Është në Kushtetutë, është në ligje, por thonë s’ka gjë të keqe të përsëritet diçka e mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Gjini e ka kërkuar fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit zoti nënkryetar. Po të kërkoj ndjesë, që po e marr fjalën edhe një herë!

Çështje e parë është: U diskutua dy herë edhe po kam nevojë për të thanë para Kuvendit të Kosovës. Gjuhët jozyrtare janë gjuhë në të cilat mund të mësohet në Kosovë. Nuk janë të gjitha gjuhët, që mësohen në Kosovë sot. Keni fëmijë nëpër shkolla në gjuhë angleze, e askund nuk shkruan që gjuha angleze është në përdorim jozyrtar. Domethënë, ministër, shpjegimin e keni të dobët. Nuk jemi kundër asaj çka po kërkonit të ndodhë në Kosovë, por shpjegimet po i bëni të çuditshme, dhe me vet faktin që po i bëni shpjegime të çuditshme, po na bëni për të dyshuar çfarë qëllimi keni. Merruni vesh mes veti edhe bëni shpjegimet qysh doni t'i bëni.

Dhe, çështja tjetër është se është totalisht e panevojshme të jetë amendamenti 7 pjesë e ligjit. Dy komisione nuk e kanë përkrahur. Edhe ne po ju themi, mos e votoni, për shkak se kemi për të ardhur në situata të interpretimeve shumë të këqija për këtë ligj edhe qëllimi i këtij amendamenti është i keq. Qëllimi pse po futet ky amendament, është kundër rrugës të cilën e ka zgjedhur populli i Kosovës. Mbani në mend, nuk guxojmë të bëjmë kështu. Ky Kuvend mbanë përgjegjësi. Por çka do të bëjë pse 3 deputetë po lypin këtu diçka të bëjnë. Edhe të jemi të qartë njëri me tjetrin, ta shohim a duam ta votojmë a s'duam ta votojmë. Zoti nënkryetar, po të lus ta qesësh në votim amendamentin 7, qysh e ka propozuar grupi i deputetëve, pa mbështetjen e komisioneve dhe po votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Vataj, e ka kërkuar fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Po mendoj që ka nevojë për një sqarim, sepse këtu është fjala, një nen që ka ardhur me ligj, 8 alinea 3.7. Është përballë një nen që është propozuar prej grupit punues të Ligjit për arsimin parauniversitar dhe dy amendamenteve që kanë ardhur nga këto grupet përfaqësuese. Pra, ky neni, amendamenti 7, ia qelë derën amendamentit 8, këtë duhet ta dallojmë pra. Deri sa thuhet që duhet të përmbahen, nuk ka mësim fetar nëpër shkolla, nuk ka nevojë të shtihet - ndalohet diskriminimi fetar e tjera, kur edhe më së pakti janë tri nene tjera, që ndalohet diskriminimi, si ndaj nxënësve që kanë përkatësi fetare, racore, gjinia, lloji, që janë mësuar me ato formulime, e kemi edhe për punëtorët, po ashtu ndalohet diskriminimi, pra ky amendament 7 është për t'ia qelë derën amendamentit 8 që vjen më pas. Kështu që, duhet t'i dallojmë paragrafin 7 të nenit 3, ndaj dy amendamenteve që janë bashkë. Nëse thuhet – nuk ka mësim fetar, nuk ka nevojë të pranohet as amendamenti 7 as 8, se i 7-i po thotë, në bazë të Kushtetutës dhe përvojave që i kemi përmend, i kemi diskutuar mjaft në komision. Pra, unë mendoj që duhet të shkojmë drejtë, ashtu si është propozuar, që u përkrah në Komisionin për Arsim ose dy amendamente që shkojnë i 7-i me të 8-tin. Shtatëshi është hyrje për të tetëshin. Nëse, një here thotë, Kushtetuta dhe ligji që ndalohet mësimi fetar, nuk ka nevojë, se diskriminimi përmendet më së paku edhe tri herë në këtë ligj që na ka ardhur neve, domethënë, të gjitha ligjet i kemi, ndalohet diskriminimi fetar, racor, përmbajtja, gjinia, lloji, racat, që janë banale gati... Kështu që, duhet të kalojmë drejtë, amendamenti 7 dhe 8, që janë bashkë, ndaj paragrafit 7 të nenit 3. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Amir Ahmeti e ka kërkuar fjalën.

AMIR AHMETI: Faleminderit kryesues, edhe njëherë!

Fillimisht, ato janë dy amendamente, nuk janë të bashkuara. Shtatëshi është i ndarë prej tetëshit. Votojmë shtatëshin, pastaj tetëshin. Dhe, e kisha lutur kryetarin e Komisionit për Legjislacion, zotri Arben Gashin, që të marrë fjalën dhe të tregojë se në Komisionin për Legjislacion, të gjithë bashkërisht, unanimisht e kemi miratuar, se amendamenti 7 nuk e shkel Kushtetutën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Desha të ndërlidhem në fjalimin e mëhershëm se ky amendament nuk është propozim i 3 deputetëve, por është propozim i 3 grupeve parlamentare. Dhe, në Komisionin e përhershëm për Legjislacion ka marrë miratimin e plotë, do të thotë ka kaluar në Komisionin për Legjislacion. Kështu që, ne mirëpresim nga kryesuesi i atij komisioni, Arben Gashi, ta demantojë deputetin parafulës, i cili tha - nuk ka kaluar në Komisionin për Legjislacion. Ky ka marrë miratimin e Komisionit për Legjislacion dhe nuk e di pse tash këtu po debatohet kaq shumë. Edhe është propozim i 3 grupeve parlamentare dhe jo 3 deputetëve.

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Gashi, si kryesues i komisionit.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Ne jemi para një situatë ku kemi diskutuar në komision dhe përmbajtja si e tillë e nenit, ku thuhet – amendamenti 7, që thotë: “Institucionet shkollore publike dhe private duhet të përmbahen nga çdo lloj i diskriminimit fetar apo etnik, si dhe përhapjen e urrejtjes ndërfetare etnike”, nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka në vetvete edhe Kartën Universale të të drejtave të njeriut, e cila parasheh ndalimin e çdo forme diskriminimi racor, fetar apo etnik, prandaj si e tillë nuk është në kundërshtim as me Kushtetutën, as me Kartën Universale për të mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe as me praktikën parlamentare, asnjë lloj kundërshtimi nuk ka.

Ndërsa, qëllimin si të tillë duhet ta arsyetojnë ata që e kanë sponsorizuar dhe Qeveria, që do ta përkrahë qëllimin pse e ka shti, pse është e nevojshme të jetë në Ligj për arsimin kjo. Kjo logjika se a duhet të jetë në ligj a s’duhet të jetë në ligj, është një çështje tjetër që duhet ta arsyetojnë këta, ndërsa si i tillë, si formulim, nuk ka asnjë lloj kundërshtimi me Kushtetutën, sepse Kushtetuta në vetvete parandalon diskriminimin etnik, fetar, racor, po ashtu edhe Karta universale për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të gjitha ligjet tjera pozitive si dhe Ligji që parandalon diskriminimin, ligjet tjera pozitive në Kosovë e ndalojnë. Se pse duhet të jenë në këtë ligj, le ta arsyetojnë të tjerët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Vataj e ka kërkuar fjalën edhe një herë.

RAMË VATAJ: Faleminderit! Jo... desha vetëm ...

KRYESUESI: Duhet të jesh pak më i ...

RAMË VATAJ: Deputeti Kelmendi, unë fola për komisionin, ku kam punuar, në Komisionin për Arsim, jo për Legjislacion. Dhe, në Komisionin tonë për Arsim, grupi punues, përveç propozuesit, domethënë që kanë qenë 3 të këtij koalicioni, që e kanë përkrahur këtë amendament, komisioni në tërësi nuk e ka përkrahur. Faleminderit! Unë fola për Komisionin për Arsim, jo për Komisionin për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka më replika. Fjalën e ka deputeti Blerim Shala.

BLERIM SHALA: Faleminderit, kryesues!

Mendoj që kemi ardhur në një moment kur po shihet që jemi goxha të aftë t'i përziejmë kodin e Kushtetutës, frymën e interpretimit të Kushtetutës me interesa tonë ditorë. Komisioni për Legjislacion e ka obligim ta mbrojë Kushtetutën, këtë e provoi ta bëjë pak më herët, kur ju si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës miratuat një amendament, i cili është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Nuk ka gjuhë të komuniteteve, ju lutem. Ka gjuhë zyrtare dhe ka gjuhë me përdorim zyrtar, kështu që keni bërë gabim të rëndë, e keni bërë prapë veten për t'ju dërguar në gjykatë Kushtetuese, dhe Gjykata Kushtetuese ka për ta rrëzuar vendimin e këtij Kuvendi.

Sa i përket amendamentit 7, Komisioni për Legjislacion dhe ne, si deputetë të Kuvendit të Republikës, reagojmë, kemi obligim të reagojmë nëse një materie nuk është adresuar qartë në mënyrë precize me Kushtetutën në fuqi, me legjislacionin në fuqi. Materia për të cilën provon të flasë amendamenti i 7, është absolutisht e kodifikuar në Kushtetutën e Kosovës, në legjislacionin në fuqi. Ne po krijojmë precedencë nëse votojmë për një amendament të tillë. Absolutisht, nuk ka nevojë të votohet për një amendament të tillë. Komisioni për Legjislacion e mbron Kushtetutën në çdo moment, nuk ka nevojë ta bëjë interpretimin e një neni, a është në kundërshtim apo jo me Kushtetutën. Ai komision dhe ne si deputetë e trajtojmë një materie vetëm nëse ajo nuk është adresuar në Kushtetutën e Kosovës dhe në ligjet në fuqi. Kjo temë është e adresuar, është e mbyllur, është e qartësuar dhe ky kuvend nuk ka nevojë ta votojë këtë amendament.

Edhe një fjalë të fundit. Jo vetëm shteti, kolegë të nderuar, edhe shoqëria, pra edhe shoqëria kosovare si e tillë i ka vijat e veta të kuqe, nuk bën t'i kalojmë këto vija të kuqe. Kemi një traditë të shkëlqyer të tolerancës fetare në Kosovës dhe ne e kemi obligim ta ruajmë atë traditë, atë tolerancë fetare, prandaj duhet të votojmë ashtu në pajtim me këtë traditë të shoqërisë kosovare dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me Kushtetutën në fuqi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani e qes në votim amendamentin 7, të propozuar nga grupet e lartcekura parlamentare, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë tani. Ju faleminderit!

Konstatohet që Kuvendi nuk e miratoi amendamentin 7, 39 vota janë “për”, 1 abstenim dhe 48 vota janë “kundër”.

Vazhdojmë me amendamentin 8.

Gjithashtu, propozim i Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, SLS dhe “6+” pa përkrahjen e komisionit funksional dhe të Komisionit për Legjislacion. Nuk ka të paraqitur për diskutim, apo u paraqit tash, kryetari i Komisionit për Legjislacion, zoti Gashi.

ARBEN GASHI: Ju faleminderit, i nderuar nënkryetar! Komisioni e ka shqyrtuar dhe ka mbërri në përfundim që është në kundërshtim me frymën e Kushtetutës dhe i ka rekomanduar seancës që të mos e aprovojë, sepse është në kundërshtim me ato parimet të cilat i ka vendosur Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ju kisha lutur që ta keni në konsideratë vlerësimin që mos të shkon vullnetarisht drejtë shkeljes së Kushtetutës qysh shkuat herën e parë. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Gjini është paraqitur.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Në këtë amendament është ma e qartë ajo që synohet të bëhet, se sa në amendamentin paraprak, edhe pse e kemi pasur të qartë të gjithë që synimi ka qenë për lejimin e shamive në shkollë. Përmes këtij amendamenti synohet që në shkollat publike të mësohet feja. Ky është qëllimi i këtij amendamenti.

Komisioni për Arsim, me plotë të drejtë nuk e ka mbështetur këtë amendament, edhe Komisioni për Legjislacion, ashtu si tha kryetari i Komisionit pak më përpara, konsideron se është një shkelje, e shkel Kushtetutën një propozim tillë. Arsytimi ka qenë se shkollat publike janë shkollat publike, aty mësohet shkencë, ndërsa feja mësohet në institucionet fetare dhe Kosova gjatë gjithë historisë së vet të ndërtimit të arsimit formal, pa marrë parasysh në cilat periudha të zorshme ka qenë ajo, qoftë në kohën kur kemi mësuar nëpër shtëpi, qoftë në kohën kur kemi mësuar nëpër institucione të ndryshme. Kosova ka ndërtuar një traditë mos ta ngarrojë mësimin e fesë me mësimin e shkencës. Arsytimet të cilat janë dhënë deri më tani, absolutisht janë kundër asaj që Kosova ka ndërtuar për më shumë se 70 vjet dhe mendoj se prapë Kuvendi i Kosovës nuk duhet ta votojë një amendament të tillë, e ne duhet ta mbështesim fenë, cilindo konfesion fetar që e kemi këtu, Islamin që është feja shumicës së qytetarëve në Kosovës, por edhe fetë tjera, krishtenizmin katolik dhe ortodoks, mirëpo ne duhet të krijojmë kushte që ata që dëshirojnë që ta mësojnë fenë, ta mësojnë nëpër institucione fetare, jo nëpër shkollat publike, të cilat janë pronë e shtetit e shteti ynë është një shtet laik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Me keqardhje duhet të them për deputetin Gjini, i cili ka përvojë mjaft të madhe dhe po tregon që është shumë i përfunduar. Është e vërtetë që ne kemi kërkuar që jo të futet edukata fetare në shkolla publike të arsimit të Kosovës, por të rikthehet edukata fetare, se edukata fetare ka qenë para periudhës së komunizmit, komunizmi e ka eliminuar këtë edhe nëse tash eliminohet, atëherë ku është dallimi ynë në mes neve dhe mes komunizmit, e para. E dyta, është e vërtetë që kemi kërkuar që të kthehet në shkolla publike, por le të më thotë deputeti Gjini që shkollat e Gjermanisë, të Belgjikës, Francës, Britanis, a janë shkolla private që e kanë edukatën fetare në shkolla, a janë shkolla publike edhe ato, e çfarë kushtetute kanë vendet e Bashkimit Evropian e çfarë e kemi ne. Ata e kanë kushtetutë laike, kushtetutë laike kemi ne, ata e kanë edukatën fetare me dekada shkollat e tyre, dhe në dallim prej neve, prej propozimit tonë, se ne s'kemi edukatë, shkollat publike të Bashkimit Evropian edukatën fetare e kanë lëndë obligative, ndërsa ne kemi propozuar që lënda e edukatës fetare të jetë lëndë jo obligative, lëndë zgjedhore, ku nxënësi mund të zgjedhë të shkojë apo mos të shkojë, por edhe mos të notohet dhe nuk bien ndesh fare me laicitetin e Kushtetutës, se ne kohën e fundit shumë po abuzohet me këtë laicitet, kujt po i konvenon, po shkelet laiciteti, kujt s'po konvenon, po e merr si po do vetë, kështu që mua shumë më vjen keq, në këtë Parlament të Kosovës kemi deputetë që marrin guximin të flasin të pa informuar. Le të informohet dhe le ti paraqet argumentet e veta. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Mendoj se vlen të sqarohet për opinion e jo t'i replikohet deputetit, i cili e merr guximin t'i quaj deputetët të pa informuar, unë ata nuk i quajta të pa informuar, duhet pasur kujdes me gjuhën pak, se nuk janë kah dinë ama bash kurrëgjë hiq, vetëm temën e vet.

Para vitit 1945, në Kosovë nuk ka pasur arsim formal në gjuhën shqipe, ka qenë vetëm në gjuhën serbe, po dua të ta kujtoj, zotëri. Nuk jam duke e lavdëruar unë komunizmin, po jam duke të thënë ty se ose ka pasur medrese, shkolla te fesë, ose ka pasur shkolla serbisht, e nuk ka pasur shkolla shqip, ama bash hiq, përpos dy ose tri vjet gjatë Luftës së Dytë Botërore, e mos të na shesin dushk për gogla këtu. Le të mësojnë fe sa të donë nëpër xhamia, neper kisha ortodokse, nëpër kisha katolike, në shkolla publike të Kosovës nuk duhet të mësohet fe. Kosova është rast unik në botë, shqiptarët janë rast unik në botë.

Nuk jemi ne as gjerman, as austriak, edhe për t'ua bërë me dije, gjermanët edhe austriakët kur ta mësojnë Darwinin, niveli i mësimi është më lartë se niveli i mësimi fetar, për derisa te ne askush nuk e dinë filozofinë e Darwinit edhe kemi për t'u kthyer në shekullin XV për shkak se këta janë përgatitur t'ua mësojnë dogmën fetare nxënësve tanë. E kanë vendin ku t'ua mësojnë, askush nuk po ua ndalon atë vend, askush nuk po ua cenon të drejtën, por jo t'i shfrytëzojnë shkollat tona publike. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kundër replikë, një minutë z. Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Prapë po argumentohet ajo teza ime se deputeti është mjaft shumë i pa informuar. Teoria e Darvinit ka moti që ka rënë poshtë prej praktikimit, është teori e hudhër poshtë nga të gjitha vendet në zhvillim, dhe teoria e Darvinit promovon se njeriu e ka..., kështu që përmes teorisë së Darvinit po donë të na bëjnë neve pasardhës të majmunit. Ne nuk jemi pasardhës të majmunit, ne jemi pasardhës të njeriut, e kush do, mund të informohet edhe më shumë.

Sa iu përket shkollave publike, nuk asht e vërtetë se në 1945 janë çelë shkollat publike në gjuhen shqipe, shumë më herët ka pas shkolla dhe është mësuar edukata fetare në ato shkolla. Me ardhjen e komunizmit në pushtet, është eliminuar edukata fetare, e tash thotë, nuk e argumenton pse nuk duhet, po thotë nuk duhet të ketë. Këtu nuk është ligj, shtet i cili nuk duhet të ketë, por duhet prurë argumente pse duhet të kemi, e pse nuk duhet të kemi. Edhe çështja e dytë, e cila është shumë në kohën e fundit është abuzuar me neve si shoqëri, është se po na ... Ashtu si po e përmendi deputeti - vend unik, çka janë vend unik, çka kanë të drejtë më shumë se ne maqedonët, kroatët, bullgarët, serbët, gjermanët austriakët për ta mësuar edukatën fetare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit, kryesues!

Mendoj që në këtë debat, fjala prejardhja prej majmunit apo komunizëm e tjera nuk kanë vend. Jemi duke biseduar për një temë shumë të rëndësishme dhe duhet të jemi në nivel. Po të kishte qenë këtu komunizëm, ajo as nuk kishte ardhur në pyetje për të diskutuar për këtë, prandaj duhet të kemi respekt për këtë Kuvend i cili po debaton.

Tjetër. Vetë fakti që është hapur një debat që nuk ka koncenzus në mes të konfesioneve, tregon që ky debat është i hershëm dhe çfarëdo pune e hershme, sjell fryte të cilat nuk mund të ndikojnë pozitivisht. Ky debat është i hershëm, nuk ka konsenzues në mes të konfesioneve fetare, e pamë reagimin edhe të Kishes Katolike dhe të tjerëve, prandaj mendojmë që neve si shoqëri na duhet shumë më tepër kohë që të zhvillohemi, e pastaj të diskutojmë për te. Është debat i hershëm dhe ky amendament në këtë Kuvend nuk e ka ende vendin.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Sala Berisha – Shala.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit kryesues! Me sa e di, unë Rregullorja e punës së Kuvendit thotë se kur të jemi në leximi ne dytë të projektligjeve, nuk lejohet debat, me përjashtim vetëm të atij deputeti ose grupi që e ka bërë amendamentin, për ta arsyetuar. Për ndryshe, kështu vetëm po na merret koha dhe unë kërkoj të ndërpritet debati dhe të qitet në votim amendamenti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në Rregulloren e parë ka qenë, por në të dytën ka ndryshuar kjo. Mendoj se nuk ka ndonjë dëm që po debatohet për këtë çështje, se kjo çështje është edhe në publik është e diskutueshme. Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryesues!

Duke marrë parasysh se e drejta e secilit deputetë është të propozojë amendamente dhe njëkohësisht Rregullorja e punës së Kuvendit jep mundësinë që të përdoret një gjuhë parlamentare brenda Kuvendit të Kosovës, zonja Sahatqija potencoi se kushtet duhet të pihen në këtë Kuvend dhe në gjithë Kosovën për zbatimin edhe të fesë dhe çdo gjëje që e lejon Kushtetuta e Kosovës, i gjithë debati mund të orientohet drejtë votimit. Kush do të votojë, mirë, kush nuk do të votojë dhe të kryhet kjo procedurë. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë desha të reagojë vetëm që të mos dal i padijshëm, as i painformuar, sepse ne komision i kemi shteruar të gjitha debatet. Unë e kam marrë shembull se po i përmendi shtetet perëndimore. Ligji francez për edukimin e thotë decidivisht: Ndalohet feja në institucionet publike shkollore. Një nen tjetër e thotë: Feja mund të jepet në institucionet, është fakultative në institucionet private, sepse ka edhe kolegje private me karakter fetar. Ju e dini, edhe në Francë që i ndalon me shami dhe me simbole fetare, të gjitha. Pra, mos të përmendim edhe Francën, se Francën e kam provuar vetë, fëmijët e mi kanë qenë në shkollë në Francë edhe shkollohen atje, edhe e kam lexua ligjin francez që thotë, decidivisht ndalohet feja në institucionet arsimore publike dhe mos të na qesin të padijshëm neve. Ekstraktin e ligjit e kam, në Komisionin për Arsim i kemi diskutuar gjithë, nuk kam nevojë të hyjë më tutje, por kur të flasim, mos t'i marrim si të pa dijshëm të tjerët. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ : Ju faleminderit, zoti kryesues!

Nga debatet dhe nga shqyrtimi në çdo debat dhe në çdo shqyrtim të projektligjit, ne jemi ballafaquar duke e lidhur çdo projektligj me fenë. Kosova do të jetë një vend demokratik, e synon Evropën, e jo të merret me fe. E potencoj deputeti Gjini, le të zhvillohet edukata fetare, por në institucionet fetare, e jo në institucionet publike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Gëzim, ke diskutuar. Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Tash, për hir të korrektësisë të përmend, ky Kuvend ka edhe hoxhallarë, ka edhe haxhi, ka edhe te pa fe, edhe pa besim, që është normale, por është pak diskriminuese të thuhet, është mirë për t'u bërë deputet, e jo haxhi, se haxhi është shtylla e pestë e islamit, është jashtë zakonisht me vlerë edhe ndihen të ofenduar, në veçanti dy hoxhallarë që i kemi këtu. Sidoqoftë, duhet konstatuar një të vërtetë. Kosova me ligj dhe me Kushtetutë garanton edhe mësim me orientim fetar, Kosova ka Medrese

edhe ka fakultet islam, Kosova ka edhe Bashkësi Islame dhe për hir të komunistëve të vjetër, unë jam edhe antikomunist, edhe anti-jugosllav, e dinë këta, se ti i bën kualifikimet kështu përmendësh, anti-jugosllav me vepra, por me Kushtetutën e 74-tës mësimi fetar ka qenë i lejueshëm jashtë orareve shkollore. Dhe të gjithë ata pak që kanë punuar, edhe negociatat e Vjenës që po përmenden këtu, kanë qenë të përgatitura, sepse fëmijët me orientim fetar, gjatë periudhës së verës në veçanti, kanë pasur të drejtë nën organizimin e Bashkësisë Islame të shkojnë të marrim mësim fetar, apo të kryejnë shkollë fillore sipas orientimit të Bashkësisë Islame. S'ka qenë e popullarizuar, s'ka qenë në modë, as në trend në atë kohë, por ata që kanë pas bindje fetare ose orientim fetar, kanë mundur dhe e kanë shfrytëzuar, kanë shkuar edhe e kanë atë edukim fetar. Atëherë, në emër të akuzës së teorisë së Darvinit apo të akuzës së komunizmit, i cili nuk e ka lejuar, mundemi të themi lirisht që edhe në atë kohë ka pasur një orientim, ka pasur një edukim, ka pasur një liri fetare, për dallim prej lirisë kombëtare. Ka pasur një orientim jugosllav dhe një orientim kombëtar shqiptar, sikur sot që po e përmendim këtu, këto raporte, por shumica ka qenë anti, unë e di që shumica ka qenë kundër, shumica nuk ka qenë as fetare, shumica ka qenë fetare, por nuk e ka praktikuar, nuk e ka kallëzuar, se nuk ka qenë në modë të thuhet dhe njerëzit e kanë mbajtur për vete. Atëherë, sot jemi në këtë kategori kushtetuese, Blerimi e tha shumë mirë, kodi kushtetues e lejon, e garanton edhe e mbështet çdo qytetarë për lirinë fetare.

Kush do çojë fëmijën në shkollë, që ku është Medreseja, Fakulteti Islam dhe shumica e predikuesve fetar dhe shkollat më të mira, prej Bagdadit e në Mekë a Medinë i kanë prurë njerëzit e Kosovës edhe është me për t'u respektuar dhe kanë doktoruar në emër të kësaj të drejte. Ka shkolla, mund të ketë edhe shkolla katolike, mund t'i çojnë edhe në edukim tjetër ata që donë t'i çojnë, por shkolla publike mendoj që duhet të kursehet, sepse sipas kurrikulës në Kosovë, nxënësit edukohen për fe në Kosovë, edukohen, ka dy lëndë, plus ka mundësi të edukohen.

Atëherë, ministri i Arsimit e ka fjalën kryesore, nuk e di pse po rezervohet prapë, ministri Arsimit e ka fjalën kryesore këtu, sepse po flitet për një udhëzim administrativ të ministrit të Arsimit, duhet sqaruar një herë e përgjithmonë. Edhe në politikën e jo diskriminimit duhet vendosur, prapë në frymën e jo diskriminimit duhet vendosur sepse, fundi i fundit, edhe unë si deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së shumë lehtë e çojmë në Gjykatë Kushtetuese dhe sa herë të çojmë në lëndë në Gjykatën Kushtetuese, të jeni të bindur që fitojmë, sepse marrim bazë kushtetuese, pa bazë nuk e çojmë, dhe na kur ta çojmë në Gjykatë Kushtetuese, e rrëzojmë, por është keq për juve. Ju faleminderit shumë! Faleminderit, Editë, mos përdor më gjuhë diskriminuese, se është problem me ligj.

KRYESUESI: Zëvendëskryeministrja, Edita Tahiri, replikë, dy minuta.

EDITA TAHIRI: E nderuara Qeveri,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Haziri,

Shumë faleminderit që ma dhe mundësinë për të folur, se puna e jugo-nostalgjisë që ta kam thënë, lidhet me diçka tjetër, por sot po diskutojmë çështjen e ndërhyrjes së fesë në institucionet shtetërore publike dhe në shkolla dhe me këtë rast dua të shfrytëzoj rastin të

them që vlerat shtetërore dhe kombëtare shqiptare, pra, e kanë përcaktuar qartë raportin: kombi para fesë, shteti para fesë. Çfarëdo tendencash tjera që këtu po paraqiten, janë kundër shtetit, kundër kombit. Mos harroni se që nga rilindësit është gjetur rruga e drejtë e raportit komb-fe edhe raportit shtet – fe dhe mos harroni se jemi në shekullin XXI dhe ne, përveç që kemi obligim ta bartim traditën moderne të së kaluarës, kemi edhe vizionin për integritet euro – antlantike, prandaj unë kam qenë edhe nënshkruese e peticionit të grave intelektuale dhe mendoj që feja është individuale dhe ato që i tha edhe Lutfiu, janë shkollat fetare, çka kemi - Fakultet Islamik, bashkësi etj. Dhe, mos harroni, jemi komb me tri fe dhe vetëm kështu jemi mbajtur unik e të fortë. Faleminderit shumë! Lutfi, të faleminderit edhe njëherë, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Buja e ka kërkuar fjalën për sqarim, ministri i Arsimit Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues!

Të nderuar kolegë, ministra,

Të nderuar dhe respektuar deputetë,

Unë besoj që nuk do të përsëris ato që u thanë, meqë zoti deputet Haziri, tha që po rezervohet ministri, unë s'po rezervohem fare, unë ju kam thënë edhe herëve tjera, mbase në këtë Kuvend ju më bëni ligjin ashtu si duhet dhe si mendoni që është më së miri, unë jam ekzekutuesi ose zbatuesi i tij dhe këtu duhet t'ju sqaroj vetëm një gjë. Nuk dua të shtoj ato që u thanë, sepse ishin të thëna logjikisht dhe përmbajtësish mirë, por po ju them që kurrikulën pritët ta nënshkruaj në orën 11:30, po mbasi i kanë këto dy ligje këtu, duhet ta shtyjë më vonë dhe kjo kurrikulë në fondin e orëve nuk përmban orët që mund të shtohen, me t'u shtuar amendamenti 8 dhe këtë do ta kemi parasysh.

Pastaj, është një problem që na e shton jo më pak se 1000 arsimtarë ose afër 1000 arsimtarë, fondin e njerëzve që do t'i paguajmë, andaj duhet ta matni ju këtë gjë shumë mirë dhe ta peshoni ashtu siç duhet, pastaj unë jam i shtrënguar, si pjesë e ekzekutivit, ta respektoj me përpikëri dhe me ekzaktesë ligjin që ju e aprovoni dhe e bëni, dihet çfarë mund ta bëni. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ministri i Shëndetësisë e ka kërkuar fjalën. O, më fal, Lutfiu ka replikë.

LUTFI HAZIRI: Dy çështje janë. Është fakt që zëvendëskryeministri e përmendi, tri shtyllat e kombit tonë që e mbajnë kuptimin fetar, por islami i ka pesë shtylla e veta dhe islami nuk njeh komb. Tash kur diskutojnë disa nga sponsorët, ata po diskutojnë në kuptimin e fetar që nuk e njeh kombin dhe ai ka shumë të drejtë kur thotë që ne duhet ta bëjmë këtë, sepse ata, nocioni "komb" për islamin nuk njihet, njihet feja. Nën dy, ajo që desha të them, është ofendim për ata njerëz të Kosovës që janë vrarë në Luftën e Dytë Botërore, që kanë luftuar për komb dhe për fe. Janë vra e më vonë të ofendohen, por nga kolegët, se jugo-nostalgjik apo diçka tjetër, nuk është personale, se kam obligim ndaj atyre që unë kam vuajtur edhe që si kam, edhe ndaj 90% të deputetëve këtu që janë, sepse ata kanë qenë kundër atij regjimi dhe kundër asaj ideologjie, por në fund ta përmbledhim sinqerisht, ne duhet të bëhemi të hapur, të drejtpërdrejtë.

Liria ekziston me Kushtetutë, njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin ku po shkojnë, në çfarëdo shkolla, çfarë mundësi kanë për të shkuar dhe edukimi nuk mungon në këtë drejtim. Se sa e respektojmë ne, është diçka tjetër. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se edhe në këtë debat, si zakonisht kur merren këto temat që kanë një ngarkesë ideologjike dhe që kanë të bëjnë edhe me refleksime personale, dhe kanë të bëjnë edhe me traditat e jetërave të secilit prej nesh, është rrezik që të huqet esenca e temës. Këtu bëhet fjalë, në esencë, për arsimim, për arsimim, jo për fe, por për zotin e madhërisëm, për atë në të cilin ne shumë herë thirrreni edhe në jetën tonë, për të dërguarit e tij. Bëhet fjalë për arsimim që të jemi të sinqertë e jo hipokrit, jo dyfytirësh, se politikë nuk bëhet me interesat e kombit. E dinë shumë mirë se shqiptarët më të mëdhenj kanë qenë njerëz besimtar, megjithatë, njerëz të cilët në emër të zotit kanë sakrifikuar për kombin dhe për shtet. Kujt i pengon në këtë sallë të Kuvendit që të mësohet për zotin e madhërisëm në shkolla, unë nuk mundem ta kuptoj dhe ta arsyetoj.

Këtë të vërtetë e kanë kuptuar kolegët tanë në Parlamentet e Bashkësisë Evropiane, shteteteve evropiane, ku po synojnë të hyjmë, që moti e kanë kuptuar. Është fakt, zoti deputet Vataj, se në Francë, në dy krahina të Lorenës dhe Arzasit është i ndaluar arsimi fetar, por është fakt dhe në qoftë se ke ndonjë argument tjetër, se kjo lëndë mësohet në Republikën Federale të Gjermanisë, të Austrisë, Belgjikës, Britanisë së Madhe, pse si marrim edhe këta shembuj. Nuk është këtu qëllimi që nxënësit tanë t'i bëjmë hoxhallarë ose priftërinj, me një orë në javë, ku ata mësojnë për vlerat etike dhe morale, që fundamentin e kanë në njohuritë fetare, ata nuk bëhen as më shumë, as më pak myslimanë ose as më shumë, as më pak katolikë. Pse nuk i marrin praktikën më të mira evropiane në këtë aspekt? Këto janë praktika, këto zbatohen, kanë përvoja këta popuj, këto shtete, pse frikohemi nga ajo që nxënësit tonë të mësojnë për krijuesin.

Linja e kuqe për popullin tonë, për shtetin tonë janë dukuritë degraduese që po na ndodhin, prostitucioni në përhapje, sëmundjet e varësisë, është korrupsioni në rritje, po shihet shumë qartë se shëndeti moral i popullatës tonë është duke rënë, ju po pajtoheni me këtë, prevalenca e vetëvrasjeve në Kosovë është katërfishuar në periudhën e pas luftës, ju lutem, katërfishuar, kemi qenë shteti, populli me prevalencën më të ulët të vetëvrasjeve në Evropë, në vitet '60. Janë këto fakte të cilat duhet të na shtyjnë vetëm të mendojmë.

Unë mund të pajtohem me atë se është debat i hershëm, unë mund të pajtohem që nuk jeni gati për të biseduar për këtë temë, por nuk mund të pajtohem se ky konkludim mund të arsyetohet me mungesën e traditës shekullore të popullit tonë për të debatuar për këto tema.

Besimi në krijuesin është pasuri e këtij populli, e këtij shteti, nëpër histori, pasuri mijëvjeçare. Pse mos të mësojnë nxënësit tonë për Zotin e madhërishtëm në shkolla, pse? Jo për fe, feja nuk mësohet, edhe njëherë e thashë, me një orë në javë dhe atë si zgjedhje, jo në mënyrë obligative, por nëse do. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Vataj, ia ka përmendur emrin.

RAMË VATAJ: Po, pasi mu përmend emri, se nuk është veç Loreni dhe Alzasi krahina të Francës, por ligji vlen për krejt territorin e Francës, janë diku 60 milionë, dhe kur thotë ligji për gjithë territorin e Francës, edhe Alzasi që është komunë, ku në të vërtetë kam jetuar 12 vjet, e di pak më mirë, por është e vërtetë që për gjithë nxënësit që janë në edukim para universitar, ndalohet feja me ligj në institucionet arsimore publike, fakultative është në ato private. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Sahatqija, iu ka përmendur emri, a? Nga dy herë nuk jepet me rregullore, vetëm kryetarëve të komisionit. Po, s'ta ka përmendur emrin. Mirë, zonja Sahatqija, replikë në fjalimin, 2 minuta.

TEUTA SAHATQIJA: Viteve '60 ka pasur më së paku vetëvrasje, e tjera, e tjera. Viteve '60 nuk ka pasur edukatë fetare, sa e di unë. Prandaj, nuk mundet vitet '60 dhe vetëvrasjet të arsyetohet me kërkesën për futjen e lëndës mësimore. Në qoftë se lënda fetare na bën më të mirë, e jo hipokritë, mendoj që ekzistojnë gjërat tjera, kurrikule tjera, ekzistojnë lëndë tjera, ekziston sistemi shkollor, i cili duhet të ketë shumë më tepër vëmendje, se sa që morali shoqëror të rregullohet me ligj. Përsëri po kthehet në atë pse e lypa replikën? Ekziston mungesa e konsensusit. Para se të dalë kjo, si amendament, do të duhej që të ketë një mirëkuptim në mes të konfeksioneve. Ai mirëkuptim nuk ekziston, prandaj edhe një herë po e potencoj, është herët sepse ekziston mungesa e konsensusit atje jashtë dhe nuk mundemi këtu ta përkrahim, se është para kohe.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Një minutë, kundër replikë, është ministri.

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara deputete, Prevalenca e vetëvrasjeve nuk rritet për shkak se ka arsim fetar apo nuk ka, por rritet për shkak se të rinjtë tanë, që janë 1/3 e atyre që kryejnë vetëvrasje sot në Kosovë, fatkeqësisht e kanë një krizë të thellë të personalitetit, i cili reflekton krizën e thellë të identitetit të tyre shpirtëror, një dezorientim të fuqishëm dhe një arsimim, në këtë aspekt, do të kishte ndihmuar jashtëzakonisht shumë.

Çështja e konsensusit, ne këtu brenda jemi përfaqësues të atyre jashtë, e ata jashtë e dinë shumë mirë se kënd e përfaqësojmë ne. Ne e dimë shumë mirë që ky popull, me 95% të substancës së tij, është popull besimtar dhe një përqindje shumë e lartë është e besimit islam dhe e kemi një komunitet mysliman atje, i cili kërkon që kjo lëndë të futet në shkollë, e ne jemi ata që përfaqësojmë këtë shumicë të popullit. Gjithmonë jam për konsensus dhe konsensusi duhet të arrihet, por një vendim politik për futjen e lëndës i takon këtij Kuvendi.

Përpilimi i plan programit....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti ministër, e keni kryer fjalimin, fol pa mikrofon. Edhe një fjali, regjia!

MINISTRI FERID AGANI: ... e zgjata, vetëm mendoj që është një fjali me rëndësi. Arsimimi fetar ose të themi qartë, arsimi në bazë të kurrikulumit zyrtar, të nxjerrë nga Ministria e Arsimit, do të parandalojë ekstremizmin fetar në këtë vend, do të parandalojë mundësitë e indoktrinimit të rinisë sonë nga grupe të caktuara, të cilat e kanë për qëllim që rininë tonë ta dërgojnë në rrugë kah s'duhet, ju lutem. Kjo është ajo fjali që duhet të them. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Jeton Svirca. Zoti Ahmeti, tërhiqe fjalën, se nuk të jap më fjalën, se e ke kryer.

JETON SVIRCA: Ju faleminderit!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe në leximin e parë të këtij projektligji, në Kuvend kemi dhënë argumentet tona, pse duhet të futet ky amendament i propozuar në Ligjin për arsimin parauniversitar.

Nuk dua të ndalem te ato argumente, sepse i kemi përsëritur shumë herë, por dua të cek një gjë, që arsyeja në propozimin ose thirrjen e këtij propozimi e kemi mbështetur edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konkretisht tek neni 22, i cili flet për zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare.

Në rend të parë, ceket Deklarata universale për të drejtat e njeriut dhe më lartë shkruan se, këtu 8 dokumente ndërkombëtare kanë prioritet në rast konflikti me ligjet në Kosovë dhe neni 18, i Deklaratës universale të drejtave të njeriut, i obligon shtetet që t'ju mundësojnë mësim praktik, në kuadër të fesë, nxënësve të atij vendi. Pra, thirrja jonë bazohet edhe në këtë të drejtë ndërkombëtare dhe në këtë nen të Kushtetutës. Gjithashtu, dua të cek se komisioni ka marrë vendim për mos ta përkrahur këtë amendament në komision, me arsyetimin se është numri vogël i deputetëve dhe nuk mund të marrim vendime të tilla në komision. Andaj, mos të jetë referuese, vendimi i komisionit tonë, jam vet anëtarë i atij komisioni dhe ne jemi ata të cilët duhet ta marrin këtë vendim. Ne jemi përfaqësues të popullit të Kosovës, nuk jemi përfaqësues të bashkësive fetare. Është kompetencë e jona, detyrë e jona, përgjegjësi e jona që t'i bëjmë ligjet dhe të interesohemi për kërkesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, ky amendament është përkrahur edhe nga Grupi për komunitete i Kuvendit të Kosovës, gjithashtu, me informatat që i kemi, edhe Komisioni për Integritet nuk ka pasur ndonjë vërejtje konkrete. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Amir Ahmeti e ka fjalën.

AMIR AHMETI: Faleminderit, kryesues!

Ne kemi gojën plotë me demokraci, plot me integritet evropian, ndërsa nuk marrim për këtë praktikë evropiane, nuk dëshirojmë që ta dëgjojmë, as s'ia varim veshin. Të gjitha vendet Evropiane u përmendën edhe këtu, përveç Sllovenisë, e cila nuk e ka edukatën qytetare fetare në shkollë dhe dy regjione të Francës, të gjitha vendet tjera evropiane e kanë këtë lëndë.

E dyta, në Evropë nuk është e ndaluar shamia. Është duke u bërë luftë për ndalimin e burkës apo të fesës, por jo të shamisë. Në Parlamentin e Belgjikës kemi femra me mbulesë, në Shtëpinë e Bardhë, këshilltarët e presidentit Obama i kemi me mbulesë dhe atyre nuk po u pengon asgjë kjo punë.

Tjetra, unë kam të kryer Medresenë Alaudin, në Prishtinë, dhe jam krenar që e kam kryer atë shkollë, por ndoshta djali im ose vajza ime nuk do ta kryejë atë shkollë, për këtë arsye unë dua që ata në shkollat fillore dhe të mesme të mësojnë për fenë e tyre, për zotin e tyre dhe pastaj të marrin drejtimit e tjera.

Tjetra, ata të cilët thonë se: feja është përpara ose kombi, i tregoj zotit Haziri se shtetet-komb e kanë zanafillën vetëm në shekullin XVIII, me iniciativën e Kardinalit Rishell, nga Franca, ndërsa Kur'ani, fjalën "komb" e përmend qysh në shekullin e 7-të. Gratë intelektuale, të cilat kanë nënshkruar peticionin, ato kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut dhe mos të harrojmë se të drejtat e tyre përfundojnë në momentin kur cenojnë të drejtat e të tjerëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Poštovani predsjedavajući,

Poštovane kolege,

Prvo, na početku da čestitam predstojeći Ramazanski Bajram svim pripadnicima islama, i svima ovde koji ste u Parlamentu. I ovo što ću sada govoriti, odnosno što ću kazati par reči, znači govorim ne samo, normalno ispred parlamentarne grupe, već ispred bošnjačke, turske i romske zajednice. Ja, kao svršeni medrese „Alaudin“ u Prištini, samo da kažem jednu stvar. Uzeću jedan primer, da u medresi za jednu cigaru mogao si da budeš izbačen iz škole, što danas imamo slučaj da učenici nude cigaru profesorima i obrnuto, što u medresi toga nema.

Neko je od poslanika ovde rekao da ima reagovanje od Katoličke crkve što nemamo protiv toga ništa, ali mora se uzeti u obzir i reagovanje Islamske zajednice, koju čine pripadnici islama, odnosno muslimani preko 90%...

KRYESUESI: Të lutem, të lutem, keni kujdes sepse nuk është kjo për diskutim! Të lutem!

RASIM DEMIRI: Samo još jedno...

KRYESUESI: Vetëm lidhur me amendamentin. Nuk të kemi thirr, nuk je këtu për të na mbajtur fjalime fetare dhe të na fusësh përçarje fetare këtu! As për islamin, as për katolicizmin, as për kishën serbe, as për protestantë, as për asnjë grup as komunitet fetar. Ju lus që këto diskutime janë të papranueshme në Parlamentin e Kosovës.

RASIM DEMIRI: Ja moram da prenesem osećanja Islamske zajednice, da Islamska zajednica...

KRYESUESI: Ništa nema! Islamska zajednica je tamo, ovde je Parlament Kosova.

RASIM DEMIRI: Samo sam hteo još jednu stvar da kažem i to da je gospodin Ljutfi Haziri, koji je bio prije mene na hađ, kaže da medrese... imamo 7 medresa, ali trebamo se pitati kako i na koji način opstaju te medrese. I ovo što sam sada rekao, pošto mi ne dozvoljavate, ne ja sam hteo drugo da kažem kako i na koji način opstaju te medrese, i na kraju... pošto vidim da se vrši diskriminacija, onda ... Parlamentarna grupa „6+“, za našu javnost, za našu zajednicu, odnosno za bošnjačku zajednicu, tursku zajednicu i romsku zajednicu, dakle podržava ovaj predlog. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!
Replikë, Zoti Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Dy replika, edhe për zotin Amir, edhe për kolegun e nderuar. Nuk po flasim për financimin e shkollave fetare këtu. Nëse dëshirojmë të bisedojmë për financimin e medresesë e të fakultetit islam, edhe të Bashkësisë Islame, është çështje tjetër. Unë e ndaj mendimin këtu, mendoj që Qeveria jonë duhet në të ardhmen të mendojë, të gjejë mënyrë të subvencioneve së paku, sepse nëse e krahasojmë angazhimin tash, me terminologji diskriminuese, ne financojmë me miliona euro, për shembull, vitin e kaluar 70 milionë euro për renovimin e kishave ortodokse e asnjë euro për xhami. Është diskriminuese, realisht, por këtu nuk po flasim për financim. Këtu ka tendencë dhe duhet thënë shumë qartë: ne kemi medrese, e kemi fakultetin islam, po duam edhe mejtep. Në gjuhën që po flitet, po duam edhe shkollë fillore, sepse po duam edukim edhe nëpër shkolla fillore. Kjo është kërkesa që duhet sqaruar, mos të fshihet. Po duam edhe në nivelin fillor të fusim edukimin fetar, sepse dy shkallët janë të garantuara, edhe edukimi i mëvonshëm është i garantuar. Nuk ka nevojë tash të kallëzojmë, sepse bindjet fetare janë... janë... Zoti nuk ka ndërmjetësues, së paku Amiri e di, për dallim prej disa ... tjera. Unë nuk kam ndërmjetësues me Zotin tim. Me Allahun tim unë s'kam ndërmjetësues. As Amiri s'mund të më bëhet ndërmjetësues. As kryetari i Bashkësisë Islame, as Feridi, si ministër. Dhe, jo, nuk ka ligjërata shumë, është shumë kritike kjo punë, sepse po donë të hudhin gurë në këtë drejtim, si më... më diçka. Atëherë, financimi është i dalluar, ne kemi të bëjmë për edukim, për edukim fetar është çështje tjetër dhe natyrisht si nen duhet të sqarohet ashtu qysh po sqarohet, por pa e lakuar në asnjë mënyrë dhe në asnjë formë tjetër jashtë asaj që e kemi sot këtu, ose nesër do ta kemi nëpër shkolla tona. Tendencja është tjetër, sepse kjo është kërkesë politike...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe gjysmë minute, Lutfi Hazirit!

LUTFI HAZIRI: Edhe më herët është kërkesa politike, po fshihet me kërkesë etnike, edhe tash është kërkesa politike, po fshihet me kërkesë fetare, nuk bën. Duhet të jemi të sinqertë, të thuhet kjo është kërkesë politike, unë e përfaqësoj kështu, kështu mendoj, kështu e kam obligim, kështu besoj edhe nëse e merr shumicën, le ta marrë. Kurrgjë të keqe s'ka. Unë po dua të jem vetëm parimor në këtë drejtim. Unë çka besoj dhe çka i përmbahem, është çështje që e them dhe, si e tillë, për aq sa e mbaj, më vlerëson dikush tjetër dhe jo as imami, as menzini. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kundër replikë, Amir Ahmeti. Një minutë.

AMIR AHMETI: Faleminderit kryesues, edhe njëherë!

Më së pari, unë nuk fola për financimin e bashkësive fetare. E kemi në dhjetor, atëherë kur na vjen ligji, atëherë diskutojmë. E dyta, ne nuk kemi kurrfarë tendenca, ne kemi folur ashiqare. Po flasim për edukatën fetare nëpër shkolla dhe s'po duam mejtepe, po po duam të njëjtin model sikur në Evropë dhe nuk e di çka ka të keqe këtu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Unë mendoj se është mirë që po debatojmë. Ne duhet të kemi një tolerancë në debat. Unë mund t'i kuptoj të gjithë deputetët të cilët ndjejnë një nevojë që kjo çështje të debatohet dhe mbi bazën e një debati të gjenden zgjidhjet më të mira. Ne kemi nevojë të debatojmë për shumë çështje të rëndësishme, për të cilat marrim vendime pa një debatim, pa një analizë të mirë. Në atë drejtim, ndoshta kjo çështje duhet të debatohet edhe më shume dhe duhet të mbërrihet një zgjidhje më e mirë.

Edhe pse formulimi, domethënë, nuk e përmbyllë atë debat, formulimi vetëm e hap mundësinë që mbi bazë të atij debati të gjenden zgjedhjet të cilat janë në pajtim me praktikat evropiane. Por, sido që të jetë, këto çështje mund të jenë objekt i debateve dhe mbi to të gjenden zgjidhjet më të mira. Ajo që mua më pengon në ehon e debatit, ka të bëjë me faktin se nëse njerëzit janë të lirë të shprehin përkatësinë fetare dhe mos të diskriminohen, mos të përjashtohen nga shkolla, në qoftë se e ndjejnë nevojën që të kenë një shami, qenka më pak evropiane ose më pak kombëtare. Më lejoni të them se kjo është shume e rrezikshme për kohezionin social në Kosovë. Nuk mund të themi se disa besime, ose ai që është i besimit islam, është më pak evropian dhe më pak kombëtar. Kjo është shumë e rrezikshme për kohezionin social në Kosovë, mund të them edhe për kohezionin nacional. Prandaj, duhet të jemi shumë të durueshëm dhe shumë të kujdesshëm në këto formulime. Në qoftë se ka nevojë të debatojmë, mund të themi që ka nevojë të debatojmë, por nuk mundemi me ndjenja neoromantike të trajtojmë çështjet që janë shumë serioze, që kanë të bëjnë me kohezionin social, kohezionin nacional, kohezionin shtetëror dhe vlerat evropiane, të cilat sot e kësaj dite janë në Evropë. Por, mund të shohim se cila është zgjidhja më e mirë në kushtet e kontekstit tonë kosovarë, që t'i akomodojmë edhe nevojat e atyre që janë fetar, edhe nevojat e atyre që janë katolikë, edhe nevojat e atyre që janë

myslimanë dhe secilit kosovar. Kjo është rruga e kohezionit social, kohezionit nacional dhe zgjidhjeve evropiane. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Teuta Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Unë tmerrohem nga debati. Shoh se edhe shume ministra nuk i kanë vu para vetes prioritetet që duhet t'i kenë. Dy komisionet, komisionet e përhershme dhe komisioni funksional e ka dhënë fjalën e vet, i nderuar kryesues, dhe u tregua se në Komision për Arsim, Kulturë kemi qenë 90%, të deputetëve dhe vetëm 1 votë ka qenë "për" rekomandimin e grupit. Megjithatë, duhet ta përmend që nga 3 subjekte politike që kanë nënshkruar këtë amendament, përfaqësuesi i SLS-së nuk ka qenë, nuk ka qenë "për". Do të thotë, ka qenë përfaqësues i vetë subjektit që ka nënshkruar, por nuk ka qenë "për". Prandaj, edhe një herë, Vendimi ka qenë i plotfuqishëm dhe unë duhet t'i them kryetarit të Komisionit që ta tregojë se të gjithë kemi qenë të një fjale dhe nuk duhet të ndalemi në këtë. Prandaj, ju lus që t'i mbyllim debatet dhe të votojmë për amendamentin ashtu siç ka ardhur. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë ju kisha lutur që të mos paraqiteni kështu, se nuk jua jap fjalën sa herë të doni të diskutoni. Lista po shkon duke u zgjerua e diskutuesve dhe rezultati i votimit përafërsisht po dihet cili është, megjithatë unë s'kam të drejtë t'ua marrë fjalën asnjërit.

Fjalën e ka deputeti Arben Gashi, si kryetar i komisionit funksional.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Jo, nuk po flas si kryetar i komisionit, po flas si deputet. Unë po ndihem i obliguar të them edhe unë mendimin tim për këtë çështje. Realisht, po ndihem shumë keq kur ministrat nuk po janë në gjendje të dalin edhe të elaborojnë se cili është sistemi arsimor në Kosovë. Shumë paafësi e madhe, se këta nuk dalin edhe t'u tregojnë edhe deputetëve, edhe opinionit publik në Kosovë se edukata fetare në Kosovë mësohet. Mësohet në shkollë, në shkollë publike, sot mësohet në kuadër të edukatës qytetare mësohet religjioni, mësohet për fenë islame, për fenë katolike, për fenë ortodokse, për të gjitha fetë mësohet sot në Kosovë. Edhe me ligj është e lejuar. Këta zotërinjtë këtu nuk po dalin për t'i treguar opinionit publik në Kosovë se në kuadër të filozofisë, kur fillon të mësohet filozofia dhe mendimi filozofik, mësohet për fenë, mësohet për ndikimin e fesë në filozofi. Këta zotërinjtë nuk po tregojnë këtu se kjo filozofi, kjo qasje sistimore ndaj studimit të fesë është një qasje, e cila ka një qasje shumë pragmatike. Në shkollë publike ne mësojmë këtë program, në kuadër të të cilit mësohet edhe feja, në kuadër të edukatës qytetare dhe në kuadër të filozofisë, të çështjeve edhe të sociologjisë mësohet dhe kush do për studime edhe më të thelluara fetare, mund t'i drejtohet edhe medresesë, mund t'i drejtohet edhe fakultetit të studimeve islame. Prandaj, këta zotërinjtë këtu po e qesin në konfuzion edhe Parlamentin, edhe qytetarët e Kosovës dhe të gjithë ata që po na dëgjojnë. Ndërsa, sa i përket sponsorizuesëve të amendamentit, ky amendament nuk është i menduar mirë, ky amendament, e thashë dhe e kam thënë edhe në Komision, nuk është i studiuar, ky amendament e ka një qëllim politik, qëllimi politik i të cilit është të mbahet

kjo Qeveri edhe ndonjë ditë. Por, nuk mundet të shkohet kështu përpara. Këta zotërinj duhet ta dinë këtë çështje, duhet ta thonë publikisht, duhet ta thonë haptazi. Ky amendament nuk parasheh kurrëgjë. Edukata fetare nëse duam të shkojmë si shoqëri, të vendosim, duhet të hapim debat më të gjerë, të vendosim si shoqëri deri ku do të lejojmë. Duhet ta ndryshojmë komplet sistemin, sistemi që kemi vendosur jep edukatën fetare në kuadër të edukatës qytetare dhe jep studimin e fesë në kuadër të studimit të filozofisë. Edhe feja trajtohet si filozofi, pastaj nëse dikush do ta trajtojë si besim, ka institucione ku e trajton si besim. Andaj, mendoj se ka degjeneruar i tërë muhabeti, ka degjeneruar i tërë debati, sepse përfaqësuesit e Qeverisë këtu dhe ata që po e propozojnë këtë amendament, janë jokompetentë dhe nuk po dinë të elaborojnë se çka duhet elaboruar. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit!

Ministri i Arsimit, zoti Buja kërkon sqarim!

RAMË BUJA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Arben,

Kisha dashur të jesh pak më i kujdesshëm, sepse unë nuk do të doja dhe nuk dua që tash t'ua them këtu Kurrikulin e tërë, se çka përmban në esencë. Unë besoj që deputetët e Parlamentit të Kosovës, si përfaqësues të popullit të Kosovës, pa dallim etnie dhe feje, e dinë mirë se ç'përmban filozofia fetare, e dinë mirë ç'përmban feja si fe, si konfesion dhe po kështu po i dimë bashkë të gjithë tendencat e propozuesve, prandaj, unë... do të më duhej shumë kohë, përndryshe unë po deshët, ua elaboroj Kurrikulin, që do ta nënshkruaj pas një ore apo një orë e gjysmë, sa të doni dhe kur të doni mund ta debatojmë pa asnjë problem. Por, sot unë mendova që debati, ju lutem... unë ju dëgjova, debati ka degjeneruar dhe s'është faji im pse ka degjeneruar debati. Këtu ka qenë problemi. Amendamenti i 7-të, është propozuar, dhe i 8-ti, që lidhen me njëri-tjetrin dhe i përngjajnë si veja vesë, se lidhshmëria është e pashkëputshme.

Ju debatuar dhe e degjeneruar vetë, si deputetë e kam fjalën, por nëse doni sqarim, urdhëroni një debat e zhvillojmë kur të doni dhe unë ju sqaroj se ç'është kjo filozofia jonë. Filozofia ç'është historia, ç'është edukata shoqërore, çka përmban ajo, çka përmban tjetra. Andaj, unë kështu veç për korrektësi kolegjiale, kisha thënë që nuk është këtu faji i ... absolutisht unë... ama ju lutem... unë kam pru draftin, dhe atë draft, si e kam pru, si ministër dhe si ministri, ne kemi dashur që ta aprovojmë si të tillë çfarë e kemi pru. Jo me amendamente. Ju e keni bërë me amendamente. Ju jeni ata që e aprovoni apo s'e aprovoni. Ju lutem, kjo është e qartë fare. Nëse, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e ka pru një draft, është për draftin e propozuar. Nuk kemi pse të filozofojmë këtu.

KRYESUESI: Faleminderit, faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Pajtohem se ky debat ka marrë... domethënë është degjeneruar dhe ka marrë një rrjedhë që nuk i përshtatet këtij Parlamenti dhe nuk i konvenon këtij Parlamenti. Parlamenti i

Kosovës, është e vërtetë që nuk është interpretues i Kushtetutës, por ai mbrohet Kushtetutën e Kosovës. Dhe, në këtë ne nuk jemi mjaft të zëshëm duke e mbrojtur Kushtetutën. Kushtetuta thotë se Kosova është një shtet laik, ku të drejtat fetare të gjithëve ju garantohen, edhe me ligje. Jo vetëm në Ligjin për fenë, por edhe në Ligjin kundër diskriminimit, ku hyn edhe diskriminimi fetar. Askush, asnjëherë, pra, nuk ka tentuar që feve të ndryshme në Kosovë, që për fat janë të shumta dhe nuk janë vetëm 3, sepse çdo ditë po lindin fe të reja, ju garantojmë këtë të drejtë, por ky amendament, sigurisht e shkel Kushtetutën e Kosovës dhe thashë se është shtet laik dhe tenton që të shkel, të intervenohet edhe në Ligjin për arsimimin parauniversitar. Prandaj, gjithashtu ky ligj dhe në bazë të diskutimit që u dha në interpretimin e këtij amendamenti, sigurisht që shkelen edhe të drejtat e grave. Këtu u tha se prostitucioni është zhvilluar në këtë kohë të demokracisë. Unë nuk mund të pajtohem në asnjë mënyrë me këtë thënie të ekspertit që e njeh edhe psikologjinë, pra, edhe psikiatrinë e njeriut shumë mirë, profesor. Sepse, prostitucioni mund të zhvillohet dhe nuk e dimë sa është i zhvilluar edhe nën shami dhe në perçe, edhe unë jam... e di edhe unë profesionalisht këtë.

Nuk do të hyj në këtë debat më tutje, sepse nuk e kam qëllimin ta degjeneroj, por mos t'i ndajmë këto çështjet me moralin, fenë dhe edukatën e shoqërisë tonë. Kujtoj se ne duhet ta mbrojmë, unë bashkohem me të gjithë intelektualët e Kosovës se ne na duhet fuqizimi i gruas dhe pjesëmarrja e saj më e fuqishme institucionale, arsimimi i saj më i denj dhe jo mbulesa e fytyrës dhe shamia në shkolla. Nëse ato duan të marrin edukim fetar, i kemi shkollat fetare, dhe gjithashtu mund të orientohemi andej. Aq më tepër që ky amendament, është deklaruar konfesionit tjetër, pra, katolik që sjellë përçarje dhe nuk është marrë një mendim i përbashkët që feja të futet si mësim në shkollat parauniversitare dhe gjithashtu të futet edhe veshja e caktuar për femrat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, nënkryetar!

Është e kuptueshme, besoj që të gjithë e dinë qëllimin politik të propozimit të këtij amendamenti, por unë s'po e kuptoj se kush janë këta njerëz që vijnë këtu dhe fyejnë. Të parët duke thënë se deputetët janë të paimformuar dhe të padijshtëm, e të tjerët prej lartë, duke thënë prej asaj pjese, duke thënë se dikujt po i penguaka zoti, pse është kundër këtij amendamenti, apo si fyhet intelijenca jonë, duke thënë që korrupsioni në institucione publike po u heqka duke e futur këtë lëndë në shkollat publike. Këto janë të papranueshme edhe për diskutim. Absolutisht, mendoj se vetë ky insistim me nuanca ekstremiteti, që po ndodhë tash edhe në parlament, por edhe në opinionin publik, tregon ose është indikacion edhe për qëllimet politike, që janë pas këtyre amendamenteve dhe pas këtyre qëllimeve që kanë dalë deri tash në publik. Përndryshe, çka po i shtynë këta njerëz që të vijnë këtu dhe të fyejnë. Nëse kanë dhënë një propozim, le ta argumentojnë propozimin e tyre dhe aq. Nëse deputetët tjerë pajtohen, e votojnë, nëse s'pajtohen, s'e votojnë. Nuk ka nevojë këtu të vijnë e t'i fyejnë deputetët tjerë.

Debati po shihet që ka degraduar. Unë po ju them se mos të futemi në histori tash, të flasim për histori, se historia jonë nuk lidhet prej shekullit VII, as prej vitit zero, por ka

edhe më herët. Dhe, këto debate nuk i ndihmojnë këtij ose kësaj teme, për të cilën ne jemi këtu.

Edhe një herë po them, është mirë të shkojmë në votim menjëherë dhe mos të kërkohet ose mos të tentohet të qiten temat pa pasur konsensus gjithë shoqëror ose gjithëkombëtar. E dimë që s'ka konsensus për këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e ka fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: I nderuari zotëri deputet, Nuk ka nevojë akuza të provohet të shuhet debatin. Parlamenti është vend ku debatohet, ku paraqiten edhe qëndrime të kundërta, nuk kemi nevojë të pajtohemi për çdo gjë. Agjenda politike e kësaj kërkesë është shumë e qartë. Qëllimet politike, definitivisht janë qëllime politike, amendamenti i ka qëllimet politike. Po të mos kishte qëllimet politike, atëherë pse jemi na këtu, çka bëjmë na këtu. A jemi duke bërë shkencë, a po mendoni që bëjmë shkencë. Ne jemi duke bërë politikë. Agjenda është shumë e qartë politike. Dëshirojmë që të përvetësojmë edhe një standard evropian, një standard evropian, a ka nevojë ta përsërisim edhe shumë herë, të shumicës absolute të shteteve të bashkësisë evropiane.

Në qoftë se ju mendoni se na si popull shqiptar dhe popull i Kosovës nuk jemi në nivel të pjekurisë intelektuale, historike, emocionale, kulturore që ta përvetësojmë këtë vlerë evropiane, të cilën e gëzojnë qytetarët e Evropës, thonë haptazi - nuk jemi, jemi të papjekur, duhet prituri pak, ende na duhen edhe 1000 a 2000 vjet, e mandej të bëhemi si ata. Ju lutem, mosni ashtu! Ky debat nuk çon askund! Ne po flasim për një qëllim të qartë, një synim të qartë. Praktikë evropiane, praktika më e mirë evropiane. Edhe, po kërkojmë hapjen e debatit. Pas miratimit të këtij amendamenti, hapet debati në shoqëri për atë Kurrikulum, për programin shkollor, për mënyrën e mësimdhënies, çka do të ketë ajo lëndë, çka do të mësojë ajo lëndë. Prandaj, pse po e degradojmë bisedën pa nevojë? Në të vërtetë, shumë deputetë këtu po kanë dëshirë ta kanalizojnë në drejtim tjetër dhe të çojnë kah përçarja fetare. Nuk guxojmë të përçajmë këtë popull në baza fetare. Nuk guxojmë!

Është bërë kërkesa, është amendamenti, ju lutem, urdhëroni e votoni. Nuk ka nevojë fare për fyerje reciproke. A jemi për agjendë evropiane, a s'jemi? A jemi për kohezion social, apo jo? Kjo është, asgjë tjetër. Në qoftë se jemi, e votojmë amendamentin pa asnjë problem, sepse të gjitha shtetet e Bashkësisë Evropiane...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj - Bujupi.

DONIKA KADAJ BUJUPI: I nderuar kryesues,

S'e kisha marrë fjalën, se me të vërtetë vetë fakti që një amendament i tillë ka ardhur këtu në kuvend, nga një grup që nuk përfaqëson as një përqind të qytetarëve të Kosovës, e që këtu ministri del edhe thotë unë i përfaqësoj 90% të besimtarëve të Kosovës.

I keni huqur matematikat! Ju nuk përfaqësoni shumicën e qytetarëve të Kosovës në këtë Kuvend dhe nuk keni të drejtë të manipuloni me fjalë. Të paktën të jeni të saktë në atë që e thoni. Të gjithë të tjerët e dinë që nuk është vullneti i qytetarëve të Kosovës, as shambia, as flamuri i zi në qendër të Prishtinës, të cilin e keni ngritur. Edhe gjyshet tona kanë luftuar kundër asaj çka ju sot po kërkon të instaloni në Kosovë, e përmes të cilës po i bëni shumë dëm kombit. E dimë që shqiptarët e kanë një komb, që është para fesë dhe ai komb është shqiptaria. Edhe sot ju kisha lutur të gjithë deputetëve të këtij Kuvendi që mos të dëmtojnë edhe më tutje interesin kombëtar dhe shtetëror të Kosovës. Kosova shumë moti e ka marrë një drejtim dhe të gjithë e dimë drejtimin e Kosovës, që është properëndimor, proevropian dhe ajo çka po kërkon ju, as nuk është perëndimore, as evropiane, e aq më pak demokratike. Prandaj, mos manipuloni më tutje dhe, ju lutem, mos e fyeri më tutje këtë Kuvend duke u ngritë dhe duke thënë që flisni në emër të 95% të qytetarëve të Kosovës, se nuk flisni, ju nuk përfaqësoni as 1% të qytetarëve të Kosovës dhe rastësisht gjendeni këtu ku gjendeni.

Prandaj, i nderuar kryesues, ju lutem që ta hedhim në votim, ta marrim një vendim dhe ta mbyllim sot këtë kapitull, se me të vërtetë po degradon edhe Kuvendi. Por, po i torturojmë edhe qytetarët e Republikës së Kosovës me këto fjalime, që nuk janë as të vërteta, as të sakta, as në emër të tyre. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryesues!
As unë s'do të merrja fjalën në këtë rast, por kam dy vërejtje procedurale dhe një propozim.

Së pari, jemi në shqyrtimin e dytë, po diskutojmë një amendament të caktuar. Është e pakuptueshme mënyra si po debatojmë. Ky debat e ka pasur vendin eventualisht në shqyrtimin e parë, e ka vendin edhe nëse mendon dikush të hap debat, për temën që donë të shtrojë, por kur bisedojmë për një amendament, diskutimi lejohet vetëm për amendamentin.

Për më tepër, debati është politik dhe unë e kuptoj edhe ministrin që thotë - politikë po bëjmë, por janë disa çështje me të cilat nuk është mirë të bëhet politikë, e dëmtojmë atë që e shfrytëzojmë për të bërë politikë dhe unë mendoj se nuk bën që në këtë muaj të madh të abuzojmë, në njëfarë mënyre, edhe me ndjenjat fetare e me vlerat e fesë, për do hesape që janë, megjithatë, jo të atij niveli.

Vërejtja e dytë e imja, ka të bëjë, po e them vetëm kalimthi, është miratuar një Ligj për liritë fetare në Kosovë, kam përshtypjen sikur edhe ata që janë shumë të entuziazmuar të flasin për fenë, as që e kanë lexuar, përndryshe, po ta kishin lexuar, do ta kishin parasysh

që Kosova e ka dhënë shumë herë provimin, sa i përket respektimit të vlerave fetare dhe besoj që këtë nuk e konteston askush. Nuk do të ishte mirë t'i imputohet Kuvendit diçka që nuk e ka. Por, vërejtja ime e dytë dhe kryesorja, procedurale, është që ne sot miratuar një paragraf të ligjit, është fjala për nenin 4.7. që absolvon këtë çështje. Pati një amendament alternativ, që nuk kaloi. Amendamenti që po shqyrtojmë është vetëm vazhdimësi e atij amendamenti. Nuk ka mundësi të miratojmë një amendament për një çështje dhe tash të diskutojmë për të kundërtën e tij, sepse edhe me Rregulloren të Kuvendit, kur janë dy amendamente që e përjashtojnë njëra-tjetrën ose e nënkuptojnë njëra-tjetrën, me vetë vendimin për një amendament, nënkuptohet që është vendosur edhe për tjetrin.

S'mundet p.sh. Kuvendi tash të vendosë të kundërtën e asaj që vendosi një orë më përpara. Prandaj, zoti kryesues, nënkryetarë më saktë i Kuvendit, mendoj që ka qenë koha më herët që të hidhet në votim, mjafton të deklarohet një palë që është për një variant, pala tjetër, eventualisht deputetët që kanë bërë amendament ose janë angazhuar drejtpërdrejt në këtë proces dhe të vendoset, në mënyrë që të vazhdojmë me tjerat, se i kemi edhe një mal ligjesh, e po veprojmë në gusht, kur nuk vepron asnjë Kuvend. Le të jenë bile racional e ekonomik.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni! Jeni autor i Rregullores vetë dhe e dini që për secilin amendament deputetët kanë të drejtë të diskutojnë. Deputeti Asllanaj e ka fjalën.

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë së pari kam një vërejtje kështu, mendoj më shumë ndoshta morale, që ministrat aktual nuk do të duhej që të kyçen në debat parlamentar, sepse kur janë zgjedhur ministra, kanë dorëzuar këtë mandat dhe kanë kaluar në ministra dhe për temën aktuale do të duhej të flasë, të përgjigjet, të japë sqarime eventualisht ministri i Arsimit, kryeministri dhe askush tjetër.

Unë mendoj që është keqpërdorim i ministrit të Shëndetësisë dhe i zotit Jagxhillar, ministra që kanë dalë për të dhënë, të llojnë për një amendament, i cili është në kundërshtim me propozimin, pikërisht të ministrit të Ministrisë së Arsimit. Konsideroj që do të duhej të flasim me një gjuhë.

Tjetër fenomen që shoh këtu, sot, në debat, për të cilin pata rezerva të bisedoj, është që është një tendencë pak të shantazhohet partia në pushtet, PDK-ja, nga një partner i vogël qeverisës. Ju lutem, mos e përdorni shantazhimin, sepse askund nuk kam dëgjuar në fushatën elektorale të PDK-së që ka qenë për arsim fetar në arsimin parauniversitar, nuk e kam dëgjuar, e kam dëgjuar vetëm nga Partia e Drejtësisë, gjegjësisht nga Koalicioni për Kosovën e Re dhe nga asnjë parti tjetër.

Kjo dëshmon që është një disponim në Kosovë që për momentin nuk është koha që të futemi në arsimin fetar në Kosovë. Dhe, kjo e shton këtë argument, edhe refuzimi që bën një komunitet fetar, siç është komuniteti i krishterë-katolikë në Kosovë dhe realisht për

këto tema që janë shumë domethënëse, shumë parimore do të duhej të kishte një debat shumë më të gjerë, me një konsensus të plotë dhe jo si një debat i kyçur shpejt e shpejt, në mënyrë që të kënaqen apetitet e një partneri të vogël të koalicionit qeveritar. Kjo është bindja ime. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në qoftë se nuk përmendni emra të kujt, janë edhe dy deputetë të fundit të paraqitur, Myzejene Selmani dhe Bekim Haxhiu. Mos na hapni telashe, me replika!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të drejtën ekskluzive për ndërtimin e Qeverisë e kanë pasur të gjitha partitë politike mbas procesit zgjedhor dhe është e drejtë e secilit të hyjë në koalicion me kënd të donë, ndërsa shantazhet kanë ndodhur edhe atëherë kur votat i kanë pasur shumë më shumë në mandatin e kaluar, të dy partitë politike që e kanë udhëhequr vendin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Vërtet, desha të jem i rezervuar në këtë pikë dhe, domethënë, deklarin ta jep me votim, mirëpo ministri i Shëndetësisë u thirr për të diskutuar për këtë amendament në emër të parimeve, të integriteteve dhe të vlerave evropiane.

Zoti ministër, sigurisht që nuk duhet të bëjmë politikë me fenë dhe kjo, si duket, edhe po debatohet për qëllime politike dhe disa vetëm këtu kanë këtë çështje apo, këta edhe propozuesit, këtë çështje e kanë ngritur për qëllime politike, për të bërë një reklamë, për të përfutur politikisht dhe absolutisht nuk ka qëllimin e një edukimi të mirëfilltë fetar dhe qytetar.

Ministri i Shëndetësisë do të duhej të merrej më tepër me problematikën në shëndetësi, për shkak se nuk është standard evropian 9 muaj mos të zgjedhet një drejtor i Qendrës Klinike Universitare, nuk është kurrfarë standardi evropian ai për të kërkuar pastaj standarde në një segment tjetër të shoqërisë, i cili nuk i takon.

Prandaj, do të duhej që vërtet, ky amendament, për shkak se edhe arsyetimi i propozuesit nuk ka fare arsyetim, nuk janë paraparë as mënyrat, as format se si duhet të rregullohet kjo çështje, prandaj mendoj që ndoshta në një kohë, më vonë, kur do të përgatiten më mirë, kjo çështje të debatohet apo të rregullohet me një udhëzim administrativë tash, për shkak se po shihet se disponimi nuk është as nga shumica dhe nuk ekziston një konsensus dhe krejt ky debat e ka vetëm një qëllim apo një reklamë politike dhe asgjë më tepër.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar kryeministri i Kosovës, zoti Thaçi.

HASHIM THAQI: Unë dëshiroj të sqaroj vetëm diçka përsëri, pasi që u përmend këtu edhe qëndrimet që kanë qenë më herët, edhe të partive, por edhe të Qeverisë apo të fushatave elektorale.

Mendoj që as dje, as sot, as nesër për gjërat e tilla nuk duhet të bëhet fushatë elektorale. Tjetër, ne duhet t'i respektojmë standardet evropiane, edhe unë personalisht, edhe si kryeministër edhe si kryetar i partisë më të madhe në vend, e kam pasur dhe e kam qëndrimin sot dhe do ta mbaj sot e përgjithmonë kundër diskriminimit fetar dhe etnik, kam pasur, kam dhe do të kem qëndrim edhe nesër edhe sa i përket ndërtimit të monumenteve fetare të gjitha besimeve në Qendër të Prishtinës dhe qëndrimin tim nuk e fsheh për shkak të zhvillimeve politike. Qëndrimi im është kushtetues, ligjor, me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës dhe i standardeve evropiane. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! E qes në votim amendamentin e 8-të. Diskutime tjera nuk ka. Amendamenti i 8-të është i propozuar nga Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, SLS, “6+” dhe nuk mbështetet nga komisioni funksional dhe Komisioni për Legjislacion.

Ata që janë për ta votuar amendamentin e propozuar, votojnë “për”, ata që janë kundër votojnë “kundër”, që do të thotë janë për variantin që e ka propozuar komisioni funksional dhe Komisioni për Legjislacion.

Edhe një herë, “kundër” kush voton, voton për propozimin e komisionit funksional dhe Komisionit për Legjislacion, “për” ata që votojnë për grupin parlamentar. Votojmë tani!

Ka pa kartelë? Atëherë, konstatoj se nuk miratohet amendamenti i 8-të, 64 vota janë “kundër”, 1 abstenim dhe 18 vota janë “për”.

Vazhdojmë me Amendamentin 9
“Kundër”, s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 10
“Kundër”, s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 11
“Kundër”, s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 12
“Kundër”, s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 13
“Kundër”, s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 14, ka dy propozime:

- a). Është propozimi i komisionit funksional dhe,
- b). Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, pa përkrahjen e komisionit funksional

Atëherë, e qesim në votim propozimin e komisionit funksional me votim elektronik, votojmë tani.

Faleminderit! 57 vota “për”, 4 abstenime, 1 votë “kundër”, miratohet propozimi i komisionit funksional, rrëzohet propozimi i Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”. Faleminderit!

Amendamentin 15
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 16
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 17
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 18
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 19, Grupi Parlamentar “6+”, pa përkrahjen e komisionit funksional dhe të Komisionit për Legjislacion. Edhe ky duhet t’i nënshtrohet votimit elektronik. Pra, votojmë amendamentin e 19-të të Grupit Parlamentar “6+”, pa përkrahjen e komisionit funksional dhe të Komisionit për Legjislacion, d.m.th. dy komisionet kryesore për miratim janë “kundër”. Ata që votojnë “për” Grupin Parlamentar “6+”, propozimin e Grupit Parlamentar “6+”, votojnë “për”, ata që janë për mbështetje të komisionit funksional dhe Komisionit për Legjislacion, votojnë “kundër”. Votojmë tani!

Faleminderit! Me 49 vota bie propozimi për amendamentin e 19-të të Grupit Parlamentar “6+”, 20 vota janë “për”, 2 abstenime. Nuk miratohet.

Amendamentin 20
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 21
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 22
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 23
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 24
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamentin 25, Grupi Parlamentar “6+”, pa përkrahjen e komisionit funksional ...

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: A, me përkrahje... Më falni! Me përkrahjen e komisionit funksional, por pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion.

Tani, Komisioni për Legjislacion ose më mirë të themi, kryetari i komisionit, kërkon sqarim, zoti Gashi e keni fjalën!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Kjo çështje është diskutuar në Komisionin për Legjislacion dhe Komisioni Legjislacion ka vlerësuar se ky propozim është në kundërshtim me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës dhe po ashtu, për pasojë, edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse ky propozim thotë: “ Tekstet shkollore në gjuhët e komuniteteve, në të cilat është duke u zhvilluar mësimi për nivelet 1 dhe 2, ofrohen falas”. Kjo është një qasje diskriminuese. Tekstet shkollore për klasën e 1 dhe 2, ose duhet të ofrohen falas për të gjithë, ose mos të ofrohen falas për askënd.

Prandaj, kjo qasje e kualifikimit vetëm për një komunitet edhe disa komuniteteve tjera, është në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe si e tillë nuk duhet përkrahur. Faleminderit! Mund të bëhet, të ndryshohet që për të gjitha klasat e para dhe dyta, tekstet janë falas, atëherë nuk ka problem.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Vataj e ka kërkuar fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Këtu besoj që ka nevojë për një sqarim, sepse ky nen flet vetëm për librat që ju shpërndahen komuniteteve tjera, përveç atyre që janë në gjuhën shqipe dhe serbe. Ndërsa, edhe në të vërtetë aplikohet, gjithë nxënësit e nivelit 1 dhe 2, i marrin librat, këtu i kemi qitur sipas nevojës, pse të diskriminohen p.sh. turqit edhe boshnjakët, që në të vërtetë ata i marrin falas.

Pra, ky nen flet, neni para këtij flet për gjuhët zyrtare, po ta zëmë, ndërsa këtu për të komuniteteve duhet t'i ndajmë, nivelin 1 dhe 2, jepen librat falas, për të gjitha, edhe për shqiptarët, edhe për serbët, edhe këtu veç për komunitetet, kur është specifike, boshnjakët dhe turqit. Por, edhe ata i marrin...

KRYESUESI: Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Gashi, replikë ose sqarim shtesë.

ARBEN GASHI: Nuk desha replikë, veç desha një sqarim, se problemi është se kjo po ngritet në nivel ligji. Ajo që e tha zoti Vataj, qëndron por është në nivel vendimi qeveritar që librat shpërndahen falas. Atëherë, mund të merret vendim qeveritarë edhe për këto komunitete të shpërndahen falas, dhe jo të futet në ligj, se në momentin kur futet në ligj, bëhet një ligj diskriminues, prandaj është e panevojshme për të qenë ligj, sepse zgjidhet me një vendim qeveritar shumë kollaj. Ky është arsyetimi.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kervan e ka kërkuar fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

Dua të jap edhe unë një sqarim. Neni 26, i ligjit thotë: "Tekstet shkollore dhe mjetet tjera mësimore", ku përfshinë komunitetin në shumicë shqiptar, prandaj dallohet, natyrisht, komuniteti shumicë shqiptarë, kurse neni 27, titullin e ka, projektligji, neni 27: " Tekstet shkollore në gjuhët e komuniteteve". Ne nuk e futëm në projektligj prej zeros, veç në projektligj ekziston, por kemi bërë riformulim, te paragrafi i parë, ku flet për tekstet shkollore në gjuhën serbe dhe te paragrafi i dytë, ku flet për tekstet shkollore në gjuhët e komuniteteve, e kemi fjalën për komunitetet të cilat zhvillojnë arsimimin në nivel 1 dhe 2, aktualisht veç disa viteve që veç shpërndahen tekstet shkollore falas.

Prandaj, nuk është që na prej zeros e futëm, ka qenë në projektligj, jo diskriminues, por vetëm një riformulim është bërë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Gjini e ka kërkuar fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se duhet një sqarim i saktë me atë çka synohet të ndodhë, nëse amendamenti kalon kështu si është. Librat falas ju shkojnë të gjithë nxënësve në Kosovë dhe kur ministri merr vendim për të shpërndarë libra falas, merr vendim për nxënësit e të gjitha komuniteteve, jo vetëm për një komunitet. Dhe, shpërndarja e librave falas, nuk guxon të jetë subjekt i një ligji, do të thotë, asnjë Qeveri nuk guxon të jetë permanent e obliguar për të shpërndarë libra falas. Këto janë vendime dhe kanë edhe karakter ideologjik, fillimisht, dhe çështja e dytë është, nëse amendamenti futet kështu siç është, atëherë Kosova do të jetë e obliguar që vetëm për pakicat, të cilat përmenden, të jepen librat falas, nëse eventualisht ndonjëherë, ndonjë ministër e tërheq vendimin, i cili është në fuqi edhe sot.

Ne e mbështesim vendimin dhe mendojmë që nuk guxon të ketë diskriminim. Ne mendojmë që kurdo që nxënësit e cilitdo komunitet marrin libra falas, të gjitha komunitet duhet të marrin falas, mirëpo mendojmë se nëse kjo pikë kësisoj si është, futet në projektligj, Kosova do të vjen në pozitë që vetëm për pakicat të japë libra falas detyrimisht, ndërsa për shumicë jo.

Mendojmë se nuk është i nevojshëm edhe mendojmë se ekskluzivisht shkon në sistem të diskriminimit, për të cilin diskriminim nuk folëm deri më tani. D.m.th. po them edhe njëherë, e kemi diskutuar shumë gjatë në komision, kjo është esenca, ky amendament bën të jetë Kosova e obliguar në çfarëdo rrethana të japë libra falas për nxënësit e pakicave e jo për ata të shumicës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Unë desha, i nderuari nënkryetar, një sqarim, se kam përshtypjen se edhe sponsorët e këtij amendamenti nuk e sqaruan sa duhet. Në të vërtetë, se a duhet të jenë tekstet falas ose jo, e rregullon edhe propozimi i ligjit dhe amendamenti nuk e konteston këtë, nuk e ndryshon. Ndryshimi i vetëm është te ajo që është ndryshua në fillim dhe, për mendimin tim, është e diskutueshme a u bë mirë që u ndryshua, që “gjuhët jo zyrtare” u zëvendësua me “gjuhët e komuniteteve” dhe ky është ndryshimi që është propozuar nga grupi i deputetëve që janë parashtruar këtu.

Nëse është kjo, për mendimin tim, ia vlen që ta kemi parasysh edhe njëherë vërejtjen që bëri deputeti, harrova emrin, që thotë se në Kushtetutën e Kosovës është e vërtetë që ka një dispozitë që thotë se pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të marrin arsimimin publik parafillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, thotë - pjesëtarët e komuniteteve dhe komunitet, si i tillë. Nëse kjo interpretohet saktë, atëherë del në gjuhën e komuniteteve, sepse është kështu shkruan në Kushtetutë. Prandaj, mendoj që amendamenti mund të miratohet, sepse nuk ndryshon, kurse kjo çështje mbetet të harmonizohet në procesin e harmonizimit të standardizimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REXHEPI: Zahvaljujem!

Bošnjačkoj zajednici je od velike važnosti da se podrži besplatno dodeljivanje udžbenika učenicima osnovne škole, koji su na svim jezicima Kosova i zato nam je jako bitan i onaj zakon koji je malo pre podržan, tako da podržavam predstavnika turske zajednice po ovom pitanju. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryesues!

Edhe një sqarim shtesë. Neni 26, pika 4, thotë: “Tekstet shkollore të miratuara nga Këshilli drejtues i nivelit të 1 dhe 2, në bazë të paragrafit 2, të këtij neni, ofrohen falas për shqiptarët”.

Neni 27, thotë: “Tekstet shkollore dhe materialet e tjera në gjuhën serbe, do të përdoren, siç është përcaktuar në ligjin në fuqi dhe jepen falas”. Këtu, veç turqit dhe boshnjakët janë ndarë. Ky është një diskriminim i madh, të lutem!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Idriz Vehapi e ka fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Zoti kryesues, do të mundohem të jem shumë i qartë, por le të dëgjojnë deputetët. Tekstet shkollore për nivelin 1 dhe 2, në gjuhën shqipe dhe serbe jepen falas. Ka komunitete që janë, komunitete jo shumicë, por mësojnë ose në gjuhën serbe ose në gjuhën shqipe, niveli 1 dhe 2. Dhe, ata i marrin tekstet qoftë në gjuhën shqipe ose serbe, i marrin falas.

Ne këtu kemi menduar që komunitetet tjera në të cilat është duke u zhvilluar mësimi në nivelin 1 dhe 2 në gjuhët e tyre, të jepen falas, se ato edhe ashtu jepen. Dhe, e kemi hequr atë “sipas nevojës”, sepse ka komunitete, të cilat nuk e zhvillojnë mësimin në nivelin 1 dhe 2 në gjuhët e tyre, sepse nuk ka as kurrikul, pritet ndoshta, në një të ardhme tjetër të bëhet. Faleminderit! Kështu kemi menduar ne.

KRYESUESI: Ministri Buja e ka fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: Shikoni, unë, besoj që e dimë bashkë që cilësimet, sqarimet e printuara, tëholluara janë nganjëherë të panevojshme dhe konfuze. Unë ju propozoj që të mbetet si është në projektligj, sepse sqaron mjaftë, dihet kush, kur, si, kujt i jepen librat falas dhe është i panevojshëm ky sqarim dhe ky debat që po bëhet, sepse në fakt është e sqaruar besoj mirë dhe unë ju propozoj që të votohet ashtu siç është në nenin e caktuar dhe të mos ketë nevojë të bëhet amendamentim fare. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Atëherë, rregullat e votimit i dimë të gjithë, votojmë amendamentin 25, të Grupit Parlamentar “6+”, me përkrahjen e komisionit funksional, por pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion. Votojmë tani!

Në sallë janë 71 deputetë.

Faleminderit! Konstatohet që miratohet amendamenti me 43 vota, 3 abstenime dhe 24 vota “kundër”.

Amendamenti 26

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 27

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 28
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 29
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 30
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 31
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 32,
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 33
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 34
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 35
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 36
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 37
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 38
“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 39, i fundit,

“Kundër”, s’ka, abstenim, s’ka.
Miratohet.

Tani, votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim, votojmë tani.

Faleminderit! Konstatohet se, me 68 vota “për”, 1 abstenim dhe 2 vota “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

A jeni për pauzë? Atëherë, deri në ora 15:00.

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejton seancën: nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet i Qeverisë,
Po vazhdojmë seancën e filluar në mëngjes dhe po vazhdojmë me të njëjtën procedurë miratimit e amendamenteve.
Vazhdojmë me pikën e 5-të të rendit të ditës, që është:

5. Shqyrtimi i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare dhe Kuvendit ia kanë parashtruar raportet me rekomandime.
Pyes kryetarin e Komisionit funksional, a do fjalën? Nuk e do fjalën.
Atëherë, vazhdojmë me miratimin e amendamenteve.

Amendamenti 1
“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 2
“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 3
“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 4
“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 5

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 65 deputetë.

Lus deputetët për votim. Votojmë tani. Faleminderit!

Konstatohet se me 53 vota “për”, 1 abstenim dhe 1 “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit dhe Kuvendit ia kanë parashtruar raportet me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional, deputetin Zenun Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Regjia deputetit Pajaziti fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Energjetikë e ka trajtuar, e ka shqyrtuar këtë projektligj. Konsideron që i plotëson të gjitha kushtet. Ka trajtuar edhe disa nene të veçanta dhe i rekomandon Kuvendit aprovimin. Faleminderit!

KRYESUESI: Vazhdojmë me votimin. Projektligji ka 25 amendamente.

Fillojmë me amendamentin 1

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 2

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 3

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 4

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 5

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 6

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 7

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 8

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 9

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 10

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 11

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 12

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 13

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 14

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 15

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 16

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 17

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 18

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 19

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 20

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 21

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 22

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 23

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 24

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 25

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Të nderuar deputetë, votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet.

Lus deputetët të përgatiten për votim!

Votojmë tani!

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

KRYESUESI: Pika e shtatë e rendit të ditës është:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës

Komisionet tjera kanë shqyrtuar dhe kanë dhënë mendimin për ligjin dhe kanë bërë shqyrtimin e tij. Komisioni për Legjislacion nuk ka arritur që ta shqyrtojë. Kërkoj mendimin e kryetarit të Komisionit për Legjislacion.

A po mendon që duhet ta vazhdojmë votimin, apo ka nevojë për një shqyrtim shtesë?

Zoti Gashi, e ka fjalën, në emër të Komisionit të Legjislacionit.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar, mirëpo ka arritur në përfundimin që t’ia rekomandojë Komisionit për Buxhet, që të shohë se çka mund ta modifikojë në aspektin e mundësisë së konfliktualitetit me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, ku thuhet se ZKA për çështje për komunë është kryetari i komunës, ndërsa Ligji për qeverisjen lokale thotë që kryetari i komunës zgjidhet drejtpërsëdrejti nga votat e qytetarëve. Prandaj, mbetet që nëse komisioni funksional e ka zgjidhur këtë çështje, atëherë Komisioni për Legjislacion mund të konkludojë se është në harmoni me ligjet, përndryshe mund të shkaktohet problem. Ky është konkluzioni që ia kam dërguar edhe Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Hadërgjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, pas një pune intensive që ka bërë Grupi Parlamentar, i cili është caktuar menjëherë pas kalimit në lexim të parë të këtij projektligji, në mbledhjen e mbajtur më 24 gusht, në pajtim me rregullat e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, e ka miratuar unanimisht raportin me amendamente, këtë raport që kemi këtu dhe i ka rekomanduar Kuvendit, që ta miratojë.

I nderuar zoti nënkryetar, me planin e veprimit të Kuvendit, që ka të bëjë me sfidat e Raportit të Progresit, është paraparë që gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, të bëjmë harmonizimin e dispozitave të këtij ligji me përfaqësuesit e Komisionit Evropian.

Komisioni për Buxhet e Financa ka harmonizuar qëndrimet me përfaqësuesit e Komisionit Evropian.

Ne kemi diskutuar disa herë me kryetarin e Komisionit për Legjislacion në lidhje me kërkesën që po bëhet tani dhe dua të jap vetëm disa sqarime në lidhje me kërkesën që ka bërë në fillim të seancës, kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në grupin punues që ka punuar në këtë projektligj është ngritur çështja e mos nënshkrimit të kontratave nga ana e kryetarëve të komunave. Këtë çështje e ka ngritur zëvendëskryetari i parë i Komisionit, që është Naser Osmani dhe ne kemi diskutuar bashkë me Komisionin, që edhe kryetarët e komunave, por edhe ministrat, nuk është e arsyeshme që të nënshkruajnë kontrata. Ne kemi marrë rekomandimin nga ana e Komisionit Evropian, që thotë kështu.

- Rekomandohet që kërkesa për nënshkrimin e kontratave të qëndrojë edhe më tutje, d.m.th. kërkesa për nënshkrim nga ana e ZKA-së, ku hyn edhe kryetari i komunës, por edhe nga ana e ministrave.

Në Raportin e Progresit, dua t'ua përkujtoj deputetëve, në pikën 75, ku kemi marrë vërejtje, ka qenë e shënuar decidivisht kështu.

- Përgjegjësia për proceset e prokurimit duhet të zgjerohet, për t'i përfshirë jo vetëm zyrtarët e prokurimit, por edhe eprorët e tyre, si në nivelin administrativ, po ashtu edhe në atë politik.

Prandaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa, pasi ka diskutuar edhe me Komisionin Evropian dhe pas një debati që është bërë edhe në grupin punues, por edhe në komision, ka arritur në përfundim që të miratohet amendamenti i 5-të, që është në ligj, siç është kështu – amendamenti 5 i ndryshuar. Ne kemi arritur vetëm një gjë ta ndryshojmë aty, që kryetarët e komunave, por edhe ministrat të mos merren me nënshkrimin e kontratave të mesme, por të nënshkruajnë vetëm kontratat e mëdha, kurse në ligj ka qenë që t'i nënshkruajnë edhe kontratat e mesme edhe kontratat e mëdha. Pra, hiqen – kontratat e mesme, dhe mbesin që të nënshkruhen nga ministrat dhe kryetarët e komunave, kontratat me vlerë të madhe. Kurse, Komisioni për Buxhet ka arritur të bëjë edhe në kuadër të këtij amendamenti, të përjashtohen: kryeministri, presidentja dhe kryetari i Kuvendit nga nënshkrimi i kontratave. Pra, kështu kemi arritur në një konsensus edhe me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, prandaj unë i rekomandoj Kuvendit në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, t'i përkrahë rekomandimet që i ka dhënë Komisioni për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Mendoj që është e qartë, rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe rekomandimi i Komisionit Evropian dhe duke pasur parasysh edhe pse e kemi futur në rishqyrtim këtë ligj, mendoj që duhet ta procedojmë sot, kështu siç është.

Zoti Naser Osmani e ka kërkuar fjalën.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, nënkryetar!

Është një çështje jashtëzakonisht delikate dhe unë i lus deputetët që ta kenë parasysh. Unë mendova që kur të vijmë te amendamenti 5, të stopohet kjo për një diskutim, por meqenëse nuk ka asnjë telashe tjetër rreth këtij ligji e konsideroj të arsyeshme të bisedojmë.

E vërteta është që, organet politike, d.m.th. ata që janë me votën e popullit, nuk ish dashur që të jenë nënshkrues të një dokumenti, që nuk marrin pjesë në procesin administrativ të hartimit apo të procedurave deri te ardhja e asaj kontrate. Një.

E dyta, nuk është standard sepse edhe hartuesit, apo kontraktuesit, apo ajo kompani që e ka marrë prej Agjencisë Evropiane “Planet” ta bëjnë këtë ligj, pranojnë që këtë çështje, asnjë shtet në Evropë kështu s’e ka të rregulluar, vetëm Kosova. Pse na të identifikohemi dhe të na etiketojnë ata neve me diçka kur nuk është ashtu e rregulluar kurrkund tjetër? Një çështje që duhet ta kemi parasysh, fjala ka të bëjë vetëm me ata që janë – siç quhen “puro” ekzekutiv, ata duhet të vënë nënshkrim, mirëpo i zgjedhuri i popullit të vë nënshkrim në një dokument, që ka pasur një procedurë administrative, konsideroj që nuk është e drejtë.

Edhe një çështje që është shumë me rëndësi - e përmendi kryetarja. Tash këta që e kanë punuar këtë ligj, zoti zëvendëskryetar, e kanë qitur kontratat t’i nënshkruajë: presidenti, kryeparlamentari dhe kryeministri. Ne i kemi hequr edhe s’ka logjikë që një kryetar Parlamenti të marrë përgjegjësinë e kontratave, që kanë të bëjnë me procesin e prokurimit. Dhe, unë konsideroj, për të kaluar ky ligj i mirë dhe të mos mund të kontestohet as nga BE-ja as nga kurrkush është që, te amendamenti 5 paragrafi 3, përveç presidentit, kryetarit të Parlamentit edhe kryeministrit edhe kryetarët e komunave lirohen nga nënshkrimi. Dhe, krejt ekzekutivi tjetër është okej, që është edhe qëllimi fundamental i Agjencionit Evropian.

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Gjini e ka kërkuar fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!
Nëse kemi ardhur deri të pika ta votojmë kështu d.m.th. këtë amendament, atëherë mendoj se vlen, që në pjesën ku flitet për kryetarin e Kosovës, kryetarin e Kuvendit dhe kryeministrin, të jenë edhe kryetarët e komunave. Sidoqoftë, mendoj se duhet për Kuvendin e Kosovës ta ketë të qartë se, prej ku është nisur procesi dhe ku kemi mbërri, kemi devijuar prej qëllimit. Domethënë, po dalim prej asaj pse ka filluar i gjithë ky proces dhe ku ka lindur ideja që udhëheqësit e institucioneve, qofshin ata kryetarë të komunave ose edhe kryeministri ose edhe ministrat, ta nënshkruajnë një formular, me të cilin dëshmojnë se janë në dijeni me atë që ka ndodhur në institucionin që e drejtojnë, ka ardhur për shkak se ka pasur probleme me arritjen deri të përgjegjësia penale për shkelje të rënda korruptive në institucionet e Republikës së Kosovës, për shkak se në asnjë mënyrë politika nuk mban përgjegjësi për atë që ndodhë e në jetën e përditshme, ne e dimë që përgjegjësia definitive dhe finale bie te politika.

Tani, ka shtete që rregullimin e vet administrativ e kanë të tillë që sekretarët e shtetit janë të emëruar politikë, do të thotë ministri i emëron. Dhe, nëse i emëron ministri, në momentin që ka shkelje, e ato dokumente i nënshkruan ai sekretar i shtetit definitivisht, atëherë edhe ministri e mban përgjegjësinë për shkak se e ka emëruar vetë një njeri. Dhe nuk ka nevojë vetë ta nënshkruajë, kur i emëruari i tij e nënshkruan. Me këto çka po i bëjmë ne, nuk po gjejmë zgjidhje të saktë, që të paktën një i emëruar i udhëheqësit politik të institucioneve e nënshkruan. Do të thotë, që të kemi njëfarë lidhje të drejtpërdrejtë edhe legale edhe penale, jo vetëm morale, nëse ndonjë institucion eventualisht do të kishte raste të korrupsionit.

Ajo që unë dua të them këtu është se mendoj se edhe një herë do ta kalojmë një ligj, dhe, Grupi Parlamentar i Aleancës do ta votojë propozimin që, nëse hiqen: kryeministri, kryetari i Kuvendit, dhe kryetari i Kosovës, të hiqen edhe kryetarët e komunave, sepse zgjidhen drejtpërdrejtë prej popullit, me siguri se kemi për të ardhur në një ditë që këtë ligj ta amendojmë edhe një herë, për shkak se nuk po krijojmë lidhje legale, ose përgjegjësi legale të zgjedhurve politikë me proceset e prokurimit, dhe ma merr mendja që nuk kemi nevojë, pa dashur ta akuzojmë askënd, nuk kemi nevojë ta elaborojmë se një përgjegjësi serioze politike bie ekzaktë mbi të zgjedhurit politik e jo mbi administratën, kur kemi të bëjmë me shkelje të rënda. D.m.th. edhe një herë po them, mendoj se është mirë që të thuhet, është mirë që të mbetet në transkript, nuk e kemi gjetur formulën se si t'i mbajmë përgjegjës të zgjedhurit politikë për rastet të cilat ndodhin nëpër institucionet të cilat i zgjedhim me këtë formulë.

Meqenëse, ky ligj duhet të kalojë dhe, ne pajtohemi se duhet të kalojë, ne sot do ta votojmë propozimin, që nëse tre udhëheqës të institucioneve më të larta të shtetit të hiqen nga kjo listë, të hiqen edhe kryetarët e komunave, sepse zgjidhen drejtpërdrejtë prej popullit, është njëfarë justifikimi valid në këtë rast, mendoj, se shumë shpejtë Kuvendi i Kosovës, duhet të gjejë mënyrë, që edhe këta që hiqen prej listës, të mbahen përgjegjës, në fund të fundit, të paktën duke e pas një përfaqësues të vetin, i cili do të jetë i vetëdijshëm me të gjitha rastet e prokurimit, të paktën me rastet e mëdha të prokurimit të vlerave të mëdha, siç u përmend këtu me të drejtë, nga deputeti Osmani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Ne po diskutojmë për një ligj që ka kaluar në Kuvend në legjislaturën e kaluar dhe problem ka qenë pikërisht ky nen, që nuk është votuar në sallën e Parlamentit të Kosovës. Po, atëherë kemi pasur një situatë të cilën unë dua të ma sqarojë ministri i resorit këtu ose zëvendëskryeministri ose kush jep përgjigje para seancës në këtë rast?

A ekziston ende në fuqi urdhëresa administrative, e cila i urdhëronte që këtë nënshkrim ta bëjnë ministrat asokohe? A ka funksionuar ajo deri sot, a nuk funksionon, apo do të legjitimohet dhe të legalizohet me këtë nen nëse votohet sot ose nuk votohet? Po dua shpjegim, sepse është një histori e kaluar në këtë Kuvend dhe pa farë ndryshimi po sillet sot këtu. Është e nevojshme që të thuhet kjo që po pyes unë. A ekziston në fuqi një urdhëresë administrative që atëherë i detyronte ose iu jepte leje t'i bëjnë këto nënshkrime

ministrat? Dhe, çka ka ndodhur pasi që nuk është votuar në Kuvend, se unë sa di ligji mbasandaj nuk është nënshkruar ose s'ka hyrë në fuqi kurrë. A ka hyrë apo s'ka hyrë ai variant?

KRYESUESI: Zëvendëskryeministri Kuçi e ka fjalën.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë, anëtarë të Qeverisë,

Po provoj që profesor Hamiti, por indirekt ndoshta edhe disa deputetëve, t'iu jap përgjigjen adekuate.

E para i nderuar, zoti Hamiti, ne nuk kemi pasur mundësi që ta zbatojmë atë udhëzim administrativ, pasi që ligji s'ka hyrë në fuqi dhe në momentin që s'ka hyrë, ka mbetur ligji paraprak dhe udhëzimet administrative kundër ligjit nuk mund të jenë në fuqi.

Çështja e dytë, ne kemi mbështetur një logjikë të tillë, Qeveria e Kosovës, që të jenë edhe përfaqësuesit e lartë, përfshirë edhe ministrat, përfshirë edhe kryeministrin, ne e kemi mbështetur si Qeveri, që të jenë pjesë e nënshkrimit. Nuk është çështje e vullnetit tonë dhe nuk është çështje e praktikave të shumta në Union Evropian apo diku tjetër, por, një çështje e një kërkesë të Komisionit Evropian, që besoj secili prej jush në këtë sallë, në veçanti kryetarët e komisioneve janë ballafaquar me një kërkesë të tillë. Dhe Komisioni Evropian, për arsye të ndryshme, që deri diku edhe zoti Gjini mund të ketë të drejtë, kanë ardhur në një përfundim që duhet të ketë nënshkrime të tilla. Dhe, ne si ministra, nuk kemi dëshirë t'i nënshkruajmë ato çështje, se përgjegjësia politike ka qenë në çdo rast, por në këtë rast do të jetë edhe përgjegjësia penale, për veprime të tilla. Por, këtu besoj, duhet të bisedojmë në mënyrë parimore. Nuk kemi të bëjmë këtu, a duhet kryetari, a duhet kryeministri, a duhet ky, këtu kemi të bëjmë ta rrisim përgjegjësinë për të gjithë përfaqësuesit e institucioneve? Kur themi për të gjithë, unë personalisht jam të jetë edhe presidentja, edhe kryeministri edhe kryetari i Kuvendit edhe ministrat dhe kryetarët e komunave. Po të hymë në elaborim juridik, kush është i zgjedhur kush jo, besoj që nuk na tingëllon mirë, se edhe ne që jemi ministra, kemi nga pak vota jemi diku. Kjo nuk është logjika juridike, ndërsa, në anën tjetër në nivel komunal, emërimi i drejtorëve bëhet nga kryetari i komunës. Në ministri emërimi i sekretarëve mund të ketë ndikim ministri, ne nuk gënjejmë, por, jo emërim direkt. Emërimi i drejtorit për prokurim nuk bëhet nga unë. Unë mund të kem ndikim duke iu thënë njerëzve, bëje këtë ose jo, por legalisht nuk kam të drejtë ta bëjë këtë. Çka do të thotë, përgjegjësia në këtë rast, unë mendoj se duhet ta bëjmë, ta provojmë një vit së paku, ky Kuvend është këtu, njerëzit do të jenë këtu, do ta shohim si mbetet. Vitin e kaluar, ligji është miratuar pa këtë nen, dhe në Raportin e Progresit është konsideruar se ligji s'i ka plotësuar kushtet. Vetëm ky nen ka qenë telashe. Edhe këtë vit, i vetmi ky nen është që konsiderohet, përndryshe, çështja e prokurimit në Kosovë nuk është problem vetëm i ligjit, është problem i strukturave, i mentaliteteve. Por, me rritjen e shkallës së përgjegjësisë, po e them unë në mënyrë të sinqertë, besoj secili prej nesh që jemi në ndonjë pozicion, do të jem shumë i kujdesshëm cila kontratë do të hyjë në fuqi, ditën kur unë do ta kem nënshkrimin, në momentin që ikën dikush nga nënshkrimi, pastaj do të jetë kujdesi më i vogël. Unë ju ftoj, deputetë të nderuar, ta marrim përgjegjësinë tani, jo për deputetët por, për të gjithë ne, që bëjmë

institucione ekzekutive, t'i bëjmë këto përgjegjësi po veprojmë për një vit, po e marrim përgjegjësinë, pas një viti po e rishikojmë ligjin dhe ta shohim a është efektiv apo jo? Nëse bëjmë përjashtime të tilla pastaj jemi shumë të qartë, që ligji nuk do ta plotësojë synimin që ka Komisioni Evropian.

Ne kemi diskutuar, besoj edhe deputetët e opozitës dhe të pozitës, edhe me përfaqësuesit e Komisionit Evropian dhe qëllimi, synimi dhe propozimi i tyre është, të mos përjashtohen kryetarët e komunave. Unë e di që kryetarët e komunave tash mund t'i tingëllojë dikujt keq, ju e dini që edhe ministrat nëse na pyesin neve veç e veç, edhe ne ndoshta s'kishim pasur dëshirë. Është një përgjegjësi shtesë, që po kërkohet, është një standard që po kërkohet për t'ia vënë Kosovës dhe unë mendoj që duhet ta respektojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hamiti, kërkon një sqarim.

SABRI HAMITI: Faleminderit për precizimin, zoti zëvendëskryeministër!

Unë, meqë e di historinë edhe e thashë dhe me qëllim e thashë, problemi është që të sqarohet këtu, sepse nëse kjo që tha zëvendëskryeministri është qëndrim edhe aktual i Qeverisë, atëherë le ta thotë që Qeveria nuk mbështet asfarë ndryshimi, qoftë të Komisionit, në kuptimin e sponzoruesit të ligjit. Dhe, është mirë të krijojmë qartësi, gjithmonë. D.m.th. Qeveria mbetet nga ajo që s'përjashtohet askush, as kryeministri, as kryetari i Kuvendit, as kryetarja e Kosovës, përfshirë natyrisht dhe. Ky d.m.th. është qëndrimi i Qeverisë, atëherë, është loja e Parlamentit a e ndryshon a jo? Po është gjithmonë me rëndësi se po vijmë me qëndrime të dyzuara. Herën tjetër ka qenë e njëjta gjë, a? Udhëzimi administrativ qysh ka funksionuar s'e di, por kur e kemi pasur ligjin në votim, ai ka ekzistuar. Letrën e kem pasur në dorë. Qysh ka funksionuar nuk e di. Empirikisht s'di sa ka funksionuar, po ai udhëzim ka qenë para se të mos e votojmë në këtë variant. Kjo është e vërteta. Prandaj, nëse sot Qeveria qëndron në ligjin primar, që ka ardhur në Kuvend, ajo i bie që, jo që s'do të shtojë njerëz, a që i ikin kësaj detyre, po hiqen edhe këta të tretë, unë sa kuptova. Kaq. Faleminderës!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Kuçi, a jeni dakord me atë që e tha Hamiti lidhur me amendamentin e 5-të, si Qeveri po them?

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Unë mendoj që, po e precizoj edhe më tej, ndoshta s'isha drejtpërdrejt i qartë. Qeveria e Republikës së Kosovës qëndron prapa draftit që ka sjellë në Kuvendin e Kosovës dhe atë draft e kemi punuar ose, dua të them, është punuar nga ekspertët e Komisionit Evropian. E kemi pranuar në Qeveri, e kemi votuar me konsensus dhe me bindje të plotë që ta biem në Kuvend, dhe, unë e ftoj Kuvendin që ta mbështes këtë qëndrim të Qeverisë, që në radhë të parë ka të bëjë me njerëzit e Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, Qeveria propozon që të mos votohet amendamenti i 5-të, hiç.

Fjalën e ka kërkuar Sali Asllanaj.

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë mendoj që kërkesat e Komisionit Evropian rrjedhin nga logjika e tillë, që vlerësohet që korrupsioni është në nivel të lartë në Kosovë dhe, përgjegjës kryesor pikërisht i konsiderojnë të zgjedhurit politikë. Prej këtij këndi pikërisht është kjo kërkesë, por mendoj që teknikisht sikur është i pamundur ky zbatim, sepse konsideroj që një ministri apo një kryetar i komunës që i ka 200-300, të themi tenderë, do të duhej ose të zhvendoste karrigen e vet në zyrën e prokurimit, ose ta ketë një këshilltar, një sekretar permanent shumë të besueshëm që ai ta kryejë punën e tij. Tash do të duhej ndoshta të bëj edhe ndryshime shtesë në mënyrë që të plotësohet ky kusht nga ministri, nga kryetari, apo nga funksionarët tjerë. Në këtë aspekt, unë mendoj që realisht ideja është shumë e mirë, që të rritet transparenca, të rritet përgjegjësia e të zgjedhurve, por është në kundërshtim në mes të funksioneve të zgjedhura politike, funksionarëve të zgjedhur politikë edhe administratës. Në këtë aspekt, sikur po e legalizojmë ndërhyrjen e politikës në administratë. Thashë, është një kundërthënie në mes këtyre dy gjërave, por, është kërkesë e Komisionit Evropian. Mund të shkojmë ta pranojmë dhe e votojmë.

KRYESUESI: Zoti Kuçi e ka fjalën.

HAJREDIN KUÇI: Shikoni, unë besoj që secili prej nesh e ka menduar, dhe po e them, po e mbroj një qëndrim dhe Qeveria po e mbron një qëndrim, se në radhë të parë ka të bëjë me Qeverinë, në këtë rast.

Çështja e dytë, që e tha zoti Asllanaj, unë mendoj se është e kundërta, zoti Asllanaj. Jo që po legalizohet ndërhyrja e politikës në administratë, por e kundërta, po rritet përgjegjësia e administratës edhe për personat politikë. Këtu kemi të bëjmë me kontratat e mëdha. Unë jam i bindur, ju keni qenë kryetar komune, unë jam si frik ministër, kontratat e mëdha i keni ditur. Dhe, unë besoj tash është mirë t'i dimë edhe me letra. Ta qesim nënshkrimin edhe ne dhe ta marrim përgjegjësinë secili prej nesh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

S'ka replikë.

Zoti Beqiri, e keni kërkuar fjalën!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Naseri e tha nën propozimin që ishte, që u tha edhe në fillim por, unë mendoj, meqenëse zoti Kuçi e tha që ashtu si e ka propozuar Qeveria, janë të përfshirë edhe tre zyrtarë të lartë, nuk është problemi këtu tash që këta janë hequr e po duhet hequr edhe dike. Edhe unë mendoj dhe jam shumë i bindur që, absolutisht shans nuk ka që kryetarët e komunave t' i menaxhojnë dhe t' i nënshkruajnë kontratat, dhe unë mendoj që ato do të jenë peng i njerëzve dhe kurdo ata do të jenë të shantazhuar. Kjo logjikë është shumë e keqe dhe e mbrapshtë. Një kryetar komune të merret me 200 lëndë, a mendoni ju kolegë të nderuar, që dikush aty nga Zyra e Prokurimit mund të bëjë punë, e cila drejtpërdrejt e çon në përgjegjësi kryetarin, fare pa qenë i informuar. Ja qesin, kanë konkurrua kaq, ka bërë këtë, ka mundësi ta luftojmë ndryshe korrupsionin.

Nëse mendohet ta luftojmë veç përmes ministrave, në këtë rast përmes kryetarëve, është gabim. Dhe, një logjikë e tillë, ju e thatë vet asnjë vend i Bashkimit Evropian s'e praktikon këtë. Dhe, ne nuk kemi nevojë të bëjmë eksperimente. Korrupsioni luftohet ndryshe, nuk luftohet kështu, që tash kësaj valleje t'i bashkëngjiten, të shantazhohen, të jenë pre, pse jo edhe i presioneve, vetë kryetarët në këtë rast të komunave si të zgjedhur. Nuk mendoj edhe nuk qëndron, që kryetarët e komunave janë njësoj si të tjerët.

Është e vërtetë që dikush ka marrë vota, nuk kontestohet kjo, por, kryetari është zgjedhur drejtpërdrejt me votë dhe e kryen atë detyrë. Prandaj, përgjegjësia politike në këtë rast edhe ekzekutive, ne nuk jemi të përgatitur dhe nuk kemi stafe të tilla të përgatitura që kryetarit t'ia përgatitë të gjitha dosjet, e ta sjell. Unë jam i bindur që kështu kanë për t'ia përgatitur dosjet për t'ia quar në burg -edhe ata njerëz, unë po e them shumë qartë këtë, të cilët, vërtetë ndoshta e kanë edhe këtë mision, po flas për kryetarët e komunave.

Prandaj, plotësisht konsideroj që është e arsyeshme që kryetarët e komunave me tre të tjerët këtu, institucionet përgjegjëse, të jenë të përjashtuar nga nënshkrimi i kontratave për një punë që s'e kanë punë realisht primare. Puna e kryetarit të komunës, ju e dini që është shumë gjithëpërfshirëse. Këtu ka kolegë që kanë qenë kryetarë. Dhe nëse ai bëhet, do të jetë peng, gjithë ditën veç t'i këqyrë letrat, sa kanë konkurruar, kush edhe mund të jetë që s'është fare profesional.

Prandaj, mos u bëni pre të shantazheve, sepse kështu mund t'i bëni. Ne, mund t'i bëjmë, nëse e votojmë që edhe këta të nënshkruajnë kontrata. Mendoj që kjo nuk është e qëlluar. Komisioni Evropian e ka thënë, por mendoj, se e kanë provuar diku tjetër që janë më të zhvilluar se ne.

KRYESUESI: Mua nuk më takon të polemizoj, ndoshta, po sidoqoftë unë jam dakord me atë që e tha zoti Kuçi, që e dimë pse na është kthyer ligji dhe duhet pasur parasysh këtë.

Fjalën e ka kërkuar zoti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar ka debatuar për këtë çështje gjërë gjatë dhe them me përgjegjësi të plotë, me seriozitetin dhe përgjegjësinë më të madhe. Ky ligj nuk është për herë të parë që vjen në Parlamentin e Kosovës. U tha këtu shumë qartë, u elaborua edhe nga kryetarja e Komisionit edhe nga zëvendëskryeministri, por ne të gjithë po i dimë arsyet dhe i kemi shumë të qarta pse ky ligj na është rikthyer edhe sot. Qëllimi është ngritja e shkallës së përgjegjësisë. Nëse merremi me, për të shantazhuar është e paqëndrueshme. Partia Demokratike e ka numrin më të madh të kryetarëve të komunave, nëse nisemi nga ky këndvështrim. Por, megjithatë arsyet e kryetares së Komisionit, arsyetimet dhe argumentet që na i dha zëvendëskryeministri i Kosovës, ne na bëjnë shumë të qartë, dhe Grupi Parlamentar i PDK-së i përkrah rekomandimet e Komisionit dhe është për të votuar këtë ligj dhe u bën thirrje të gjithë deputetëve, që ta votojmë me qëllim të mos maltretimit tonë dhe mos të na rikthehet prapë ky ligj edhe në mandatin, apo edhe një herë ta marrim në shqyrtim dhe t'i kalojë të gjitha procedurat që ka kaluar deri më sot. Prandaj, ne u

bëjmë thirrje të gjithëve që vërtet të mos merren me paragjykime por, t'i bëjmë thirrje arsyes dhe të procedojmë më tutje. Kryetarët e komunave le të tregohen të vëmendshëm se çka do të nënshkruajnë. Mund të jetë pengesë, por, është edhe një e vërtetë se do ta ngre shkallën e përgjegjësisë edhe të kryetarit të komunës edhe të ministrave dhe të gjithë atyre që e vënë nënshkrimin në çdo dokument dhe do të jenë shumë më të vëmendshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani Ismet, kjo punë është histori. E kemi...Ju dëgjuam... po fol në emër tëndin, s'po fol në emër të Grupit... Në rregull, në rregull. Shiko, Ismet, qe tash po ta jap fjalën. Mendoj se jemi shumë të qartë të gjithë. Edhe për atë që po e thoni ju, edhe për atë qe e tha zëvendëskryeministri, edhe për atë që e tha kryetarja e Komisionit. Qysh të doni. Ne mund ta miratojmë sot dhe mund pas një javë dite t'i kemi vërejtjet e Komisionit Evropian.

Zoti Beqiri e keni fjalën.

ISMET BEQIRI: Kërkoj falje! Në emër të Grupit e tha Naseri, por edhe unë po e përsëris. Në fjalën e zotit Grabovci dolën dy çështje. Zoti zëvendëskryeministër është në PDK dhe ai e tha, ne qëndrojmë pranë qëndrimit që e kemi sjell draftin. Ky e tha që na e përkrahim propozimin e Komisionit, çka nënkupton 3 që u përmendën më herët. Por, po e lëmë këtë. Edhe një herë unë e mbështes atë që e thashë si kërkesë, që nëse përjashtohen, bëhen përjashtime, unë mendoj që më e arsyeshmja është, që të përjashtohen edhe nga kjo, jo nga përgjegjësia në punë, po e nënshkrimit të kontratave, për çka konsideroj se do të jenë edhe s'e kanë kompetencën e plotë edhe kryetarët.

Prandaj, këtu ishin tash dy. Ishte e Qeverisë, është edhe e zotit Grabovci, që e tha se e mbështesim Komisionin. Kaq.

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar kryeministri Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ju e dini se një ligj i tillë ka ardhur edhe më herët, mund të them lirisht se para një viti e pak më tepër ndoshta, apo ekzakt para një viti u kthye si u kthye, krejt në mënyrë të panevojshme, me një lobim jo të sinqertë, me një votim, gjithashtu, të diskutueshëm, Qeveria e Republikës së Kosovës ka proceduar përsëri projektligjin, dhe ne e mbështesim si Qeveri e Kosovës, draftin e propozuar nga Qeveria që të nënshkruajë edhe presidenti edhe kryetari i Parlamentit edhe kryeministri dhe ministrat edhe kryetarët e komunave. Prandaj, kjo rrit përgjegjësinë, e rrit transparencën, e rrit përkushtimin për rend dhe ligj, por edhe për luftimin e dukurive negative. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti kryeministër!

Për mua është e qartë.

Zoti Adem Grabovci, e ka fjalën për replikë.

ADEM GRABOVCI: Shiko, unë nuk desha t'iu marrë kohë shumë. Unë kur thashë se përkrah propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, ishte qëndrim i qartë, se

ndryshimet që janë bërë, nëse mund të thuhet ndryshime, janë bërë në pajtim me Komisionin e Parlamentit Evropian. Prandaj, për këtë arsye këtu nuk ka kurrfarë ndryshimi dhe kurrfarë kundërshtimi në raport me zëvendëskryeministrin apo me kryeministrin. Ne e përkrahim këtë draft edhe...

KRYESUESI: Faleminderit!

Mendoj që s'ka nevojë më që të diskutojmë për nenin 5, janë tri propozime dhe do ta votojmë me elektronikë secilin propozim veç e veç, ose në qoftë se propozimi i parë fiton më shumë, që është propozimi i Qeverisë, atëherë s'ka nevojë të tjerët të votojmë.

Amendamenti 1

"Kundër" nuk ka, abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 2

Abstenim nuk ka, "kundër" nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 3

Abstenim nuk ka, "kundër", nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 4

Abstenim nuk ka, "kundër", nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 5,

Është propozimi i Qeverisë. Votimi me elektronikë. Votojmë tani.

(Ndërhyrje)

... E kemi kryer diskutimin. Si... çka domethënë profesional, o burrë? Tash, a diskutove më parë në emër të komisionit. Ke qenë në komision. Unë e kam një kërkesë të Qeverisë, që është sponsorizues i ligjit, dhe po e qes në votim. Të lirë jeni të votoni "kundër" propozimit të Qeverisë dhe të lirë jeni të votoni "për" propozimin e Qeverisë.

Në vazhdim ... pastaj ligji që e ka sponsorizuar Qeveria, i pandryshuar në Komisionin funksional. Ky është, unë e di shumë mirë, edhe ti e di, edhe kryeministri po e di, edhe... Po, kemi hyrë në votim, o burrë!

NASER OSMANI : Po, kemi hyrë për amendamente...

Mirë de, hajde, dy minuta po t'i jap, Naser.

NASER OSMANI:

Më takojnë me Rregullore të Kuvendit, ti s'ma ke dhënë asnjë.

Po kështu, nëse nuk votohet amendamenti 5, paragrafi 3, nëse e kthejmë qysh e ka lypur Qeveria, ke parasysh, kryeministri, kryetari i shtetit dhe kryetari i Parlamentit, nënshkruajnë çdo kontratë, e cila ka vlerën më tepër se 10.000 euro.

Po, mirë bre, ta përfundoj unë, tani ti jepe komentin tënd! Komisioni, në këtë rast, Safetja, po unë s'e kam dhënë atë pëlqim, ka propozuar që këta tre të lirohen krejt. Kompromisi është ky që këta tre të lirohen edhe kryetarët e komunave lirohen prej nënshkrimit dhe përgjegjësia mbetet. Ke parasysh, nuk guxon amendamenti 5 të votohet komplet, vetëm paragrafin 3, ndaje. Përndryshe, zoti kryesues, ka për t'u rikthye që kontratat do të jenë të obligueshme t'i nënshkruajnë edhe kryeministri, që është këtu prezent, në çdo vlerë përmbi 10.000 euro. Dhe, nëse merrni përgjegjësi, d.m.th. çdo kontratë përmbi 10.000 euro ta nënshkruani, le të merret vetëm me këtë- përcjelljen e këtyre punëve kontraktuese. Definoje mirë, definoje mirë.

KRYESUESI: Zoti Kuçi, e ka një sqarim.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit për mundësinë, zoti nënkryetar.

Ndoshta në vijën e asaj që e tha edhe zoti Osmani, po tentoj ta sqaroj pak. Mendoj që propozimi më i drejtë, zoti Osmani, besoj që edhe në përputhje me ju, propozimi më i drejtë është që, për kontrata të mëdha – t'i nënshkruajnë të gjithë. Kontratat e mëdha, se aty në ligj është kontratat e mesme dhe të mëdha. Tash të theksohet, kontratat e mëdha t'i nënshkruajnë të gjithë. Unë mendoj se që kjo është më e drejta. Faleminderit!

KRYESUESI: Safete, hajde edhe ti një sqarim.

SAFETE HADERGJONAJ: Zoti nënkryetar,

Unë në fillim i thashë sqarimet, por po duket se është e nevojshme edhe një herë.

Në Komisionin për Buxhet dhe Financa ky amendament, i cili është propozuar, d.m.th. amendamenti 5 është i harmonizuar me përfaqësuesit e Komisionit Evropian. Në amendamentin 5, te neni 26 janë bërë këto ndryshime:

Paragrafi 2, në rreshtin e 3-të dhe të 4-të fshihen fjalët “të mesme” dhe mbeten që “të nënshkruhen vetëm kontratat me vlerë të madhe”.

Shlyhet edhe fjala “gjegjësisht” dhe zëvendësohet “si dhe”, d.m.th. “nënshkruhen nga zyrtari kryesor administrativ, si dhe nga ministrat”. Kështu del paragrafi 2.

Paragrafi 3, shtohet: “Përjashtim nga paragrafi 1 dhe 2 i nenit 26, kontratat e prokurimit nuk nënshkruhen nga presidenti i Kosovës, kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe kryeministri i Kosovës”.

Tash, deputetët këtu... ky thashë edhe njëherë, është amendament, i cili është harmonizuar me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, të cilët kanë qenë vazhdimisht me punën e grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Nëse duam të mbetet sikur ka qenë i propozuar nga Qeveria, nuk votohet fare amendamenti 5 dhe mbetet sikur e ka propozuar Qeveria. Nëse duam të votojmë, vetëm paragrafin 2, atëherë hiqet paragrafi 3

dhe votohet vetëm paragrafi 2. D.m.th. këto sqarime duhet të bëhen para se të votohet. Kurse, unë i theksova edhe vërejtjet që i ka dhënë në pikën 75, Komisioni Evropian, prandaj qëllimi ka qenë të ky ndryshim.

Vitin e kaluar Komisioni për Buxhet ka propozuar të hiqet nënshkrimi. Raporti i Progresit e ka dhënë vërejtjen negative. Prandaj, kisha propozuar që të merren parasysh këto vërejtje të cilat i thashë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Arsyeja pse sot jonë votuar që këto ligje të jenë pjesë e agjendës dhe mënyrën qysh janë votuar, është kërkesa e Komisionit Evropian. Do të thotë, arsyeja pse ne sot po e votojmë këtë ligj, në lexim të dytë, e jo një ditë tjetër, përkundër faktit që deputetët nuk e kanë pasur materialin, është ekzakt kërkesa e Komisionit Evropian.

Edhe me vullnetin më të mirë, unë ju thashë edhe paraprakisht, çka po mendojmë, me vullnetin më të mirë po ju them se mënyra e pazaritjes këtu në lexim të dytë, hajt se po e heqim këtë, po ju shtojmë këtë, nuk e bën këtë ligj ta sjellë Raportin pozitiv të Progresit. Krejt çka kemi bërë sot, krejt diskutimi i sotëm është kundër qëllimi të Komisionit Evropian për ta sjellë këtë ligj në Kuvend. Krejt kundër. Edhe nëse me këto kompromise, që po thuhet këtu, këtu po bëhet kompromis duke u bërë amendamenti, nëse këto kompromise bëhen, prapë Raporti i Komisionit Evropian për këtë projektligj do të jetë negativ.

Propozimi im është që, nëse dikush në Kuvend të Kosovës në momentin e votimit të amendamentit thotë – hajt se po e heqim këtë, e po ta shtojmë këtë, po e shtojmë ligjin krejt. Se, në asnjë variant ky ligj i votuar sot nuk do të sjellë opinion pozitiv të Komisionit Evropian për këtë ligj, po ju them. Qëllimi ka qenë të ketë lidhje të drejtpërdrejt të përgjegjësisë ligjore në mes të zgjedhurit politik dhe procedurave të prokurimit. Nëse ne i heqim këto përgjegjësi tani këtu brendapërbrenda në këtë mënyrë, pa e gjetur zgjidhjen, edhe një herë po ju them, Komisioni Evropian nuk thotë që duhet kryeministri ose kryetari i Kuvendit drejtpërdrejt të nënshkruajë, por thotë duhet ta mbajë përgjegjësinë. Nëse ne tash e heqim këtë përgjegjësi kështu, s'do të ketë opinion pozitiv për këtë ligj. Kështu që, nëse nuk do të ketë opinion pozitiv, më mirë është ta heqim krejt projektligjin prej rendit të ditës, mos ta votojmë hiç, t'i bëjmë marrëveshjet politike jashtë sallës së Kuvendit edhe të vijmë me marrëveshje brenda, se sa ta votojmë këtë ligj kështu edhe prapëseprapë po ju garantoj, që opinionin do të jetë negativ. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë, përsëri ju drejtohem, të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës e mbron propozimin e vet, projektligjin që ia ka drejtuar Kuvendit, që ka kaluar edhe nëpër komisione. I vlerësojmë mendimet e Komisionit, por tash çështja shtrohet- pse Qeveria e Kosovës, qëndron prapa qëndrimit të vet dhe pse kanë ndodhur formulime dhe qëndrime të tilla dhe pse po nxirret ky ligj i prokurimit?

Ritheksoj edhe një herë, ju e dini se vitin e kaluar, pikërisht nga një lobim jo i dobishëm dhe i shëndetshëm tek deputetët e Kosovës, ka ndodhur kthimi i këtij projektligji, një lobim jo i shëndetshëm, duke krijuar rrethana favorizuese për korrupsion në institucionet e Kosovës, prandaj qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është parandalimi i korrupsionit, në të gjitha nivelet e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Kështu që, ky projektligj e rrit përgjegjësinë e të gjithë bartësve të institucioneve të Kosovës, prej nivelit më të lartë deri në nivelin më të ulët, është i standardit bashkëkohor, në anën tjetër, ju e dini që nëse pyeten të gjithë bartësit e institucioneve, duke u nisur, po flas prej institucionit më të lartë, ndoshta deri te niveli i kryetarit të komunës e drejtorët komunal, nuk janë ndoshta për ta nxjerrë të gjithë këtë projektligj, por ju e dini se është në interes të parandalimit të fenomeneve negative, ngarkimit me përgjegjësi të njerëzve që kanë marrë përgjegjësi në institucionet e Kosovës. Kështu që, siç e kam mbrojtur edhe vitin e kaluar, e mbroj edhe sot edhe ju ftoj të votoni për propozimin e Qeverisë dhe të mos ndodhë gabimi i vitit të kaluar dhe përgjegjësi për nënshkrimin e kontratave mbi 10.000 euro të marrin nga presidenti, kryetari i Parlamentit, kryeministri, ministrat. Lehtë është t’i thuash sekretarit të Ministrisë dhe shefit të prokurimit – nënshkruaj, le të marrë përgjegjësi ministri, pastaj, pak më ndryshe shkon edhe në nivel të kryetarëve të komunave, lehtë është t’i thuash drejtorit, se drejtorin kryetari i komunës e zgjedh vet, ju e dini, pastaj dhe në nivele tjera. Kështu që besoni, është në interes të gjithëve, nuk është vetëm në interes të një partie, dhe, nëse më pyesni mua, natyrisht se ka pasur debate edhe brenda institucioneve dhe Qeverisë për këtë çështje edhe vitin e kaluar. Befasisht, vitin e kaluar ka kaluar si ka kaluar, kësaj radhe jam insistues, që ky projektligj të votohet në bazë të propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pra të ngarkohen me përgjegjësi të nënshkrimit të kontratave mbi 10.000 euro: presidenti, kryetari i Parlamentit, kryeministri, ministrat dhe kryetarët e komunave. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Atëherë, shkojmë në votim.

E hedh në votim propozimin e parë, që është propozimi i Qeverisë, që të mbetet teksti i njëjtë, pa amendamentin e 5-të, që është propozim dhe kërkesë e kryeministrit dhe e Qeverisë.

Votojmë tani.

Në sallë janë 65 deputete.

Më 47 vota “për”, 4 abstenime, 5 “kundër”, miratohet ligji, ashtu siç ka qenë në tekst dhe bie amendamenti i 5-të dhe propozimet e pastajme.

Amendamenti 6

“Kundër”, s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 7

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 8

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 9

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 10

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 11

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 12

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 13

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 14

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 15

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Në sallë janë 64 deputetë.

Me 44 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Faleminderit!

Vazhdojmë!... A kemi kuorum?

More ju, ne deri tash është bërë luftë kundër korrupsionit, e tash Qeveria po insiston në një ligj për luftën kundër korrupsionit, këtu janë kundër, unë s'po marr vesh! S'po e kuptoj tamam, por...

S'ka kuorum.

Atëherë, po e marrim një pauzë nga 15 minuta, e mandej shohim e bëjmë. Zoti... Çka ke... thuaj tash... e dhashë pauzën!

Ligji, u krye ligji. Mos u kthefshin, shkojnë në shtëpi. Bajram është nesër.

Shikoni, nuk ka as kuorum...!

Të nderuar deputetë, për shkak të mungesës së kuorumit, ne e shtyjmë mbledhjen për të mërkurën, në orën 10:00.

E mërkurë, më 31 gusht 2011,

Drejt seancën: nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Po vazhdojmë seancën e pardjeshme, nga e cila rendi i ditës ka mbetur në pikën e tetë, që është:

8. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve

Fjalën e ka kërkuar në fillim kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryesues, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që fillimisht t'ju informoj shumë shkurt për zhvillimet e fundit në veri të vendit tonë, që ndërlidhen me përpjekjet tona këmbëngulëse për vendosjen e rendit dhe ligjit atje. Pas masave të reciprocitetit dhe vendimit për marrjen në kontroll të pakave kufitare 1 dhe 31, më 25 korrik, si përkushtim ka mbetur vënia e rendit dhe ligjit në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Ashtu siç edhe keni qenë të informuar në vazhdimësi, më lejoni t'ju riinformoj se hetimet e përbashkëta të Policisë së Kosovës dhe të EULEX-it lidhur me funksionimin e strukturave ilegale dhe kriminale, që të ndërlidhura me vrasjen e pjesëtarit të Policisë së Kosovës tash më heroit, Enver Zymberaj janë zhvilluar me sukses. Për rrjedhojë Prokuroria e Kosovës ka lëshuar një numër të caktuar të flet arrestimeve kundër personave që dyshohen që janë përgjegjës për veprimtarinë e këtyre strukturave ilegale, kriminale, por edhe në vrasjen makabre. Për të zbatuar urdhrin e prokurorit, për të sjell para drejtësisë personat që dyshohen se janë përgjegjës për vrasjen, sot organet përkatëse të ndjekjes, së bashku me ndihmën e KFOR-it, kanë zhvilluar dhe janë duke vazhduar një operacion të gjerë në veri të vendit për kapjen e personave të dyshuar për vrasje që janë pjesëtarë të strukturave ilegale dhe kriminale të financuara e të mbështetura drejtpërdrejt nga Beogradi.

Operacioni ende nuk ka përfunduar dhe nuk do dëshiroja shumë që të komentoja për këtë gjë, por mund të ju them se aktualisht janë konfiskuar evidenca të rëndësishme të funksionimit të strukturave kriminale ilegale dhe paramilitare serbe, por edhe armë të ndryshme që janë përdorur në veprime të tyre terroriste.

Përveç kësaj, më lejoni t'ju informoj se organet përkatëse të hetuesisë të Republikës së Kosovës, kanë identifikuar dhe përgatitur kallëzime penale edhe për një numër të konsideruar të personave për të cilët ka prova të mjaftueshme se janë përgjegjës për cenimin e sovranitetit shtetëror të Republikës së Kosovës, tash e 12 vjet. Por, dallimi është se tanimë gradualisht do të dëshiroj juve, të nderuar deputetë, të gjithë qytetarëve të vendit dhe partnerët ndërkombëtarë t'ju informoj se të dhënat tona rezultojnë se strukturat ilegale dhe kriminale që ka funksionuar tash e 12 vjet atje, gradualisht po shndërrohen në struktura paramilitare.

Këta persona, përveç tjerash, dyshohen se janë përgjegjës për akte terroriste, janë përgjegjës për vepra kriminale, të kontrabandës dhe shpëlarjes së parave dhe që janë përgjegjës për sulmin e organizuar dhe kundër pikave 1 dhe 31.

Të nderuar deputetë,

Unë dua t'ju siguroj juve dhe gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës e në veçanti dua t'ju siguroj qytetarët e komunitetit serb që jetojnë në veri të vendit se gjitha veprimet tona shtetërore të koordinuara me komunitetin ndërkombëtar kanë vetëm një qëllim, vendosjen e sundimit të rendit dhe ligjit atje dhe kthimin e qetësisë dhe jetës normale për të gjithë. Kjo është gjëja më elementare që shteti ynë duhet të bëjë për qytetarët e vet dhe ne jemi të vendosur ta bëjmë një gjë të tillë deri në fund.

Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet e Kosovës, së bashku me ato ndërkombëtare, nuk janë në konflikt me qytetarin në veri, janë në konflikt me strukturat ilegale, kriminale dhe paramilitare. Kriminelët dhe vrasësit e dyshuar ndoshta sot edhe mund të jenë arratisur, por ata nuk do të mund t'i ikin kurrë ballafaqimit me drejtësinë. Ndoshta, sot ata kanë gjetur strehim në institucionet në Beograd, mbase edhe në kuptimin edhe legal. Dhe, jo rastësisht ne e kemi drejtuar gjithmonë mesazhin dhe kemi bërë përgjegjës në bazë të dëshmive që kemi se Beogradi zyrtar qëndron prapa atyre strukturave ilegale, kriminale dhe gradualisht tashmë edhe individëve paramilitarë.

Në çdo rrethanë përsëri sot ritheksoj mesazhin tim të qartë se ditët e këtyre strukturave ilegale, kriminale janë të numëruara dhe se pavarësisht se ku fshihen sot, ne do t'i gjejmë dhe do të përballen me drejtësinë e shtetit të Kosovës. Nuk ka rëndësi se sa kohë do të na duhet të bëjmë një gjë të tillë, por unë ju siguroj se nuk jemi duke pushuar as edhe një minutë të vetëm në angazhimet tona, që këta njerëz të destabilitetit, të cenimit të sovranitetit tonë, të përballen me drejtësinë.

Por edhe mesazhi ynë sot për Beogradin është, që të mos i strehojë vrasësit e policit të Kosovës, të mos i strehojë strukturat ilegale dhe kriminale. Të distancohet nga politika e Slllobodan Millosheviqit, më herët, kur paramilitarët që kryenin krime të ndryshme nëpër

vende të ndryshme të Jugosllavisë, i strehonte në Beograd. Tek e fundit edhe Beogradi ka për obligim t'i respektojë standarde ndërkombëtare të fletë-arresteve ndërkombëtare, por edhe t'i ekstradojë vrasësit.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Dëshiroj të theksoj se sundimi i rendit dhe ligjit është parakusht thelbësor për vetë ekzistencën e shtetit tonë, është parakusht thelbësor për integritet euroatlantike. Ne jemi të përkushtuar që të vazhdojmë dialogun për çështje praktike mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë, është parakusht i domosdoshëm fqinjësia e mirë për integritet evropiane dhe ne do të jemi të zotuar të vazhdojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!
Fjalën e ka kërkuar zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës fillimisht dëshiroj të sqaroj pse kemi lëshuar seancën e kaluar. Arsyeja ka qenë e thjeshtë, sepse është shkelur procedura, gjegjësisht Rregullorja e votimit të Projektligjit për prokurorimin publik në Republikën e Kosovës.

Sidoqoftë, duke mos dëshiruar të lëshohem më tej në këtë çështje, ne kërkojmë që ky projektligj të rikthehet në votim dhe që ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim amendamentin 5, por që propozojmë paragrafi 3 i këtij amendamenti të hiqet, të fshihet, pa te, çka nënkupton që të gjithë marrin përgjegjësi, ashtu siç u shprehën shumëkush këtu, me rastin e nënshkrimit të kontratave të vlerës së lartë, pa dashur ta shpjegoj dhe ta sqaroj, sepse qartë shkruan në projektligj. Prandaj, kërkojmë që të rikthehet edhe një herë në votim projektligji në fjalë dhe ne si grup parlamentar do ta përkrahim amendamentin 5, por që paragrafi qartë të thuhet: ” të fshihet paragrafi 3 i këtij amendamenti” dhe nëse kjo nuk ndodhë, nuk bëhet ky rikthim, ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk do të marrim pjesë në punimet e seancës. Është çështje edhe procedurale, por edhe çështje mendoj përmbajtësore dhe nuk devijon shumë nga ajo që ishte edhe vullneti i shumicës së mbledhjes së kaluar. Sidoqoftë, ne e kemi pasur dhe kemi qëndrimin ende që nuk duhet ngatërrohet politika me ekzekutivin, megjithatë, ne jemi të gatshëm edhe nuk dëshirojmë t'i ikim në asnjë mënyrë përgjegjësisë që del nga projektligji nëse votohet edhe kthehet në rivotim, gjegjësisht votohet për amendamentin 5 dhe fshihet paragrafi 3.

Shpresoj në mirëkuptimin edhe tuajin si kryesues edhe të kolegëve deputetë të partive tjera parlamentare. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Zoti Beqiri, në qoftë se ju thoni që është shkelur procedura, atëherë do të duhej të më sqaroni se ku është shkelur procedura në Kuvend, sepse mua nuk më rezulton si e tillë. Zoti Beqiri, e ka fjalën!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju e dini dhe gjithë deputetët e dinë që gjatë miratimit të dytë, gjegjësisht leximit të dytë, është hedhur në votim sipas radhës, kjo është në bazë të nenit 58, ku shkruan: shqyrtimi i dytë i projektligjeve dhe thuhet: pika 3, amendamentet shqyrtohen dhe votohen një nga një sipas radhës së paraqitur krahas tekstit të projektligjit”. Dhe, ju zoti kryesues, e dini edhe kolegët e dinë që është votuar vetëm varianti i propozuar i Qeverisë dhe nuk janë votuar amendamentet. Ne këtu kemi qenë, nuk është votuar amendamenti i cili ka qenë i propozuar nga Komisioni. Kjo është diçka që është e qartë, sepse kemi qenë këtu, prandaj për këtë arsye edhe arsye tjera që i thashë, ne kërkojmë që ky projektligj edhe një herë të rikthehet në votim prej fillimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë vetëm sa për t’u sqaruar personalisht dhe po dua që, me qenë se jam vetë, t’ju sqaroj edhe diçka shtesë.

Ligji është sponsorizuar dhe ka ardhur nga Qeveria dhe sponsorizues i parë, sipas mendimit dhe interpretimit tim, është sponsorizuesi kryesor dhe është institucioni ose amendament në veti është krejt ligji. Dhe, Qeveria ka kërkuar dhe ka mbrojtur propozimin e vet. Dhe unë e kam hedhur propozimin e Qeverisë si propozues i parë i ligjit dhe jo amendamentin si të parë. Megjithatë, jo duke konsideruar si shkelje të procedurës, sepse nuk është shkelur, për mua nuk është shkelur procedura, por në qoftë se ka gatishmëri që të rikthehet në votimin e ligjit, ne mund të flasim edhe për atë, por procesverbali i djeshëm, i nxjerr edhe me zë edhe me shkrim, nuk e jep këtë, nuk rezulton tek kjo që po thoni është shkelur procedura. Në qoftë se propozimi i Qeverisë ka kaluar me shumicë votash, që do të thotë janë 47 vota “për”, atëherë nuk ka kuptim, asnjëherë nuk është futur në votim propozimi i radhës që kanë qenë edhe dy të tjera. Megjithatë, praktika jonë e deritashme, sepse s’kemi pasur praktikë të tillë dhe nuk mund të them se nuk shkruan as në Rregullore që propozimi i Qeverisë duhet të jetë i pari, ka qenë gjithmonë që është votuar amendamenti i komisionit përkatës, i pari dhe pastaj është konstatuar që është në rregull apo jo, me anë të votimit që të votohet edhe për propozimin tjetër. Në qoftë se ka fituar amendamenti i komisionit, atëherë s’është futur fare asnjëherë në votim propozimi tjetër.

Unë interpretimin po e bëj personalisht, me qenë se kam qenë në krye dhe kam drejtuar dje seancën dhe ndoshta më mirë kishte qenë dje që ta thoni këtë që po e thoni sot pasi që është miratuar ligji, megjithatë, unë e marr në konsideratë propozimin tuaj dhe këtu janë edhe grupet tjera parlamentare, të shohim se si është vullneti që të procedojmë. Nëse jeni ta kthejmë amendamentin 5 në rivotim, sipas propozimit tuaj, nuk është çështje imja kjo, deputetët vendosin këtu, Parlamenti vendos.

A keni propozim shtesë për këtë apo t’i pyesim kryetarët e grupeve parlamentare? Atëherë është një lloj mocioni që s’na ka ndodhur edhe një rast e kemi pasur një herë, por ka qenë i tjetër natyre. Pyes kryetarët e grupeve parlamentare se çfarë po mendojnë për propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së?

Zoti Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike edhe në seancën e kaluar ka qenë mendoj shumë i qartë. Kem kërkuar vetëm që ky ligj të jetë në harmoni të plotë me qëndrimin e Komisionit të Parlamentit Evropian. Megjithatë edhe pse u votua, ne e përkrahim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe kërkojmë që amendamenti 5 të futet në rivotim edhe një herë.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” a ka qëndrim?

VISAR YMERI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Për sa i përket kësaj çështje, domethënë, siç e dini e kemi lëshuar edhe ne sallën në seancën e kaluar për shkak të rendit të ditës dhe zëvendësimit të rendit të ditës, me një rend tjetër të ditës, i cili është futur aty.

Me qenë se paska qenë ky problem procedural, domethënë për të cilën po e marrim vesh sot, atëherë edhe ne jemi të mendimit që do të ishte mirë që ta kthejmë në rivotim këtë ligj dhe pastaj që seanca të vendosë për atë se cilat amendamente do të duhej ose do të miratoheshin. Faleminderit!

KRYESUESI: Për amendamentin e keni fjalën.

VISAR YMERI: Amendamenti, me qenë se ky paska qenë ky problem.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe ne e mbështesim rikthimin me qenë se ka marrëveshje dhe mendojmë se edhe zgjidhja është adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Koalicioni, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryesues!

Duke marrë parasysh kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së për rivotimin edhe një herë të amendamentit apo nenit 5 Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah që të jenë në parim me rekomandimet e Komisionit Evropian. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

SLS, deputeti Saša Milosavljević.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: I Parlamentarna grupa Samostalna liberalne stranke podržava predlog Parlamentarne grupe LDK-a da se ponovo glasa o amandmanu 5.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi “6+”, deputeti Demiri.

RASIM DEMIRI: I Parlamentarna grupa “6+“ podržava predlog Poslaničkog kluba LDK-a da se ovaj predlog da se ponovo vrati na izglasavanje.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, konstatoj që nga të gjitha grupet parlamentare është mbështetur propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zotit Beqiri dhe ne duhet të procedojmë, por duhet t'i sqarojmë pak më mirë deputetët për çka është fjala. Dhe, po kërkoj që edhe Qeveria të prononcohet për propozimin e saj të mëparshëm edhe komisioni ose po futemi në votim, e fusim amendamentin 5 edhe propozimin e Qeverisë, cili të fitojë.

(Reagim nga salla)

Po tash unë kam pasur tri kërkesa dhe, unë nuk mund të mbaj në mend çka po mendoni ju. Tri kërkesa kanë qenë zyrtare dhe. Një, ka qenë që të hiqet paragrafi 3 i amendamentit, dy, ka qenë Qeveria që ka insistuar që ligji të mbetet ashtu siç është pa ndryshim dhe, tre, ka qenë që kryetarët e komunave të futen në mbrojtje të mos i nënshkruajnë kontratat me qenë se janë të zgjedhurit e popullit. Prandaj, unë, të jemi të qartë edhe me opinionin, edhe me njeri – tjetrin, unë nuk e kam ndërmend të qes në votim diçka të fshehtë që nuk është e qartë për opinionin, me qenë se po thonë që është shkelur procedura. Urdhëroni, kemi tri propozime, votojmë amendamentin, me qenë se keni kërkuar që të votohet amendamenti, pa paragrafin e tretë.

(Reagim nga salla)

Urdhëro, okej, po janë tri propozime tani, jo nuk është veç një. Është propozimi i Qeverisë që të hiqet amendamenti, të mos votohet, po të mbetet propozimi i Qeverisë, në qoftë se e ka ndryshuar sot është tjetër gjë. Urdhëro, zoti kryeministër e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Qeveria përkrah pajtueshmërinë e grupeve parlamentare.

KRYESUESI: Në rregull, atëherë votojmë amendamentin 5, pa paragrafin e 3. Propozim i komisionit, kush është “për”, kush është “kundër”? Amendamenti 5, pa pikën 3. A ishte ky propozimi yt, zoti Beqiri? Prapë po ju them, kërkesa është e kryetarit të Grupit Parlamentar, në emër tuajin.

Ne e qesim në votim amendamentin 5, pa paragrafin 3. Kush është “për”, votojmë tani: Regjia, a do të votojmë?

Atëherë, konstatoj që në sallë janë 96 deputetë,

“Për” kanë votuar 54 deputetë, “kundër” 2, kanë abstenuar 19. Konstatoj që amendamenti i rikthyer në votim, miratohet, duke përjashtuar paragrafin 3 të amendamentit. Faleminderit!

A jeni që ta fusim edhe një herë tekstin në tërësi? Atëherë votojmë edhe një herë ligjin në tërësi me qenë se u krijua situata që u krijua.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim, votojmë në tërësi Ligjin për prokurimin publik. Regjia gati, votojmë tani. Faleminderit!

Në sallë janë 96, prapë.

Konstatohet se me 91 vota “për”, një abstenim dhe asnjë “kundër”. Kuvendi miratohet Ligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e informatorëve dhe Kuvendit ia kanë parashtruar raportet me rekomandime. Ftoj kryetarin e Komisionit funksional deputetin Arben Gashi, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Gashi, e keni fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Komisioni funksional e ka trajtuar projektligjin dhe i ka bërë 15 amendamente të cilat ia rekomandon seancës që t’i shqyrtojë dhe t’i aprovojë. Besojmë që Komisioni ka punuar me përkushtim këtë projektligj dhe cilësia e këtij ligji është rritur mjaftë mirë si rezultat i angazhimit të deputetëve në kuadër të komisionit dhe si rezultat edhe i bashkëpunimit me institucione të tjera, prandaj, ju kërkoj që ta shqyrtoni këtë projektligj dhe t’i aprovoni rekomandimet të cilat i ka propozuar Komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit funksional. Projektligji ka 15 amendamente, po i votojmë veç e veç me procedurat e miratuara më herët.

Amendamenti 1.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 5.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.
“Kundër? Nuk ka,
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 7.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 10
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 11.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
“Kundër”? Nuk ka,
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 13.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 14.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 15.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Të nderuar deputetë,

Tani votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Në sallë janë 90 deputetë. Faleminderit!

Konstatohet se me 85 vota “për”, një “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratohet Ligjin për mbrojtjen e informatorëve. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 10-të të rendit të ditës :

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale dhe Kuvendit ia kanë parashtruar raportet me rekomandime. Ftoj kryetarin e Komisionit funksional deputetin Gashi, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Gashi, e keni fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Po ashtu edhe për këtë ligj Komisioni ka trajtuar me shumë kujdes duke pasur parasysh se është një ligj i karakterit të veçantë dhe pas punës intensive që është bërë në Komision është arritur që Komisioni të aprovojë 12 amendamente në kuadër të këtij projektligji dhe fton seancën që këto amendamente të aprovohen, me qëllim të rritjes së kualitetit dhe funksionalitetit të këtij ligji dhe dhënies një mundësie më të mirë që institucionet e Kosovës të funksionojnë dhe të kenë bashkëpunim në çështjet e përgjegjësisë të përgjegjësisë të personave juridikë për veprat penale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës të paraqitura në raportin e Komisionit funksional.

Projektligji ka 12 amendamente.

Votojmë amendamentet veç e veç.

Amendamenti 1.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 2.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 3.
“Kundër” nuk ka,
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 4.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 5.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 7.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 10.

“Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 11.
“Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
“Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Të nderuar deputetë,
Tani votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.
Në sallë janë 87 deputetë.
Konstatoj se me 72 vota “për”, një abstenim dhe një “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 11-të të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Kuvendit ja kanë parashtruar raportet me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional deputetin Arben Gashi, që para deputetëve të arsyetoj raportin me rekomandime.

Zoti Gashi e keni fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe duke marrë parasysh që është një projektligj i rëndësisë së veçantë, për shkak se prek një sferë të veçantë për parandalimin e konfliktit të interesit, fokusi ka qenë që të kemi standard sa më të mirë të këtij ligji dhe besoj që ndërhyrjet nuk kanë qenë shumë të mëdha, kanë qenë vetëm tre amendamente të cilat kanë për qëllim ndryshimin e disa çështjeve shumë të vogla dhe besoj që nuk prekin shumë esencën e ligjit, mirëpo në një kohë të ardhshme ndoshta do të duhet të trajtohet prapë ky ligj, sepse është një ligj i cili komplikon shumë situatat e caktuara, mirëpo të shohim se sa do të jetë funksional. Amendamentet janë gjithsej 3 dhe i rekomandojmë seancës që t’i aprovojë këto amendamente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit funksional.

Amendamenti 1.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Tani votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e propozuara.

Lus regjinë dhe deputetët të votojmë.

Në sallë janë 81 deputetë.

Konstatohet se me 71 vota “për”, një abstenim dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Pika e 12-të e rendit të ditës, është:

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë dhe Kuvendit ja kanë parashtruar raportet me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional deputetin Arben Gashi, që para deputetëve të arsyetoj raportin me rekomandime. Faleminderit! Zoti Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni e ka trajtuar po ashtu këtë projektligj, dhe ky është njëri prej projektligjeve që ka pasur më së shumti defekte dhe logjike edhe defekte juridike në aspektin e konceptimit të tij. Prandaj, komisioni ka draftuar 3 amendamente, mirëpo amendamentet kanë disa paragrafë, amendamenti 1 ka 9 paragrafë, ndërsa amendamentet tjera kanë më pak paragrafë, por besojmë që kemi arritur që të kemi një kualitet më të mirë në kuptimin e logjikës të ndërtimit të një ligji dhe në kuptimin e koncepteve juridike që janë përdorur aty dhe po ashtu në kuptimin e funksionalitetit të këtij ligji. Prandaj, rekomandojmë

seancës që këto amendamente të cilat janë propozuar nga Komisioni funksional të aprovohen, sepse kemi një përmirësim kualitativ të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë vazhdojmë me votimin e tre amendamenteve që kanë ardhur nga Komisioni.

Amendamenti 1.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Në sallë janë 77 deputetë.

Konstatohet se me 76 vota “për”, një abstenim dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 13-të të rendit të ditës:

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë në çështjet penale dhe Kuvendit ia kanë parashtruar raportet me rekomandime. Ftoj kryetarin e Komisionit funksional deputetin Arben Gashi, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Arben Gashi, e keni fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni ka pasur parasysh që ky është njëri ndër ligjet shumë të rëndësishme sa i përket bashkëpunimit juridik- penal ndërkombëtar, prandaj, mendoj se fokusi ka qenë shumë i madh në kuptimin e krijimit të kapaciteteve ligjore për mbrojtjen e interesave të qytetarëve të Kosovës, mirëpo në të njëjtën kohë për krijimin e kapaciteteve të bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet e bashkëpunimit penal. Dhe, mendojmë se kemi arrit që të krijojmë me 11 amendamente që janë propozuar, kemi arritur që të krijojmë

një ligj më të mirë dhe të krijohen kushte që edhe Ministria e Drejtësisë në këtë rast, të ketë bazën ligjore dhe të ketë po ashtu mundësinë që më mirë të hyjnë në marrëdhëniet bashkëpunimi dhe me marrëveshjet lidhur me ekstradimin dhe të bashkëpunimit tjetër në çështje penale dhe mendojmë se kemi një ligj përpara i cili ka kualitete të nevojshme që Ministria dhe Qeveria e Kosovës të hyjnë në bashkëpunim ndërkombëtarë për çështje penale dhe të nënshkruaj marrëveshje të ekstradimi dhe bashkëpunimi penal. Prandaj, ftoj seancën që t'i aprovojë amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional dhe të kemi një qëndrim përkrahës për këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit funksional. Projektligji ka 11 amendamente. Fillojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

“Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

“Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

“Kundër”? nuk ka,

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 6.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 7.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 10.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 11.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten të votim, votojmë tani.
Në sallë janë 77 deputetë. Faleminderit!
Konstatohet se me 69 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë në çështjet penale. Faleminderit!

Pika e14-të e rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit i kanë parashtruar raportet me rekomandime. Ftoj kryetarin e Komisionit funksional deputetin Zenun Pajaziti, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Faleminderit!
Zoti Pajaziti, e keni fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni ka shqyrtuar këtë projektligj, është njëri ndër projektligjet që është në pakon e projektligjeve që ndihmojnë procesin e privatizimit. Ka pasur një trajtim pak më të gjatë, sepse ka pasur edhe një debat më të gjatë brenda Komisionit për disa prej neneve të këtij projektligji. Ne i kemi adaptuar se i kemi përgatitur disa amendamente, kemi pasur po

ashtu në dispozicion edhe informacione të Qeverisë dhe institucioneve tjera ndërkombëtare që kanë marrë pjesë në përgatitjen e këtij projektligji në përputhje me Kushtetutën dhe si të tillë në këtë projektligj e mbështesim. Përveç se dëshiroj t'ju përkujtoj se një amendament është amendamenti 2 ka disa telashe që kanë të bëjnë me një panel të veçantë, një panel të apelit dhe në e kemi adaptuar një amendament, i cili nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën dhe me planin gjithëpërfshirës. Kemi shpresuar që do të ketë kohë edhe Komisioni i Legjislacionit ta trajtojë këtë amendament, ndërkohë që kanë ardhur më shpejtë se sa t'i trajtojë edhe ky Komision. Unë mendoj që të reflektojmë sot këtu dhe të mbetet projektligji pa këtë amendamentin e dytë që do të jetë krejtësisht okej me planin gjithëpërfshirës dhe kushtetutë. Mendoj që mund të japin një shpjegim edhe përfaqësuesi i Qeverisë që ka marrë pjesë në përgatitjen e projektligjit. Unë mendoj që, pavarësisht që kemi kaluar, dy herë janë shtyrë mbledhjet e komisionit për shkak të këtij propozimi dhe më në fund edhe pse ka kaluar, unë mendoj këtu duhet ta korrektojmë. Pra, duhet ta procedojmë, pa amendamentin 2. Faleminderit!

KRYESUESI: Domethënë, propozimi i juaj në emër të Komisionit është që të hiqet amendamenti 2.

Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Si Komision e kemi kaluar kështu, ka kaluar me vota. Unë ja u dhashë sqarimet, unë flas këtu edhe në emër të Grupit, njëkohësisht. Në emër të Komisionit është e kaluar, unë them që të reflektojmë si deputetë për amendamentin 2, si Komision është okej ka kaluar me shumicë votash.

KRYESUESI: Atëherë, fjalën e ka në emër të Komisionit për Legjislacion zoti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, duke marrë parasysh se këto kanë ardhur në kohë shumë të shkurtër, nuk ka pasur mundësi që të shqyrtojmë Projektligjin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Po ashtu nuk ka mund ta shqyrtojë Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Projektligjin për persona të zhdukur. Këto tri projektligje nuk janë trajtuar në Komision, sepse kanë ardhur ditën e premte, pasdite, Komisioni nuk ka pasur kohë të mbledhet. Dhe, mendoj se është dashur paraprakisht që me Projektligjin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, që lidhet me procesin e privatizimit të ishte marrë në mënyrë profesionale Komisioni për Legjislacion e jo Komisioni për Tregti, Industri, sepse ndërhyhet në sistemin e drejtësisë. Sistemin e drejtësisë normalisht është dashur ta trajtojë Komisioni për Legjislacion, sepse bie në kompetencën e tij, mirëpo tash jemi në këtë situatë dhe i mbetet seancës të vendosë se si do të duhet të procedojë. Ne nuk kemi ndonjë vendim të Komisionit për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zëvendëskryeministri Kuçi e ka kërkuar fjalën.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që të shprehë qëndrimin e Qeverisë ndoshta edhe me një sqarim plotësues shumë të shkurtër.

Ju e dini që ky projektligj respektivisht kjo Dhomë e Veçantë deri në këtë rast ka pasur përbërje shumicë nga gjyqtarët ndërkombëtarë respektivisht ata të EULEX-it dhe kësaj radhe kemi arritur që të bëjmë një ndryshim nga 13 me 7 që ka qenë në favor të EULEX-it, tani është e kundërta, 13 gjyqtarë do të jenë vendorë dhe 7 të EULEX-it. Kjo faza e parë e ndryshimit, ndërsa në çështjen e dytë që e keni marrë një letër edhe ju të nderuar anëtarë të Komisionit, është një pajtueshmëri e Qeverisë së Kosovës me EULEX-in apo një kompromis do ta thosha që në Dhomën e Apelit, të jenë 3 me 2 në favor të EULEX-it, është për dy arsye.

Arsyeja e parë është që Dhomën e Apelit ka raste më pak, por janë një lloj mbikëqyrje e vendimeve paraprake dhe arsyeja e dytë është që me Kushtetutën e Kosovës dhe me planin gjithëpërfshirës parashihen kompetenca të tilla për EULEX-in. Unë besoj që sot Kuvendi i Kosovës do ta mbështetë qëndrimin që ka dhënë Qeveria. Besoj ajo që e tha zoti Pajaziti do të mbështetet, që amendamenti 2, të mos mbështetet nga anëtarët e Kuvendit dhe unë po ashtu premtoj që shumë shpejtë Kuvendi i Kosovës do të marrë një vendim kur e ndërron rolin e EULEX-it në Kosovë, por deri në atë kohë mendoj që ky ndryshim është një kompromis është një garanci, është një dialog do të thosha që e kemi bërë edhe në Bruksel edhe me Komisionin Evropian edhe me EULEX-in dhe pres nga ju që të japin një mbështetje të tillë.

Pra, amendamenti 2 të mos ndryshohet por të mbetet sikur ka qenë neni 3 pika 12. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Janë edhe dy të paraqitur.

Deputetja Sahatqija e ka kërkuar fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Komisioni e ka shqyrtuar dhe e ka shqyrtuar bukur gjatë këtë projektligj si edhe ligje të tjera të kësaj pakoje. Amendamenti 2 ka qenë amendament i cili jashtëzakonisht shumë është shqyrtuar. Si Komision ne e kemi sjellë këtë amendament edhe ky amendament duhet të dalë në votim. Ne jemi shumë të vetëdijshëm që Qeveria e ka bërë atë maksimumin e vet në bashkëpunim me EULEX-in, por mendoj që edhe Kuvendi edhe Komisioni e ka një detyrë të vet edhe ky amendament është rezultat i mendimit, i besimit edhe i votimit me shumicë të Komisionit. Prandaj, qysh do që të jetë mendoj që ky amendament duhet të dalë në votim edhe shpresoj që të kalojë, sepse është fuqizim i shtetit të Kosovës, i institucioneve të Kosovës.

KRYESUESI: Zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Desha të ndërlidhem me këtë debat për amendamentin 2, por edhe përgjithësisht për këtë ligj, për shkak se është e vërtetë që ka qenë një prej debateve më të nxehta në Komisionin për Zhvillim Ekonomik ky ligj dhe amendamentet për të cilat po flasim. Fillimisht, domethënë, ka qenë problemi kryesor, aty ka qenë në atë se a do të emërohen gjykatës në Dhomën e Veçantë nga EULEX-si, apo do të mbesin ashtuquajtur gjykatës ndërkombëtarë, siç ka qenë në versionin origjinal të ligjit të dërguar nga Qeveria? Dhe, një prej kundërshtimeve kryesore të tona ka qenë që për sa i përket EULEX-it, natyrisht, që ai nuk duhet të figurojë fare këtu në këtë ligj dhe EULEX-si duhet ta dimë që baza ligjore EULEX-si nuk është ajo e planit të Ahtisarit. Pra, një EULEX-si i cili ka zbarkuar në Kosovë nuk është EULEX-së i cili ishte paraparë në planin e Ahtisarit edhe pse ka ngjashmëri shumë të mëdha. Nuk po them që EULEX-si, apo misioni i planit të Ahtisarit është i mirë, por ky që ka ardhur është edhe më i keq për shkak se thirret në Rezolutën 1244. Dhe, rrjedhimisht konsideroj që emërimi i gjykatësve nga EULEX-si në këtë Dhomë të Veçantë do të nënkuptonte njëkohësisht edhe cenim të drejtpërdrejtë të sovranitetit të Kosovës, për shkak se ne e dimë që EULEX-si nuk e njeh Kosovën si shtet, pra është neutral karshi statusit të Kosovës dhe e dimë po ashtu që EULEX-s madje as nuk e pranon Kushtetutën e Kosovës, nuk e njeh Kushtetutën e Kosovës si të tillë... ndoshta edhe në disa aspekte e zbaton atë. Dhe ky është problem jo vetëm politik, por edhe juridikë dhe konsideroj që Kuvendi i Kosovës nuk duhet që ta votojë një ligj ku thirret ose ku kërkohet apo obligohet mandatimi i gjykatësve të EULEX-it në çfarëdo instance të gjyqësisë në Kosovë e veçanërisht jo në Dhomën e Posaçme, kur kemi të bëjmë, të gjithë e dinë domethënë me trajtimin e pasurisë së Kosovës e cila ishte privatizuar nga UNMIK-u apo nga AKM-ja dhe ajo që po privatizohet zot nga AKP-ja.

Për sa i përket amendamentit 2, ky amendament domethënë ka ardhur si rrjedhojë e debatit në Komision dhe është votuar në Komision në formë çfarë është, pra, është një ndryshim goxha rrënjësorë nga origjinali që e ka sjell Qeveria. Këtu edhe në Komision, por edhe këtu zëvendëskryeministri e tregoj tashmë që përmes negociatave domethënë është arritur që një ndryshim të bëhet edhe në ato parimet bazë të planit të Ahtisarit dhe parimet kushtetuese për sa i përket kësaj dhe ne kemi konsideruar në Komision që, pasi e kemi filluar ndryshimin, atëherë ta vazhdojmë ndryshimin për të mirë të Kosovës dhe ta bëjmë Kolegjin e Apelit, ta përmirësojmë pak, kisha thënë ashtu duke ia shtuar një gjykatës më shumë vendor duke ia hequr një gjykatës ndërkombëtarëve apo gjykatësve ndërkombëtarë. Mirëpo, kjo çështje siç na është thënë është kah rrjedhur, domethënë versionin origjinal ka rrjedhur nga një marrëveshje të cilën e paska arritur Qeveria e Kosovës me EULEX-in dhe Komisionin Evropian, më herë dhe unë konsideroj që kjo e tregon edhe një herë këtë lloj të them ashtu dyfytërsie të Qeverisë, ku në njërin anë ministrat e kësaj Qeverie dalin flasin për EULEX-in se si ai është i dëmshëm dhe i pa nevojshëm, ndërkohë që në anën tjetër prapa syve të publikut kjo Qeveri, arrin marrëveshje me EULEX-in për këto çështje që janë kaq të rëndësishme për Kosovën.

Një problem tjetër që po e shohim që lindi këtu është edhe çështja e këtyre ligjeve të cilat nuk kanë kaluar fare në të gjitha komisionet që duhet të kalohen, pra Komisionin për Legjislacion. Veçanërisht, në këtë ligj pajtohem domethënë me kryetarin e Komisionit,

është e rëndësishme që ky komision ta japë mendimin e vet, në mënyrë që deputetët të jenë më të mirë të informuar për sa i përket ligjit dhe problemeve që mund të sjellë ky ligj.

Prandaj, unë mendoj që gjëja më e mirë do të kishte me qenë që këto ligje që nuk i kanë kaluar Komisionit, të tërhiqen nga kjo seancë dhe të shtyhen për një seancë të radhës ku do të kishin kohë të gjitha komisionet të merren me këto.

Pra, për këto ligje që u përmendën këtu paska mbetur veç edhe Komisioni për Legjislacion dhe kjo nguti konsideroj që është e paarsyeshme dhe madje edhe një farë mënyrë po i shtrembëron pak ose po i eskivon pak procedurave normale të Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Adem Grabovci e ka kërkuar fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, përshëndet angazhimin e Qeverisë që të punojë dhe të veprojë në dobi të procesit dhe në interes të qytetarëve të vendit. E përkrah angazhimin e Qeverisë dhe është i bindur se ka arritur të bëjë maksimumin e mundshëm që ky ligj të jetë sa më i favorshëm.

Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së mbështet qëndrimin e Qeverisë dhe do të votoj “kundër” amendamentit 2. Dhe, u bëjmë thirrje gjithë deputetëve që mos ta votojnë këtë amendament. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Muhamet Mustafa e ka kërkuar fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë mendoj që do të ishte shumë mirë që të kemi një trajtim të këtij ligji dhe ligjit tjetër në Komisionin për Legjislacion, në mënyrë që të kemi një mendim profesional mbi pajtueshmërinë e këtyre amendamenteve me sistemin kushtetues dhe ligjdhënës në Kosovë. Përndryshe, mendoj se amendamenti 2 është një zgjidhje jashtëzakonisht e mirë dhe jashtëzakonisht e rëndësishme edhe unë nuk mund të kuptoj pse kërkohet që të tërhiqet ajo, kjo është në dobi të kosovarizimit. Ne, në qoftë se në nenin 1 kemi shumicën e gjykatësve kosovarë edhe në Apel do të kemi të njëjtën logjikë.

Prandaj, mendoj që të shkohet në atë drejtim, por ka mendime që nuk është krejt në harmoni me propozimin gjithëpërfshirës, sigurisht që ne kemi obligim ndaj propozimit gjithëpërfshirës. Prandaj, për të konstatuar këtë, le të tubohet Komisioni për Legjislacion dhe le të na dërgojë raport se ku ky amendament lëndon pra marrëveshjen me planin gjithëpërfshirës, duhet ta kem mendimin profesional. Përndryshe, ka një rëndësi esenciale po them që në Dhomën e Apelit, shumica e gjykatësve të jenë kosovarë. Unë këtë e kam arsyetuar pak edhe në diskutim, sot nuk po e shoh të arsyeshme ta arsyetoj më shumë, por po ju them se është jashtëzakonisht e rëndësishme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zëvendëskryeministri Kuçi, e ka kërkuar fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Ndoshta u pa edhe një herë pas reagimit tuaja, dua të them që edhe nga zonja Sahatqija dhe nga zoti Ymeri, u njoftua besoj edhe ajo që është bërë një ndryshim edhe u çmua, por njëkohësisht do t'i thosha zoti Ymeri, që nuk është dyfytirësi, por një negociim dhe një seriozitet.

Unë e di që nuk dallojmë në qëllime asnjëri në këtë sall a të ketë më shumë gjyqtarë më shumë të EULEX-it apo të Kosovës, dhe do të ishte hipokrizi t'i thuash dikujt ti po lufton t' i mbash të EULEX-it e ky tjetri të Kosovës. Por, po ashtu e di që i kemi disa obligime në Kushtetutën e Kosovës, me planin gjithëpërfshirës dhe kur t'i ndryshojmë ato me automatizëm ecin të gjithë këto, por deri këtu kemi ardhur me një kompromis kemi biseduar për këtë edhe në Kosovë me Komision Evropian, me partnerët ndërkombëtarë që të gjithë shtetet e Kuinti por edhe me Komision Evropian në Bruksel edhe ndryshimi i parë 13 me 7 s'ka qenë i lehtë. Por po e japi edhe një sqarim edhe profesorit Mustafa, është shumë me rëndësi që gjithkund të jenë gjyqtarë kosovarë, por nëse gjyqtarët kosovarë që janë në Dhomën e Posaçme i kryejnë detyrat mirë, nuk ka shumë punë Dhoma e Apelit. Dhoma e Apelit ka punë kur ata ankohen që si ka kryer punët mirë Dhoma e Posaçme dhe në këtë drejtim edhe drejta e tyre për një mbikëqyrje njihet përmes asaj që të jenë shumicë në Dhomën e Apelit, nuk humb Kosova në këtë drejtim, nuk humbin palët në këtë drejtim dhe çështja e drejtësisë është po ashtu me ligjet tona të aplikueshme në vendin tonë.

Unë ju ftoj edhe një herë që kompromisin tonë ta mos ta rrënojnë jo në kuptimin e saj që ta, por t'i prishim raportet në atë çështje që pastaj të mos funksionojë fare dhe të mbetet si është. por po ashtu unë ju premtoj që vitin tjetër në strategjinë legjislative do të jetë ligji i njëjtë për ndryshimin e përbërjes dhe unë besoj që kjo është një e arritur e mirë për këtë vit, viti tjetër mund të jetë me risi të tjera.

Pra, po e them edhe një herë amendamenti 2 të mos mbështetet pra, të mbetet ashtu sikur ka mbetur në ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani kjo është komplikuar pak mundësia e miratimit të ligjeve sepse, Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne dëgjuam raportet e dy komisioneve që sipas Rregullores janë të implikuar në këtë amendamentim dhe dëgjuam mbasandaj edhe një vendim pak të çuditshëm që Komisioni tërhiqet nga amendamentimi i vet. Prandaj, këtu ne duhet të vendosim për 2 – 3 sende, po duhet ta shohim rregullin, më së pari a vendos Kuvendi t'i votoj ose të mos i votojë këto amendamente, pa mendimin e Komisionit juridik? Kjo është me rëndësi, duhet të vendosë Kuvendi po ose jo. Ka të bëjë edhe me dy ligje, po ne jemi këtu, domethënë më së pari e merr këtë vendim “po”, “jo”, nëse e merr “po”, “jo” atëherë shkojmë në variacionet çka

do të votojmë. A do të votojmë njëshin a dyshin, a e votojmë dyshin me një variant, sepse edhe ai ka variante? Prandaj po them, të jemi të saktë në procedura, në mënyrë që të mos krijohet një gati mosmarrëveshje mbas gjithë këtyre diskutimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

E kisha të njëjtin mendim edhe unë. Ne kemi një qëndrim dhe mendim të Komisionit për Legjislacion, i cili nuk ka shqyrtuar tri ligje dhe kërkon deklarin e Parlamentit se a duhet të shqyrtohen më tutje a jo këto tri ligje që s'janë shqyrtuar, sepse në qoftë se njëri përjashtohet, atëherë duhet të përjashtohet të tria, është i njëjti qëndrim edhe i Grupit Parlamentar "Vetëvendosje" dhe kemi një çështje kushtetuese që kërkon edhe interpretim kushtetues, ose kërkon nga ne që ta interpretojmë Kushtetutën, pavarësisht nga qëndrimet tona politike për çështje të caktuara dhe, mendoj që të gjithë e dimë se si duhet të procedohet, në qoftë se komisioni në fjalë i cili ka vërejtje nuk pajtohet me amendamentin e dytë. Prandaj, unë kërkoj deklarin e Parlamentit, po mendoj me vota sepse shumica kanë diskutuar tani për këtë çështje, që të vendosim që të shqyrtohen sot këto tri ligje apo mbi bazën e kërkesës së Komisionit për Legjislacion dhe kërkesës së Grupit Parlamentar "Vetëvendosje" për shkak të mos shqyrtimit në Komision të tërhiqen për seancën e ardhshme.

Një sqarim zoti Kuçi e ka kërkuar.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Ndoshta një sqarim që edhe ju e dini, unë e njoh të drejtën e Komisionit për ta shqyrtuar çështjen e tillë dhe këtu nuk ka asnjë dilemë, por, po ashtu të gjithë ne e njohim të drejtën që Kuvendi vendos edhe mbi atë që vendos Komisioni dhe një parim i njohur juridik ai që mundet më shumë mundet edhe më pak, por do të thotë Kuvendi mundet me e krye punën që dikush tjetër e ka thënë apo jo, edhe pse ka raste kur vendoset të kundërtën me komisionin.

Çështja e dytë që është shumë me rëndësi besoj këto ligje nuk janë të tanguara, përjashtimisht këtij amendamenti. Po e zëmë Ligji për persona të zhdukur, nuk e tangon asi konceptin politik dikujt, nuk e tangon as çështjen që ka të bëjë me raportet juridike që mund të jenë mes Kuvendit, Qeverisë apo dikujt tjetër dhe ky prolongim e ka edhe një rëndësi të tretë që sot është dita e fundit, besoj që të gjithë e dimë, për hartimin dhe miratimin e ligjeve që kanë të bëjnë me raportin e progresit, të tri këto ligje janë të ndërlidhura drejtpërdrejtë.

Dhe unë ju ftoj që këto të mbështeten sot, po ashtu ju falënderoj që sot është pajtuar dhe ligjet paraprake, të gjitha që kanë qenë lidhur me Raportin e Progresit janë miratuar. Unë mendoj që ka qenë një dërgim më 24 qershor i këtij projektligji që po e shqyrtojmë tash, unë ju kisha ftuar për mirëkuptim dhe kisha dashur që Kuvendi t'i shqyrtojë dhe të japë mendimin e vet. faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Me qenë se në një mënyrë është mocion i Komisionit, kisha kërkuar edhe një herë zotin Gashi për mendim.

ARBEN GASHI: Komisioni nuk i ka trajtuar këto amendamente, prandaj nuk mund të jap qëndrim në emër të komisionit. Qëndrimi im personal është që këto ligje nuk mund të trajtohen përderisa Komisioni nuk është mbledhur që ta japë një vendim për këto ligje. Mirëpo, në të njëjtën kohë seanca mund të vendosë se çka do të bëhet me këto ligje, prandaj i mbetet seancës që të vendosë. Personalisht, mendoj se nuk duhet trajtuar, por seanca vendos. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, jemi të qartë të gjithë.
Zoti Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!
Kam një propozim, po para saj më lejoni një koment shumë të shkurtër. Është një rast vërtet i veçantë në të cilin mund të konstatohet një mospërputhje e plotë me Propozimin gjithëpërfshirës dhe me Kushtetutën, por është në një aspekt që besoj Kuvendi duhet ta ketë parasysh. Është në kuadër të procesit të transferimit të kompetencave dhe finalizimit të pavarësisë së Kosovës. Nuk shoh ndonjë logjikë që Kuvendi i Kosovës ta shfrytëzojë këtë pretekst formal- juridik për të penguar një proces shumë të rëndësishëm të Kosovës.

Prandaj, mendoj që kjo do të mund të tejkalohet, por nëse Komisioni insiston që ta shqyrtojë, propozimi im e pash edhe të një kolegu është që, ose Kuvendi të vazhdojë me ligje tjera dhe Komisioni ndërkohë të mblidhet dhe të ketë parasysh këtë që theksova dhe të kalojë formal- juridikisht ose eventualisht të bëhet një pauzë e shkurtër që Komisioni të mblidhet dhe ta shqyrtojë dhe ligjet të kalohen. Nëse ka një progres nuk mund Kuvendi i Kosovës të dalë kundër atij progresi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë i ndërpres diskutimet se vërtet këtu u ezauruan, grupet janë deklaruar, komisionet janë deklaruar, janë rregullat të cilat përcaktojnë. Dëshira ka shumë, qëndrime politike ka të ndryshme, dokumentet mbi bazën e të cilave funksionon Kuvendi janë vetëm një rregullore dhe është vetëm një kushtetutë. Atëherë, unë e hedh në votim propozimin e Qeverisë ose më mirë të themi janë dy propozime që të tërhiqen, tri projektligje. Projektligji i njëmbëdhjetë - Shqyrtimi për Gjykatën Supreme që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Shqyrtimi i dytë i projektligjit për personat e zhdukur. Nuk janë shqyrtuar në komision, diskutimet kanë marrë fund. Unë i qes në votim, sepse është kërkuar mendimi i deputetëve.

Kush është “për” që të shqyrtohen sot dhe kush voton “kundër” domethënë që t’i rishqyrtojë edhe një herë Komisioni për Legjislacion?

Regjia gati për votim, votojmë tani:

A jeni duke votuar a jo?

Atëherë, konstatoj që me 63 vota “për” shqyrtim të sotëm janë deputetët, 6 abstenime dhe 17 janë “kundër”.

Atëherë po vazhdojmë me votimin e ligjeve sipas renditjes.

Shqyrtojmë pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës që është: - Shqyrtimi i Projektligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ne i kemi thënë këto. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

9 vota” kundër “

Në sallë janë 98 deputetë,

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Ky duhet t’i nënshtrohet votimit dhe po mendoj se duhet edhe të diskutohet.

Fjalën e ka kërkuar zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne edhe ashtu gati e shterëm bisedën rreth këtij amendamenti që pat “pro” dhe “kundër”. Komisioni ishte i dyzuar, e ka ndërtuar vetë dhe tha jo. Megjithatë, unë u përpoqa ta përcjell gjithë diskutimin dhe, më sa më duket mua, zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, tha që pjesa e parë e amendamentit, që i bie te 1-shi, është një marrëveshje me bashkësinë ndërkombëtare. Nëse unë e kam dëgjuar mirë, zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, atëherë unë insistoja që bile kjo pjesë që është një marrëveshje e nuk është e parëndësishme as kjo pjesa e parë, të votohet pjesa e parë e amendamentit 2, ku është një përqindje e ndryshuar e gjyqtarëve, që ka kuptim dhe ka rëndësi. Nëse kjo është marrëveshje, pse të mos votohet, kjo s’ ka kurrfarë logjike, dhe unë them kjo pjesë bile të votohet? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Zoti Gjini e ka kërkuar fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se të gjitha diskutimet në njëfarë aspekti ishin të drejta për shkak se diskutimi paraprak ishte esencialisht për këtë pikë, jo për diçka tjetër, mirëpo ajo që po shihet në Kuvend, është se është gati vullnet i përbashkët yni ta ndryshojmë Kushtetutën. Por, derisa nuk e ndryshojmë Kushtetutën në këtë pikë, ne duhet pasur kujdes se çka po votojmë sot, për shkak se, nëse një votim do të jetë ndryshe prej disa elementeve që janë tepër të qarta në Kushtetutën e Kosovës, atëherë me siguri se dikush do të kërkojë interpretim të këtij ligji në Gjykatën Kushtetuese dhe do t’i kthehet Kuvendit. Tani, po sqaroj, Aleanca nuk është kundër që të jetë shumicë numri i gjyqtarëve vendorë, mirëpo një vendim i tillë i Kuvendit sot do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Kjo është krejt ajo çka po themi dhe mendojmë se ne duhet ta respektojmë vijën kushtetuese për shkak se është një prej mënyrave më të mira për ta ndërtuar një shtet më të fuqishëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur, po, zotëi Kuqi e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJRDIN KUQI: Ju faleminderit!

Më së pari ju faleminderit që u pajtuat të vazhdoni edhe me këto tri ligje që janë me rëndësi.

E dyta, mendoj që esenca që e tha zoti Hamiti, ekziston në këtë, për ta sqaruar, mendova se komisioni e ka pasur të qartë.

Amendamenti 1, neni 3, paragrafi 1 ndryshon dhe duhet të mbështetet.

Amendamenti, po ashtu i njëjtë, neni 3 paragrafi 10 po ashtu, por ne e kemi problem vetëm me nenin 3, paragrafi 12. Pra, 12- shi duhet të jetë si në ligj, këto dy të tjera duhet të jenë sikur ka thënë Komisioni. Domethënë këtu është çështja, esenca e kësaj, unë besoj se edhe zoti Gjini e tha në mënyrë të drejtpërdrejt vullneti është krejt tjetër politik, por momentalisht gjendja juridike është e tillë, dhe unë besoj që edhe Kuvendi pa dashur të ndërhyj në të drejtën e deputetëve, pa e ndryshuar Kushtetutën, ka problem me i ndryshuar ligjet.

Pra, edhe një herë po e përsërisë, vetëm neni 3, pika 12 të mbetet sikur në ligj, çështjet e amendamenteve tjera i mbështet edhe Qeveria. Po.

KRYESUESI: Ju faleminderit! A e deshe fjalën Teutë! Mirë, mos fol pa ta dhënë fjalën. Deputetja Sahatqija e kërkon fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Kryesues, kur flas, a flas me mikrofon a jo, ajo është e drejta ime. Ju faleminderit për sugjerime. Pullën e pata shtypur dhe e pata kërkuar fjalën.

Sa i përket ndryshimit të Kushtetutës, ndryshimi i Kushtetutës me këtë ligj është bërë. Ndryshimi është në dobi të gjyqtarëve kosovarë. Me Kushtetutë edhe me dokumentin e Ahtisarit, është ndryshimi i gjyqtarëve në dobi të gjyqtarëve ndërkombëtarë. Me këtë ligj e kemi bërë ndryshimin, prandaj nuk jemi duke bërë precedencë, Kuvendi edhe Komisioni ka kërkuar që këtij ndryshimi që është propozuar prej Qeverisë, t'i shtohet edhe një inkrement edhe që ai ndryshim të vlejë jo vetëm për kolegje tjera, por edhe te Kolegji i Apelit. Prandaj, ajo që është ndryshuar Kushtetuta edhe që është ndryshuar dokumenti i Ahtisarit, ajo është evidente, ata që e kanë lexuar këtë ligj.

Ne po kërkojmë që ai ndryshim të vazhdon, të vazhdojë edhe te Kolegji i Apelit. Kaq.

KRYESUESI: Nuk mund të ndryshohet Kushtetuta me ligj, deputete. Mos bë hajgarë tash, se jemi në Parlament!

Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Besoj se ka një keqkuptim madhor këtu. Sa i përket Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe referimit të saj drejtpërdrejt nga parafolësit, nga zoti Gjini dhe të tjerët, mendoj se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në mënyrë eksplicite nuk e përmend Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk përmendet. Prandaj, kjo është në mënyrë implicite nënkuptohet nga pakoja e Ahtisarit dhe jo në mënyrë eksplicite në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ju kisha lutur shumë që ta keni parasysh se ky ligj

nuk e prek drejtpërdrejt, është interpretim i imi se ky ligj drejtpërdrejt, në mënyrë eksplicite nuk e prek Kushtetutën, por në mënyrë implicite pastaj është çështje interpretimesh prandaj ka hapësirë për dyja variante që të kalojnë dhe seanca mund të vendos se cili prej varianteve mund të kalojë dhe të shkojë për trajtim të mëtutjeshëm.

Ju faleminderit shumë! Mendoj se Kushtetuta si e tillë nuk po ndryshohet me këtë ligj.

KRYESUESI: Nuk është puna e Kushtetutës, është puna e Komisionit për Komunitete dhe ju i dini kompetencat e tij, zoti Kuqi. Tash, a të flasim drejtë...?

ZËVENDËSKRYEMINSITRI HAJRDIN KUQI: Ju faleminderit!

Unë besoj që për një sqarim që e përmendi edhe zoti Gashi. Zoti Gashi, besoj secili prej nesh po e lexojmë ligjin e Kushtetutës, e lexojmë deri në nenin e fundit dhe në nen aty thotë: “nëse bie në kundërshtim Kushtetuta dhe pakoja”, vlen pakoja dhe ky është problemi. Do të thotë, esenca e kësaj çështjeje, është që ne nuk duhet të hyjmë në një çështje që kemi arritur një marrëveshje bashkë me aktorët ndërkombëtar dhe ajo marrëveshje të kthehet në pikën zero.

Ajo që kisha dashur, po e them prapë, ashtu si është në ligj nuk është keq, e kemi bërë kompromis, nuk e dëmton Kosovën dhe unë jam i bindur që po e them prapë, efektshmëria e kësaj Gjykate do të jetë shumë më shumë ose së paku 50% më mirë se sa ka qenë deri më sot. Ta votojmë, ta mos votojmë këtë amendamentin e dytë, të vazhdomë më tutje dhe besoj që vitin tjetër na këtu jemi prapë dhe prapë mund t'i ndryshojmë.

KRYESUESI: Hajde, replikë Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Ju faleminderit, zoti Kuqi!

Besoj që Kushtetutën e kemi lexuar deri në fund, mirëpo unë bëra një interpretim sipas mendimit tim juridik dhe thashë që në mënyrë eksplicite në Kushtetutë nuk thuhet diçka për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, prandaj besoj se u keq referova në atë që e thatë ju.

Sa i përket çështjes se pakoja e Ahtisarit a e parasheh a nuk e parasheh, unë thashë që e parasheh pakoja e Ahtisarit këtë ndryshim, mirëpo ndryshimi, referenca drejtpërdrejt në Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk ka nevojë të bëhet dhe Ligji mund të kalohet si i tillë, sepse ka një marrëveshje ndërkombëtare dhe mund të shkohet, të vazhdohet më tej. Besoj se po shkojmë në të njëjtën logjikë, ndërsa nuk di pse po përplasemi pa nevojë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Visar Ymeri e ka kërkuar fjalën.

VISAR YMERI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Së pari, vetëm desha një qartësim se këtu më duket se është shkaktuar një keqkuptim për sa i përket Komisionit për Zhvillim Ekonomik. Komisioni për Zhvillim Ekonomik e ka

votuar këtë amendament dhe aty natyrisht që ka pasur vota kundër, mirëpo shumica e votave ka qenë për këtë amendament dhe tash kryetari mund të flasë në emrin e vet personal, por jo në emër të Komisionit, se Komisioni e ka marrë këtë vendim. I mirë e i keq, ky është vendimi i Komisionit. Për sa i përket çështjes së ndryshimit ajo jo të Kushtetutës, pra këtu është qartësuar që Dhoma e Veçantë nuk është kategori kushtetuese e as numri i gjykatësve në të, e veçanërisht jo numri i gjykatësve në Kolegjin e Apelit.

Kjo është e vërtetë që figuron në planin e Ahtisarit, mirëpo plani i Ahtisarit tashmë është ndryshuar edhe me këtë versionin origjinal të cilin e ka sjell Qeveria këtu, pra nuk është e njëjtë, domethënë vetëm edhe një qartësim këtu, arsyeja pse është ndërruar edhe pika 1 në nenin 3, domethënë në amendamentin 2, është për shkak që është ndërruar pika 12, siç e përmendi edhe zëvendësministri dhe ministri i Drejtësisë, ku domethënë në numrin e gjykatësve në Kolegjin e Apelit është ndryshuar një gjykatës në favor të gjykatësve vendorë dhe pastaj, është dashur që të ndryshohet edhe përbërja e Dhomës së Posaçme si të tillë, domethënë nga 12 vendorë dhe 8 ndërkombëtarë, është bërë në 13 vendorë dhe 7 ndërkombëtarë, për shkak se në Kolegjin e Apelit është bërë ky ndryshim. Pra, siç e shihni versionin origjinal ka qenë 12 me 8, tash është bërë 13 me 7 për shkak të pikës 12. Pra është e vërtetë që problemi ose çështja, të cilën po e diskutojmë është te pika 12 e këtij neni.

Unë konsideroj që, në gjendje çfarë jemi tash, domethënë që po e diskutojmë ligjin i cili edhe pse nuk ka kaluar nëpër komisionet tjera, ky është propozimi i një komisionit të Kuvendit dhe për këtë duhet të votojnë deputetët. A e pranojnë a nuk e pranojnë, është çështje e tyre individuale, mirëpo votimi duhet të bëhet për këtë? Nuk mund ta tërheqim një amendament tash me kërkesë të Qeverisë, për shkak se këtë vendim e ka marrë Komisioni.

KRYESUESI: Jo, jo nuk mund të tërhiqet, duhet të votohet tani.
Tani e ka fjalë e ka Alma Lama dhe i fundit është Armend Zemaj.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë fjalën e mora për të protestuar dhe kritikuar ju, sepse kur po e kërkoj fjalën asnjëherë nuk po shihini as këtë as nuk po na e jepni fjalën.

Ndërkohë, për të njëjtat çështje, të gjithë deputetëve tjerë po ua jepni fjalën, tani Rregullorja a është si ligji në dorë apo si është? Është i njëjtë për të gjithë apo si...

KRYESUESI: Unë respektova hierarkinë

ALMA LAMA: Jo, kur ishte Ligji për prokurimin publik, unë kisha nevojë të flas sepse kisha argumente.

KRYESUESI: Kërkoj falje në qoftë se je prekur...

ALMA LAMA: Duhet ta respektojmë Rregulloren dhe ky është parlament, vjen nga fjala “parla- flas”, kemi nevojë të flasim dhe të mos miratojmë ligje me të cilat s’ pajtohemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
E ka fjalën Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Unë po e vazhdoj protestën, por në një drejtim tjetër. Ka të bëjë me komisionet dhe në komisionet dihet qartazi se udhëhiqen nga shumica e koalicionit qeverisës dhe është shumë interesat që ka tri, katër ligje, ndoshta po emocionohen atje në komisione apo po mbushem patriotizëm nga deputetët e tjerë dhe këtu po i ndryshojnë qëndrimet dhe po e qesin Kuvendin para një dileme se a duhet të votohet një amendament apo jo? Prandaj, është një vërejtje ime shumë parimore dhe shumë e sinqertë që vendimet kur të merren në komisione, të shikohen pak edhe dokumentet tjerë përcjellës, siç është edhe Kushtetuta edhe pakoja e Ahtisarit dhe të gjithë dokumentet alternativ. Por, ta sqarojmë a dëshirojmë amendamentin 2 të mos ta votojmë komplet, apo vetëm paragrafët e parë. Ta kemi edhe një sqarim si kryesues i seancës.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Pajaziti e ka kërkuar fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se ka nevojë edhe për pak sqarime. E para, dëshiroj t’ju them se ky komision ka kaluar disa projektligje dhe pa pajtimin e komisionit, kur ka qenë e nevojshme. Është mirë që sot u vendos që këto projektligje ose veçanërisht ky projektligj të jetë për shkak kohës në seancë dhe është mirë që edhe te deputetët ka reflektim pozitiv për sa i përket respektimit të kushtetutshmërisë dhe zbatimit të Kushtetutës. Nganjëherë është e vërtetë mund të ketë edhe emocione edhe votimet e ndryshme nëpër komisione, dëshiroj t’ua theksoj atë që e kam theksuar në mbledhje të Komisionit. Në aneksin 7, neni 3, pikën 3, i cili tekstualisht në planin gjithëpërfshirës e precizon këtë çështje. Dhe, unë mendoj që po ashtu edhe neni 143 i Kushtetutës i jap përparësi domethënë respektimit të këtij plani, që edhe nëse votojmë ndryshe, nuk do të kemi sukses, do të kthehemi në pikën zero, kështu që unë mendoj që te neni 2, i cili rrjedhimisht i ka disa nene, unë mendoj se Dhoma e Apelit e pastaj edhe te Dhoma e Posaçme reflekton është respektuar ajo që Qeveria e ka arritur në negociata ose në bashkëpunim me EULEX-in dhe të tjerët për ta bërë një hap përpara, nuk prishë kurrgjë punë, vetëm se neni 2 nëse shkon kështu, është në kundërshtim me Planin gjithëpërfshirës. Unë mendoj se nuk duhet të votohet amendamenti 2. Këtë qëndrim e kam pasur. Është shtyrë disa herë në mbledhje të Komisionit, pikërisht për këtë pikë.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Konjufca e ka kërkuar fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Një sqarim para se ta hedhim në votim këtë amendament. Mendoj se këtu puna nuk është fare te Kushtetuta e Kosovës e as te plani i Ahtisarit,

sepse për t' i rënë punës shkurt dhe për ta sqaruar politikisht, kjo, këtu është puna e nënshtrimit të Qeverisë së Kosovës, me një marrëveshje që e ka bërë me EULEX-in, janë marrë vesh ashtu, e tash kushtetuta po përdoret si justifikim me këtë rast, sepse të mos harrojmë, këta e kanë shkelur edhe planin e Ahtisarit prej presioneve ndërkombëtare, kur ju ka nevojitur, kur ka pasur presione ndërkombëtare.

T'ua kujtoj vetëm Ligjin për t' i shtuar edhe dy pakica tjera në Kosovë, që nuk janë në plan të Ahtisarit, kroatët dhe malazezët, pakicën kroate dhe malazeze. Këta kanë qenë "për", a nuk e parasheh plani i Ahtisarit. Pse kur po i konvenuaka dikujt, po bëka të shkelet plani i Ahtisarit, e në këtë rast kur po i konvenon Kosovës që me qenë më shumë gjyqtarë në Dhomën e Apelit, më shumë gjyqtarë vendorë, këta po i referohen planit të Ahtisarit, si justifikim. Kjo është shumë e qartë. Këtu kemi të bëjmë me një nënshtrim të Qeverisë së Kosovës, e për ta maskuar nënshtrimin, po i referohen Kushtetutës të Kosovës edhe planit të Ahtisarit.

E dyta, këta na kanë thënë gjithmonë që jemi duke shkuar drejt marrjes së kompetencave, do me thënë transferimit të kompetencave prej faktorëve ndërkombëtarë, prej institucioneve ndërkombëtare që janë aktualisht në Kosovës, te institucionet vendore, kurse praktikat po e kallëzojnë krejt të kundërtën. Këta po i betonojnë me këto praktika që po na i sjellin në Kuvend, sundimin ndërkombëtar në Kosovë edhe kompetencat e EULEX-it, kompetencat aktuale të EULEX-it, kështu që mendoj që po bëhet fjalë thjeshtë për një hipokrizi, të cilën deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk duhet ta votojnë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Zëvendëskryeministri Kuçi e ka kërkuar fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit!

Ndoshta është bërë shumë tepër duke diskutuar, por po nxitet pak debati. Unë desha me zotin Konjufca drejtpërdrejtë të reagoj.

Mendoj që njerëzit kur janë në institucione, kanë sjellje më pak rraha gjoksi, më shumë institucionale. Për të qenë më i qartë, plani i presidentit Ahtisari u pranua nga ky Kuvend, nga institucionet e vendit dhe aty shumë qartë thuhet: Mbi vlen, mbi Kushtetutën dhe po ashtu shumë qartë thuhet: ndryshohet vetëm në partneritet me bashkësinë ndërkombëtare, do të thotë nuk mundesh njëanshëm, dhe këtë e kemi pranuar ne. Unë besoj që tash, të arrijmë, unë besoj partneriteti i parë ka qenë deri këtu, partneriteti i dytë mund të jetë më shumë, partneriteti dhe tash mos te marrim kush nënshtrohet e kush nuk nënshtrohet, se besoj se nuk është vendi këtu që duhet shumë për ta moralizuar njëri - tjetrin.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka diskutues tjerë të paraqitur. E hedh në votim amendamentin e dytë. Ja, qysh e kemi bërë me të parën, e bëjmë edhe me të dytën. Rregullorja e Kuvendit vlen, nuk vlen mendimi i askujt. Rregullorja është, amendamenti komplet shkon ose nuk shkon. Kjo është. Nuk ka tjetër propozim. Është propozimi i dytë të hiqen: paragrafi i dytë, të hiqet pika 12 e amendamentit. Unë nuk

mundem me dy palë kuti, Rregullorja është njësoj si për amendamentin e sotëm, si për amendamentin e djeshëm.

E hedh në votim amendamentin 2, të propozuar nga komisioni funksional, pa mbështetjen e Komisionit për Komunitete.

Votojmë, tani:

Në sallë janë 102 deputetë. Ka pa kartelë? Nuk ka.

Atëherë, konstatoj që nuk miratohet amendamenti 2, me 57 vota “kundër”, 34 vota janë “për”, 4 abstenime.

Vazhdojmë.

Amendament 3

Abstenim nuk ka, kundër nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 4

Abstenim nuk ka, “kundër”, nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 5

Abstenim nuk ka, “kundër” nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 6

Abstenim nuk ka, “kundër” nuk ka.

Miratohet.

Votojmë Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani!

Në sallë janë 102 deputetë.

Ju faleminderit!

Në sallë janë 94 deputetë.

Konstatoj se 70 vota janë “për”, 6 abstenime, 16 janë “kundër”.

Konstatoj se Kuvendi miratoi Ligjin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Vazhdojmë me pikën e 15-të të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit ia kanë parashtruar raportet me rekomandime.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional, deputetin Zenun Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni e ka trajtuar po ashtu këtë Projektligj dhe e ka servuar Parlamentit, për aprovim. Pra, është gjithçka okej. Mendojmë dhe i lusim grupet parlamentare, deputetët ta votojnë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Selmani e ka kërkuar fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe pak më parë unë e kërkoja fjalën, se është bërë një gabim gjatë votimit, por ju nuk ma dhatë. Nuk ka problem!

Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duhet të potencoj se rekomandimet e Koalicionit për Kosovë të Re, edhe pse në shqyrtimin e parë të Projektligji është potencuar mjaft mirë se Koalicioni për Kosovë të re, në rast se nuk hyjnë amendamentet të cilat i ka propozuar Koalicioni për Kosovë të re, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re nuk do ta përkrahë Ligjin për Agjencionin Kosovar të Privatizimit, edhe pse e dimë se edhe ky ligj vjen me pakon e presidentit Ahtisari. Për sqarim të gjithë deputetëve, në dy amendamente janë përfshirë përafërsisht rekomandimet e Koalicionit për Kosovë të Re, ndërsa rekomandimi i tretë nuk është përfshirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Vetëm një sqarim. Është e vërtetë se ka pasur disa propozime jo të formuluar strikt, si amendamente, Koalicioni për Kosovë të Re. Edhe pse zonja Selmani nuk ka qenë prezente në mbledhjen e Komisionit, Komisioni i ka trajtuar të gjitha ato propozime dhe amendamentet që janë, janë me përfshirje të disave nga propozimet e Koalicionit për Kosovë të Re. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në Raportin e komisionit funksional.

Amendamenti 1

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

A e kërkuat fjalën, zonja Selmani? E pash me vonesë.

MYZEJENE SELMANI: Nuk e di çfarë propozimi tjetër, kur publikisht Koalicioni për Kosovë të Re ka kërkuar që të hyjnë rekomandimet e Koalicionit për Kosovë të Re. I janë dhënë të gjithë deputetëve të komisionit parlamentar. Unë nuk mund të bëjë një shkresë zyrtare edhe nëpërmes Gjykatës Kushtetuese që këto amendamente të hyjnë. Mirëpo, kur dihet se dy parti janë në koalicion, atëherë duhet të merren rekomandimet e Koalicionit për Kosovë të Re dhe duhet të merren ato rekomandime të grupit

parlamentar, mirëpo prapë se prapë, unë i thashë edhe një herë kryetarit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, se dy amendamente janë përfshirë edhe mungesën time, duke marrë parasysh se unë jam shef e grupit dhe më duhet të jem edhe në mbledhjet e Kryesisë. Është i njoftuar mjaft mirë dhe njëkohësisht kërkoj që këto dy amendamente, ku janë futur rekomandimet e Koalicionit për Kosovë të Re, të përkrahen nga Grupi Parlamentar, ndërsa amendamenti tjetër jo. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Unë vërtet i kisha lutur komisionet që të harmonizohen dhe t'i kryejnë punët, që të mos merremi me detaje teknike në Parlament, se edhe po na merr kohë dhe po krijon paqartësi.

Amendamenti 2

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 4, është amendament i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e komisionit funksional. Votojmë me elektronikë, pra.

Kush është “për”, kush është “kundër”?

Votojmë, tani:

Ju faleminderit!

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 5 – dy propozime:

Komisioni funksional dhe deputeti Bekim Haxhiu.

E votojmë edhe këtë me elektronikë.

Votojmë sipas rregullit për Komisionin funksional, në fillim.

Zoti Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

BEKIM HAXHIU: Ju faleminderit, kryesues!

Te amendamenti 5, është propozuar që të ndryshohet, do me thënë ka qenë kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura Kosovës dhe kam marrë pëlqimin, do me thënë informimin nga kryetari i Komisionit se është pajtuar që të jetë përfaqësuesi i Sindikatave nga Këshilli Ekonomiko-Social, për shkak se në Këshillin Ekonomiko-Social, përfshihen, përfaqësohen dy sindikata. Këtu, në këtë propozim, është anashkaluar kjo çka edhe vetë kryetari i komisionit ka njoftuar se ka kaluar në komision.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Pajaziti, e ka kërkuar fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni i ka trajtuar edhe disa propozime të deputetit Haxhiu. Disa pjesërisht i ka përfshirë. Unë ju lutem që të mbështeten amendamentet e komisionit, të cilat i kanë marrë në trajtim të gjitha propozimet që kanë ardhur edhe nga deputetët, edhe nga partitë politike ose grupet e caktuara politike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Bytyçi e ka kërkuar fjalën, apo gabimisht e keni shtypur. Gabim, më fal!

Atëherë, votojmë me elektronikë Amendamentin 5

Nën a) është Komisioni funksional,

Nën b, i deputetit Haxhiu.

Fillimisht, votojmë për Amendamentin e komisionit funksional.

Votojmë, tani:

Ju faleminderit!

Kalon Amendamenti i komisionit funksional me 65 vota “për”, 7 abstenime, 9 “kundër”.

Amendamenti 6

Edhe ky i ka dy propozime: Një të Komisionit funksional dhe prapë të deputetit Haxhiu, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë, tani:

Ju faleminderit!

Miratohet amendamenti i komisionit funksional, me 60 vota “për”, 5 abstenime dhe 6 “kundër”.

Kemi një amendament shtesë, i pa renditur nga administrata, siç duhet. Është amendamenti i propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, pa deklaram të komisionit funksional, andaj kërkohet deklarimi i komisionit funksional.

Kush dëshiron të flasë tash? Zenun?

Neni 13, pika 2, po thotë të fshihet. Ky është propozimi. Pra, unë mendoj që ... Atëherë, nuk e votojmë fare.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka propozuar, zonja Hadergjonaj!

SELVETE HADERGJONAJ: Komisioni për Buxhet dhe Financa ka propozuar që neni 13, paragrafi 2, të fshihet në tërësi. Është kjo që po dihet se kanë shkuar pak me shpejtësi këto çështjet e këtyre amendamenteve, megjithatë ky është dashur të kthehet te komisioni funksional dhe ky amendament të jetë i përfshirë në tekstin e ligjit, mirëpo nuk është përfshirë. Unë kërkoj nga deputetët që ta përkrahin amendamentin e komisionit.

Është çështja e financimit të bordeve, duhet të bëhet me rregullativa të posaçme dhe jo në këtë mënyrë, siç ka shkuar, sepse në këtë mënyrë edhe krijon implikime buxhetore shtesë, meqenëse parashihet kompensimi për shpenzime. Me ligj, kompensimi për shpenzime, të cilat nuk janë të përcaktuara se çfarë shpenzimesh do të jenë, është i pa

arsyeshëm. Ky ka qenë arsyetimi i Komisionit për Buxhet. Të gjithë anëtarët e komisionit kanë qenë pro këtij amendamenti. Ne kemi propozuar dhe unanimisht është miratuar në komision.

KRYESUESI: Naser, ti u tërhoqe, a? Zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: E kemi trajtuar edhe këtë çështje në mbledhje të Komisionit dhe jemi dakorduar të japim prioritet Komisionit për Buxhet. E mbështesim plotësisht rekomandimin e Komisionit për Buxhet.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Atëherë, votojmë amendamentin e propozuar nga Komisioni për Buxhet.

“Kundër”, nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Mendoj që është si amendament i domosdoshëm, në bazë të shpjegimeve. Miratohet. Ju faleminderit!

Amendamenti 7, i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e komisionit funksional. Sqarim ka zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Njësoj sikur edhe për amendamentin 5, edhe në amendamentin 6 në komision këto propozime, këto amendamente kanë kaluar. Unë po befasohem edhe vetë nga kryetari i Komisionit për shkak se jam i informuar se këto dy amendamente, edhe 5, edhe 7, kanë kaluar në komision. Përse nuk janë përfshirë nga teknika e Kuvendit, si propozime të dakorduara nga komisioni, nuk po mund ta kuptoj, është çështje ndoshta e teknikës ose këto çështje të merren nga procesverbali i mbledhjes së komisionit, për shkak se edhe përfaqësimi në sindikatë, edhe mandati i bordit është rregulluar dhe nuk është si në projekt propozimin e parë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Atëherë, votojmë me elektronikë amendamentin 7, të deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë, tani:

Ju faleminderit!

Me 57 vota “kundër” me elektronikë dhe 1 pa elektronikë, pra me 58 vota “kundër”, 9 abstenime, 11 vota “për”, refuzohet, nuk miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8, ka dy propozime.

Komisioni funksional dhe deputeti Haxhiu. Edhe për këtë votojmë me elektronikë.

Votojmë, tani,

(Reagime nga salla)

KRYESUESI: Po, unë nuk e kam detyrë të sqaroj atë, propozuesit mund të sqarojnë dhe mund të paraqiten. Regjia, edhe një herë, ju lutem. I dini rregullat, propozuesi gjithnjë ka të drejtë të sqarojë çfarë të dojë. Un nuk e kam për detyrë të sqaroj.

Votojmë amendamentin e 8-të!

Janë dy propozime: a) Komisioni FunkSIONAL dhe b) deputeti Haxhiu.

Votojmë sipas rregullës, propozimin e komisionit funksional.

Votojë, tani:

Ju faleminderit!

Me 72 vota “për”, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 10

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 11

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 12

“Kundër” 10, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 13

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 14

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 15

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 16

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 17

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 18

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 19

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 20

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 21

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 22

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Të nderuar deputetë,

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 97 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë, tani:

Ju faleminderit!

Konstatohet se me 62 vota “për”, 19 abstenime, 9 me kartelë dhe 1 pa kartelë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 16-të të rendit të ditës:

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për masat mbrojtëse në importe dhe Kuvendit i kanë parashtruar raportet me rekomandime.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional, deputetin Zenun Pajaziti, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

Mirë. Nuk ka kurrgjë. Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në Raportin e komisionit funksional. Projektligji ka 18 amendamente.

Amendamenti 1

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 2

“Kundër! nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 3

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 4

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 5

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 6

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 7

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 8

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 9

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 10

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 11

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 12

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 13

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 14

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 15

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 16

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 17

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 18

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Ju faleminderit! Tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamente.
Në sallë janë 92 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë,
tani. Ju faleminderit!
Konstatohet se Kuvendi me 75 vota “për”, 7 abstenime, 1 “kundër”, miratoi Ligjin për
masat mbrojtëse në importe.

Vazhdojmë me pikën e 17-të të rendit të ditës:

17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për persona të zhdukur

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për persona të zhdukur dhe
Kuvendit ia kanë parashtruar raportet me rekomandime.
Ftoj kryetaren e komisionit funksional, zonjën Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryesues!

Me votimin e sotëm për shqyrtimin e këtij projektligji, shqyrtimi i dytë, janë plotësuar
kushtet për procedim të mëtutjeshëm.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me votimin amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në komisionin funksional. Projektligji ka 16 amendamente.

Amendamenti 1

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 2, duhet të votohet me elektronikë. Është i propozuar nga deputetja Albana Gashi, pa përkrahjen e komisionit funksional. Tani e ka kërkuar fjalën, deputetja Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Desha të filloj në lidhje me këtë projektligj, të hartimi i këtij ligji, fillimisht. Ky ligj nuk është hartuar në bazë të kontekstit të Serbisë për shfarosjen e popullit shqiptar të Kosovës.

Sa i përket datave 98-2000, ne kemi qenë prej fillimit kundër kësaj date, pra viti 2000. Në këtë ligj është paraparë zhdukja, pra për personat e zhdukur gjatë periudhës së luftës 98-99, ndërsa data vazhdon deri në vitin 2000. Kjo datë nuk duhet të jetë kurrsesi në këtë projektligj, por meqë jemi te data dhe duhet ndërruar diçka, atëherë unë kam propozuar që data 98, pra 1 janari 1998 të zëvendësohet me datën 1 janar 1991, si pasojë e regjimit okupues serb dhe luftës në Kosovë në vitet 1998-99. Pra, të zhdukurit duhet të përfshihen prej 1 janarit 91 deri më 21 qershor 99, kur edhe është nënshkruar Marrëveshja për armëpushim ose për përfundimin e veprimtarisë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga kryeministri i atëhershëm, Hashim Thaçi. Atëherë, i kisha lutur deputetët që ta votojnë këtë amendament. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kryetarja e Komisionit, Novobrdaliu, e ka kërkuar fjalën.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryesues!

Ndoshta kishim dashur edhe ne datat t'i marrim më përpara, por juridikisht nuk mund ta pranojmë një propozim të tillë. Ligji për procedurën jokontestimore, neni 49, thotë: “Personi që mungon nga vendi i banimit ose vendqëndrimit të fundit të tij, dhe për të cilën nuk ka informata për më shumë se 2 vjet, do me thënë e thekson, me kërkesën e secilit person fizik ose juridik që për një gjë të tillë ka interes juridik, mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës kompetente. Çka do të thotë? Në vitin 91, ne kemi pasur keqtrajttime, maltretime, ndoshta edhe vrasje, mirëpo të zhdukur nuk kemi pasur. Prandaj, edhe komisioni nuk e ka përkrahur qëndrimin, më mirë të themi propozimin e deputetes.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Kajtazi ka kërkuar fjalën.

KURTAN KAJTAZI: Ju faleminderit, kryesues!

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë të drejtat dhe interesat e familjarëve të personave të zhdukur, personat e zhdukur dhe në veçanti të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur, për të ditur për fatin e personave të zhdukur, si pasojë dhe që e cek qartë, si pasojë e luftës në Kosovë të vitit 98-99.

Ne kemi bërë përpjekje, kemi pasur kontakte edhe me organizatat joqeveritare që e prekin fushën e personave të zhdukur, edhe me shoqatat e personave të zhdukur, edhe me familjarët e tyre, dhe ata të gjithë në fund janë dakorduar, duke e ditur pamundësinë e tendencave, dy herë të hyjë në mandatin e kaluar ky projektligj, ata janë pajtuar që të figurojë data 2000. Është e drejtë humanitare, është në përputhshmëri me konventat ndërkombëtare që prekin fushën e të drejtave të njeriut, është me konventat ndërkombëtare kundër diskriminimit dhe me konventat ndërkombëtare që prekin fushën e personave të zhdukur, por një kërkesë e tyre ka qenë tendenca që të futet një datë e mëhershme.

Ne kemi diskutuar në komision dhe kemi bërë përpjekje që të futet një datë më e vonshme, por të futet një datë para janarit të vitit 98, atëherë nuk mund të cekim një datë të saktë kur përpara, pas Luftës së Dytë Botërore apo viti 91. Dhe, ky ligj, po të ndryshohet ky amendament, po të kalojë ky propozim, atëherë do të ketë implikime të mëdha buxhetore dhe ne si komision e kemi votuar kështu, të jetë ashtu siç e ka bërë propozimi Qeveria. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë me votim. Deputeti Selimi e ka kërkuar fjalën.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt, ky ligj edhe në leximin e parë, edhe tani e ka bërë një gabim, i cili në përputhje me periudhën kohore, të cilën e shpjegon ky Ligj për personat e zhdukur, bën një lloj barazimi edhe në kohë. Kini parasysh, data 1 janar i vitit 1998 dhe data 31 dhjetor i vitit 2000, janë plotësisht 3 vite. Data 1 janar i vitit 1998, deri me përfundimin e luftës, është një vit e gjysmën, që mbetet fiks një vit e gjysmë që trajton të zhdukurit e pasluftës.

Si i tillë, edhe në kohë ky ligj, edhe në fillim e barazon edhe në kohë viktimën me agresorin. Ne e dimë që Serbia prej se i ka okupuar tokat shqiptare, në këtë rast në Kosovë, ka bërë edhe vrasje, edhe zhdukje edhe krime. Pra, të zhdukur ka pasur edhe në periudhat e mëhershme kohore, por të trajtohen barabar të zhdukurit gjatë pushtimit serb, me të zhdukurit kur në Kosovë ka qenë përgjegjës NATO-ja, mendoj që është e padrejtë.

KRYESUESI: Zoti Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj që duhet të merret parasysh propozimi i deputetes edhe për një arsye, sepse u konstatua gabimisht sikur në periudhën para vitit '98 nuk ka pasur të zhdukur. Ne të gjithë e dimë se ka pasur të zhdukur. Unë po e sjell vetëm një. Xhavit Haziri, që ka

qenë veprimtar i shquar, i dalluar dhe është zhdukur në një periudhë të mëhershme. Ka qenë edhe ajo luftë. Lufta para luftës nuk ka qenë më e lehtë se sa lufta më pastaj.

Unë mendoj, ose duhet të miratohet propozimi i deputetes, ose eventualisht si propozim kompromisi një formulë që e kemi përdorë në disa ligje, është të mbetet ashtu siç është dhe të thuhet: “T”i shtohet: “dhe në raste të veçanta edhe para kësaj periudhe.” Ju faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, Vazhdojmë. A e ke krye Kurtan?

Votojmë amendamentin e propozuar nga deputetja Gashi, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë, tani:

Ju faleminderit!

Konstatohet se Kuvendi me 38 vota “për”, 32 “kundër”, 5 abstenime, miratoi amendamentin e parë të deputetes Gashi.

Amendamenti 3

“Kundër” nuk ka, bstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 4, i deputetes Gashi, pa përkrahjen e komisionit funksional, e hedh në votim elektronik, sepse janë dy propozime. Deputetja Gashi e ka kërkuar fjalën.

ALBANA GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Tek neni 3, është provuar prapë që të bëhet barazimi i viktimës me kriminelin. Kisha cekur këtu që të zhdukurit nuk janë as të njëjtë, as të barabartë, siç thotë ky projektligj. Ka kriminel në mesin e të zhdukurve, por ka edhe fëmijë e civilë shqiptarë, kështu që propozoj të votohet amendamenti 4, ku pjesa, “pavarësisht nëse kanë qenë pjesëtar të forcave të armatosura, apo civilë”, të fshihet nga ky nen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Novobrdaliu.

SUZANA NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryesues!

Këtu ju kemi përmbajtur Konventës 1, 2 3 dhe 4 të Gjenevës, si dhe dy protokolleve shtesë të vitit 1977, ku rregullohen të drejtat e luftës dhe ndër to edhe të drejtat e palëve ndërluftuese ose palëve në konflikt në rastet e zhdukjes të ushtarakët, që gëzojnë të drejtat e tyre të njëjta. Do të thotë, këtu ju kemi përmbajtur konventave të Gjenevës.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Albana Gashi, prapë. Mirë pasi je propozues...!

ALBANA GASHI: Kisha dashur për të cekur këtu që të zhdukurit serbë, pra policët, ata janë të zhdukur të Serbisë dhe nuk janë të Kosovës, kështu që nuk ishte dashur të parashihen në ligjin tonë. Edhe tjetër, unë e kam një shembull të ICRC-së, ku nuk është cekur, nuk janë cekur forcat paramilitare, janë të armatosur apo nuk janë të armatosur.

Ne disa herë provojmë të bëhemi më Papë se Papa në kurriz të popullit, kështu që kisha propozuar edhe një herë që të hiqet kjo fjali. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

E hedh në votim amendamentin 4, të deputetes Albana Gashi, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë, tani:

Ju faleminderit!

Atëherë, 42 vota janë “për”, 31 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 4 i deputetes Gashi.

Amendamenti 5

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 6

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 7

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 8

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 9.

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 10

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 11

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 12

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 13

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 14

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 15

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 16

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Të nderuar deputetë,

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë, tani:

Në sallë janë 90 deputetë.

Ju faleminderit!

Me 77 vota “për”, 5 “kundër”, 1 abstenim, konstatoj që Kuvendi miratoi Ligjin për personat e zhdukur.

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Me kaq, seanca e planifikuar për të hënë edhe sot, ka përfunduar. Në orën 14:00, fillojmë seancën e re, sipas rendit të ditës të paraparë.

Ju faleminderit!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës

